



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS**



Tel 0355 4 2378 536, Fax: +355 4 2369 987, [www.fhf.edu.al](http://www.fhf.edu.al)  
Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

# **E FOLMJA E DEVOLLIT**

**(Sprovë etnosociolinguistike)**

TEZË PËR PUNIM DOKTORATURE

Përgatiti:

Msc. ANYLA SARAÇI (MAXHE)

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. ALI JASHARI

**TIRANË, 2010**

## PARATHËNIE

### Qëllimi dhe objektivat e studimit

Zhvillimi i studimeve etnosociolinguistike në shkencën gjuhësore shqiptare nuk janë as të vonshme, as të pakta. Pavarësisht se në vitet e fundit ato kanë marrë një fytyrë të përcaktuar mirë, duke u përqëndruar mirëfilli në studimin e gjuhës si mjet komunikimi në gji të bashkësisë shoqërore, ato janë paraprirë nga një shumësi studimesh të pjesshme a të plota në fushën e dialektologjisë. Në këto punime gjejmë trajtimin e veçorive fonetiko-gramatikore të të folmeve, por, njëkohësisht, vihen re dhe shtjellime të veçanta që lidhen me përdorimin e të folmeve në varësi të ndryshorëve sociolinguistikë.

Në panoramën e përgjithshme të hartës të të folmeve të shqipes, e folmja e Devollit ka tipare të veçanta fonetike, gramatikore e leksiko-frazeologjike. Si e tillë, ajo ka ngjallur prej kohësh interesin e gjuhëtarëve. Kështu, mund të përmendim punimin e V. Xhaçkës «Një shikim mbi të folmen e krahinës së Devollit» të vitit 1958 dhe atë të J. Gjinarit «Mbi të folmen e Devollit» të vitit 1960, të pasuara nga një sërë punimesh të mëvonshme mbi leksikon, frazeologjinë dhe toponiminë e kësaj krahine, të botuara në periodikë të ndryshëm. Pavarësisht nga të arriturat e deritanishme, mund të vihet re se e folmja e Devollit nuk është studiuar ende në të gjithë elementët dhe veçoritë e saj, për më tepër, për të nuk ka pasur studime të mirëfillta etnosociolinguistike.

Duke u nisur nga rëndësia e studimeve të sotme në fushën e etnosociolinguistikës, në punimin që po paraqesim në kërkim të gradës «Doktor», janë bërë përpjekje për një studim të plotë e të thelluar të të folmes së Devollit, si një e folme me karakteristika të caktuara, të shqyrtuara në tri boshtet kryesore: në hapësirë, në kohë dhe në shoqëri.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është shqyrtimi i kësaj të folmeje anësore, e cila ka ruajtur mjaft karakteristika të gjendjes së hershme të shqipes në tërësi, por, gjithashtu, edhe si një e folme që ka dhënë e ka marrë me të folme të tjera të krahinave përreth. Kjo krahinë, si pikë etnografike e veçantë, si krahinë kufitare me dy shtete ballkanike, me histori të trazuar pushtimesh, me lëvizje të mëdha të popullsisë në periudha të ndryshme historike (lëvizje që vazhdojnë dhe sot), me një mendësi të caktuar shoqërore, me një kulturë të veçantë shpirtërore e materiale, ka lënë gjurmët e veta dhe në të folmen e saj.

Disa nga synimet që e kanë paraprirë këtë punim janë: cilat janë këto gjurmë, sa dhe si janë bërë pjesë e etnikumit shpirtëror të bashkësisë që përdor këtë të folme, cilat janë përbashkësitë

me mbarë shqipen në tërësi, cilat janë veçoritë që mund të bëhen shumë lehtë pjesë e gjuhës në komunikim etj.

Punimi përqendrohet në dy drejtime kryesore:

së pari, në një analizë të thelluar të të folmes së Devollit që i përket një mjedisi të kufizuar nga pikëpamja territoriale dhe shoqërore, duke vënë në dukje veçoritë fonetiko-gramatikore e fjalëformuese të saj në gji të toskërishtes veriore dhe në marrëdhënie me të folme të veçanta që i përkasin gegërishtes;

së dyti, në një analizë sociolinguistike të të folmes mbi bazën e faktorëve gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë që kanë ndikuar dhe ndikojnë në aspektin funksional të përdorimit të saj. Nga kjo pikëpamje, në të folmen e Devollit hasen elementë të veçantë gjuhësorë, që lidhen me situatat dhe përdoruesit e kësaj të folmeje në bashkësinë shoqërore përkatëse. Për të arritur këto qëllime u përcaktuan disa objektiva:

1. E folmja e Devollit të shqyrtohet si pjesë përbërëse e toskërishtes veriore me karakteristika të dallueshme të grupit lindor të saj.
2. E folmja e Devollit të analizohet në vështrim diakronik e sinkronik në veçoritë e saj fonetiko-gramatikore mbi bazën e përjasjeve të dukurive të veçanta gjuhësore.
3. Të klasifikojë nga kriteri i «formës së brendshme» frazeologjinë e të folmes, duke krijuar një fond frazeologjik si burim i përdorimit të saj në mbarë shqipen dhe për hartimin e një fjalori frazeologjik krahinor.
4. Të analizohet e folmja e Devollit mbi bazën e ndryshorëve sociolinguistikë si një e folme që pasqyron mendësinë, kulturën, historinë dhe zhvillimin e krahinës.
5. Të plotësojë të dhënat e onomastikës shqiptare të shqyrtuara deri më sot me të dhëna të toponimisë dhe antroponimisë së krahinës së Devollit për t'u përdorur si burime për shpjegime, shqyrtime dhe argumentime rreth historisë së gjuhës shqipe dhe si burim për hartimin e një fjalori onomastik të krahinës së Devollit.

## **Metodologjia e kërkimit**

Duke u nisur nga qëllimi i punimit, metodologjia e kërkimit u mbështet në shqyrtimin sinkronik dhe diakronik të të folmes së Devollit, në përdorimin situativ të saj në kontekste të përcaktuara nga pjesëmarrësit në komunikim në vende dhe kohë të ndryshme duke ndjekur dy drejtime:

së pari, mbledhja e materialit gjuhësor të të folmes në terren duke hulumtuar konkretisht përdorimin e saj në bashkësinë shoqërore përkatëse. Për këtë u mbështetëm në pyetësorët e hartuar për mbledhjen e materialit leksiko-frazeologjik, onomastik dhe për veçoritë fonetike dhe morfologjike të të folmes.

së dyti, shqyrtimi i materialit faktik mbi bazën e literaturës teorike për të të dhënë një pamje të plotë fonetiko-gramatikore, leksiko-frazeologjike dhe etnolinguistike të të folmes.

## **Fazat e kërkimit**

### **Faza përgatitore**

1. Studimi i literaturës.
2. Hartimi i pyetësorëve.
3. Formulimi i platformës studimore «E folmja e Devollit si një e folme me tipare të veçanta fonetiko-gramatikore dhe etnosociolinguistike në gji të toskërishtes veriore dhe në bashkëmarrëdhënie me të folme të tjera jashtë dialektit».

### **Faza e mbledhjes të të dhënave**

1. Pyetësorët me studentët, ekspeditat gjuhësore.
2. Intervistat e drejtpërdrejta.
3. Materialet leksiko-frazeologjike e folklorike në periodikë të kohës.

### **Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre**

1. Përqasja me studime të mëparshme, duke plotësuar analizën për një territor më të gjerë që përfshin mbi 20 pika të grumbullimit të të dhënave.
2. Analiza e veçorive fonetiko-gramatikore dhe shqyrtimi sociolinguistik i frazeologjisë, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë.
3. Shqyrtime të thelluara dhe mbështetëse për etnografinë e të folurit në të folmen e Devollit.
4. Përgjithësime dhe përfundime.

# PASQYRA E LËNDËS

**Parathënie**

## **PËRMBAJTJA**

### **1. HYRJE**

<b>1.1 Krahinë e Devollit</b> .....	1
1.1.1 Pozita gjeografike.....	1
1.1.2 Lashtësia e krahinës dhe e banorëve të saj.....	4
1.1.3 Të dhëna etnofolklorike për krahinën.....	7
<b>1.2 Rreth prejardhjes së emrit “Devoll”</b> .....	12

### **2. E FOLMJA E DEVOLLIT BRENDA NDARJES DIALEKTORE TË SHQIPES**

<b>2.1 E folmja e Devollit si pjesë e toskërishtes veriore</b> .....	20
<b>2.2 E folmja e Devollit në grupin lindor të toskërishtes veriore</b> .....	30
2.2.1 Dallimet në rrafshin fonetik.....	32
2.2.2 Dallimet në rrafshin morfologjik.....	33
<b>2.3 Bashkëpërkimet me gegërishten jugore</b> .....	38

### **3. TIPARE DHE DUKURI FONETIKE TË TË FOLMES SË DEVOLLIT**

<b>3.1 Vështrim i përgjithshëm për sistemin tingullor të të folmes së Devollit</b> .....	45
<b>3.2 Sistemi zanor</b> .....	52
3.2.1 Zanoret e theksuara .....	52

3.2.2 Zanoret e patheksuara.....	53
3.2.3 Togjet e zanoreve dhe diftongjet.....	56
<b>3.3 Sistemi i bashkëtingëlloreve.....</b>	<b>59</b>
3.3.1 Bashkëtingëllore të veçanta.....	59
3.3.2 Grupe bashkëtingëlloresh.....	61
<b>3.4 Modifikime të tingujve dhe ndërrime fonemore.....</b>	<b>64</b>
3.4.1 Modifikimet e tingujve.....	64
3.4.2 Ndërrimet fonemore.....	68
<b>3.5 Theksi i fjalës në të folmen e Devollit.....</b>	<b>70</b>
<b>4. TIPARE MORFOSINTAKSORE TË TË FOLMES SË DEVOLLIT</b>	
<b>4.1 Veçori të përgjithshme morfosintaksore.....</b>	<b>72</b>
<b>4.2 Emri .....</b>	<b>74</b>
4.2.1 Kategoria gramatikore e gjinisë.....	74
4.2.2 Kategoria gramatikore e numrit.....	75
4.2.3 Kategoria gramatikore e rasës.....	80
4.2.4 Kategoria gramatikore e shquarsisë dhe e pashquarsisë.....	83
<b>4.3 Mbiemri dhe përemri.....</b>	<b>84</b>
4.3.1 Mbiemri .....	84
4.3.2 Përemrat .....	85
<b>4.4 Folja .....</b>	<b>89</b>

4.4.1	Kategoritë gramatikore të mënyrës dhe kohës.....	89
4.4.2	Format e pashtjelluara të foljes.....	95
<b>4.5</b>	<b>Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës .....</b>	<b>96</b>
4.5.1	Ndajfoljet.....	96
4.5.2	Lidhëzat dhe parafjalët.....	97
4.5.2	Pjesëzat dhe pasthirrat.....	98
<b>4.6</b>	<b>Dukuri sintaksore në të folmen e Devollit.....</b>	<b>99</b>
<b>5.</b>	<b>DUKURI TË FJALËFORMIMIT DHE TË FRAZELOGJISË NË TË FOLMEN E DEVOLLIT</b>	
<b>5.1</b>	<b>Fjalëformimi.....</b>	<b>101</b>
<b>5.2</b>	<b>Prejardhja .....</b>	<b>103</b>
5.2.1	Prejardhja parashtesore.....	103
5.2.2	Prejardhja prapashtesore.....	104
5.2.3	Kompozimi dhe përngjitja.....	115
<b>5.3</b>	<b>Frazeologjia e të folmes të Devollit.....</b>	<b>117</b>
<b>6.</b>	<b>TOPONIMIA DHE VLERAT E SAJ ETNOLONGUISTIKE</b>	
<b>6.1</b>	<b>Veçori të përgjithshme të toponimisë së Devollit.....</b>	<b>133</b>
<b>6.2</b>	<b>Struktura leksiko-gramatikore e toponimisë së Devollit.....</b>	<b>135</b>
6.2.1	Toponimet sipas ndërtimit dhe kuptimit.....	136

6.2.2	Toponimia dygjuhëshe.....	140
6.2.3	Faunotoponimia.....	141
6.2.4	Fitotoponimia.....	144
6.2.5	Toponime që lidhen me mite dhe besime fetare.....	147
6.2.6	Toponime onomatopeike.....	148
6.2.7	Toponime me numërorë.....	149
<b>6.3</b>	<b>Përbërja morfologjike e toponimeve.....</b>	<b>149</b>
6.3.1	Toponime nga emra të përgjithshëm.....	149
6.3.2	Toponime antonimike.....	150
6.3.3	Toponime me strukturë togfjalëshi dhe fjalie.....	151
<b>6.4</b>	<b>Struktura fjalëformuese e toponimeve.....</b>	<b>153</b>
<b>7.</b>	<b>SHQYRTIME ETNOSOCIOLOGJISTIKE NË TË FOLMEN DEVOLLIT</b>	
<b>7.1</b>	<b>Mënyra e jetesës përmes të folmes së Devollit.....</b>	<b>155</b>
7.1.1	Poçeria dhe vlerat e saj etnolingvistike.....	155
<b>7.1</b>	<b>Besimet dhe ritet në të folmen e Devollit.....</b>	<b>161</b>
7.2.1	Shqyrtime rreth dallimeve gjuhësore sipas përkatësisë fetare.....	161
7.2.2	Urime për festa e rite si shprehje e etnografisë së të folurit.....	162
7.2.3	Etnografia e të folurit në ritet e fejesave dhe dasmave.....	166
7.2.4	Lindja dhe përgimi.....	171
<b>7.2</b>	<b>Etnografia e të folurit në ngushëllimet.....</b>	<b>172</b>
<b>7.3</b>	<b>Mallkimet si pjesë e të folurit grarisht.....</b>	<b>173</b>



<b>7.4 Rreth “baby-talk”-ut në të folmen e Devollit.....</b>	<b>176</b>
<b>7.5 Rreth antroponimisë në të folmen e Devollit.....</b>	<b>177</b>
7.6.1 Vështrim i përgjithshëm mbi antroponiminë.....	177
7.6.2 Emrat kalendarikë fetarë.....	179
7.6.3 Emrat jofetarë.....	182
7.6.4 Zbunimet si karakteristikë etnolinguistike e të folmes së Devollit.....	184
7.6.5 Patronimet .....	186
7.6.6 Emrat e farefisnisë në Devoll.....	189
<b>8. PËRFUNDIME.....</b>	<b>191</b>

## **BIBLIOGRAFIA**

## **SHTOJCA**

# 1. HYRJE

*Crede mihi, sacra populi lingua est (Më beso, gjuha e popullit është e shenjtë)-Seneka*

## 1.1 Krahina e Devollit

### 1.1.1 Pozita gjeografike

Krahina e Devollit, si njësi administrative, shtrihet përgjatë brigjeve lindore dhe perëndimore të lumit me të njëjtin emër, në skajin më juglindor të Shqipërisë. Në pikën më lindore të Shqipërisë, në fshatin Vërnik, shtrihet në gjatësinë gjeografike  $21^{\circ} 40'$ <sup>1</sup>. Gjeografikisht, territoret e këtij rrethi shtrihen në nënnjësinë jugore të Krahinës Malore Qendrore, pikërisht në gropat juglindore. Në veri, veriperëndim dhe në perëndim kufizohet me rrethin e Korçës nga lartësitë që zbresin në liqenin e Prespës dhe përgjatë kurrizit të Moravës. Në jugperëndim kufizohet me rrethin e Kolonjës nga pjerrësitë verilindore të malit të Gramozit, ndërsa në juglindje, lindje dhe verilindje kufizohet me Republikën e Greqisë, përgjatë një vije kufitare prej 83 km, ku ngrihen lartësitë mbi Nikolicë, Arrëzë, Qytezë, Vidohovë, Kapshticë, Vërnik, Rakickë e deri në lartësinë e Llapishtit. Gryka e Cangonjit e lidh këtë krahinë me fushën e Korçës. Në lindje lidhet me shtetin fqinjë, Greqinë, nëpërmjet Grykës së Kapështicës.

Brenda këtyre kufijve, rrethi i Devollit ka një sipërfaqe<sup>2</sup> prej 429 m<sup>2</sup>. Për nga madhësia Devolli grupohet në rrethet e vogla të vendit, duke u renditur i nënti në Shqipëri<sup>3</sup>. Rrethi i Devollit ka një shtrirje gjatësore horizontale meridionale veri-jug prej rreth 60 km dhe gjerësi maksimale prej 16.5 km.

Kjo krahinë rrethohet nga lartësitë e vargmalit të Moravës në Perëndim, nga malet Vojskovar, Ruki, Pllashovec në lindje, nga mali i Golinit dhe i Qafashticës në veri dhe në jug nga Paçarovi, Bidoja dhe Kruki. Si pjesë përbërëse e Gropave Juglindore, krahina e Devollit përfshihet tek albanidet e brendshme, ku mbizotërojnë shkëmbinjtë sedimentarë (terigjenë në vargun lindor të Moravës, gëlqerorë në lindje, në malësinë e Rakickës dhe të Llapishtit dhe në kontakt me magmatikët në sektorin Tren-Kokogllavë).<sup>4</sup>

<sup>1</sup> [www.INSTAT.gov.al](http://www.INSTAT.gov.al) Shqipëria në shifra, 2007, f. 6.

<sup>2</sup> Almanak i bashkive dhe komunave të Shqipërisë, Tiranë, 2005, f. 96.

<sup>3</sup> Istituto Geografico de Agostini, Calendario Atlante de Agostini, Romë, 2009, f. 271.

<sup>4</sup> P. Qiriazi, Morfologjia dhe morfogjeneza e Gropave Juglindore dhe maleve përreth tyre, Tiranë, QSGJ, 1985, f. 15.

Ndryshime e lartësisë së shkojnë nga 850 m mbi nivelin e detit në veri e deri në 1050 te Maja e Lartë në vargmalin e Moravës.<sup>5</sup>

Në pjesën qendrore të kësaj njësie administrative ndodhet lugina e Devollit të Sipërm<sup>6</sup>, me gjatësi prej 21 km dhe gjerësi prej 7 km. Degët e lumit Devoll kanë marrë emrat e fshatrave ku kalojnë; lumi i Qytezës, i Ziçishtit, i Vidohovës (Shagut), i Hoçishtit, i Pilurit, i Gjyresit, i Babanit, i Llofkës etj. Në pjesën qendrore shtrihet fusha e Bilishtit, e gjatë 10 km dhe e gjerë 7 km, e ndjekur prej fushës së Kurrilës.

Pjesa më e ulët e luginës së Devollit të Sipërm mendohet se ka qenë e mbuluar nga uji në formën e një liqeni që lidhej me liqenin e Korçës nëpërmjet grykës së Cangonjit. Më pas ai është tharë nga lumi i Devollit, i cili bënte shkarkimin e ujërave në Fushëgropën e Korçës dhe ka ndikuar në formimin e Grykës së Cangonjit. Kjo krahinë laget nga ujërat e liqenit të Prespës së Vogël.

Klima e rrethit të Devollit është mesdhetare paramalore juglindore, me nuanca të theksuara kontinentale, për shkak të pozicionit lindor dhe ndikimit më të madh të brendësisë së Gadishullit Ballkanik. Gjatë vitit mbizotërojnë rreshjet e shiut, ndërsa në dimër janë të zakonshme rreshjet e borës.

Hidrografia e rrethit të Devollit mbizotërohet prej lumit Devoll, që e ka burimin e tij pikërisht në malet e kësaj krahine dhe kalon mepërmes hapësirës gjeografike të këtij rrethi. Një element mjaft i rëndësishëm hidrografik i këtij rrethi është prania e liqenit të Prespës së Vogël, i cili po zhduket për shkak të derdhjeve të lumit Devoll, duke u kthyer më tepër në një kënetë.

Përsa i përket bimësisë dhe tokave, Devolli dallohet si një krahinë e pasur me pyje në brezin e dushkut, ahut dhe haloreve, ndërsa në lartësitë mbi 1000 m ka kullota alpine me shumëllojshmëri barishtesh dhe lulesh. Në pjesën perëndimore të kreshtës së Moravës, që njëherazi shërben dhe si kufi administrativ me rrethin e Korçës, ngrihet monumenti natyror i Gurit të Capit (shkëmb në formën e gamiles i formuar si rrjedhim i veprimtarisë eolitike mbi shkëmbinjtë ranorë). Po ashtu, në territorin e kësaj krahine shtrihet rezervati natyror i Cangonjit, ndërsa në Nikolicë gjendet një peizazh i mbrojtur natyror me një bukuri të rrallë.

Kjo krahinë përbën njësinë administrative të rrethit të Devollit, me qendër qytetin e Bilishtit. Si rreth më vete është ndarë në vitin 1992 dhe përmbledh bashkinë e Bilishtit, komunitat

---

<sup>5</sup> Po aty, f. 118.

<sup>6</sup> P. Qiriazi, Gjeografia fizike e Shqipërisë 2, QSGJ, Tiranë, 1991, f. 228.

e Mirasit, Progrit, Bilishtit Qendër dhe atë të Hoçishtit. Në këto komuna përfshihen rreth 45 fshatra, të vendosur përgjatë brigjeve të lumit Devoll, në krahun e majtë dhe të djathtë të tij (duke nisur nga burimet e tij në malet e fshatit Nikolicë). Kjo krahinë, në varësi të relievit të fshatrave dhe vendndodhjes së tyre, ndahet në dy pjesë: në Devollin e Sipërm dhe në Devollin e Poshtëm, të cilat, duke shkuar drejt jugut të krahinës, si ndarje gjeografike lidhen më tepër me faktin e terrenit të thyer malor që vjen duke u ngritur.

Rrethi i Devollit ka një popullsi prej 42567 banorësh<sup>7</sup>, me dendësi të ulët, 99. 2 banorë/km<sup>2</sup>. Kjo dendësi është nën mesataren e dendësisë së popullsisë në Republikën e Shqipërisë<sup>8</sup>, çka ka ardhur për shkaqe që lidhen me pozicionin gjeografik të kësaj krahine, me mundësitë natyrore për të siguruar jetesën, me kushtet historike të zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor të krahinës, si dhe me tradita të hershme të zonës që janë mjaft të gjalla dhe sot (p. sh. emigrimi). Nga ana tjetër, kjo krahinë dallohet për nivel të lartë lindshmërie: rreth 12.2%, më e lartë se mesatarja e gjithë qarkut<sup>9</sup>.

Popullsia e Devollit i ka pasur traditë lëvizjet migratore, si sezonale ashtu dhe të përhershme. Kryesisht migrimi është drejtuar në Greqi, por dhe në Rumani e Bullgari, ndërsa një pjesë e madhe kanë emigruar në SHBA dhe Kanada. Prirje e sotme është dhe lëvizja drejt qendrave kryesore qytetëse të vendit, si në Korçë, Durrës e Tiranë. Megjithatë, duhet theksuar se prirja për emigrim ka qenë kryesisht e banorëve të fshatrave të Devollit të Sipërm (Dardhë, Sinicë, Qytezë, Ziçisht, Bradvicë etj.), për shkak të mundësive të kufizuara për të jetuar në këto zona të thella malore. Ka pasur fshatra, si: Dardha, Grapshi, Ziçishti, Hoçishti etj., të cilat në pjesën më të madhe të vitit mbeteshin pothuaj pa meshkuj të rritur, pasi këta shkonin në kurbet stinor e më vonë në kurbet të gjatë.<sup>10</sup> Disa fshatra janë zbrazur pothuajse plotësisht që në vitet '60 të shekullit të kaluar, për shkak të terrenit të thyer malor (Bradvicë, Nilkolicë). Për më tepër, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar u kufizuan plotësisht dhe rrugët tregtare dhe mundësitë e banorëve për të punuar me punë stinore në Greqi.

Pas viteve '90 të shekullit XX, si në gjithë vendin, edhe në Devoll u përhap gjerësisht emigracioni, si nga zonat malore drejt atyre fushore e sidomos drejt qendrave të mëdha qytetëse, por, mbi të gjitha, u përhap gjerësisht emigracioni në Greqi e SHBA. Vitet e fundit vihet re një

<sup>7</sup> Almanaku i bashkive dhe komunave të Shqipërisë, Tiranë 2005.

<sup>8</sup> Instituto Geografico de Agostini, Calendario atlante de Agostini, Romë, 2009, f. 272.

<sup>9</sup> S. Meçollari, Treguesit demografikë (qarku Korçë), në gazetën "Korça", maj, 2007, f. 7.

<sup>10</sup> P. Pepo, Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore (shek. XVIII-XX), Kodiku i Korçës dhe Selasforit I, Tiranë, 1981, f. 15.

prirje e rindërtimit të shtëpive të vjetra ose ripopullimi stinor i disa fshatrave të kësaj krahine nga emigrantët ose nga banorë të tjerë me lidhje të vjetra me fshatrat e tyre. Kjo ndodh për shkak të kushteve klimatike që kanë këto fshatra (sidomos Devolli i Sipërm), si dhe nga një përmirësim i kushteve ekonomike të këtyre banorëve të rinj. Në një farë mënyre, ata po rigjallërojnë jo vetëm jetën ekonomike të fshatit të tyre, por, njëkohësisht, mbajnë gjallë dhe ripërtërijnë traditat dhe kulturën e hershme të krahinës.

Nga pikëpamja ekonomike, në këtë rreth peshën specifike ekonomike më të madhe e mban bujqësia, blegtoria, bletaria e pylltaria. Pjesën tjetër e zë tregtia, transporti, turizmi e shërbime të tjera dhe shumë pak industria. Kuptohet që, faktori natyror, prania e fushave pjellore dhe kullotave të shumta, sidomos në pjesën qendrore dhe veriore të rrethit, në të dy anët e rrjedhës së lumit, por dhe mendësia e theksuar e punës te devollinjtë ka bërë që të mbizotërojnë bujqësia dhe blegtoria. Në këtë krahinë ka prodhimtari të lartë të kulturave bujqësore dhe të frutikulturës. Është një nga krahinat që, si në shekullin e kalur dhe sot, furnizon me prodhime bujqësore dhe blegtorale me cilësi të lartë një pjesë të mirë të tregut vendës dhe eksporton dhe në vendet fqinjë.

### **1.1.2 Lashtësia e krahinës dhe e banorëve të saj**

Nga gjetjet arkeologjike, kjo krahinë dëshmohet hershëm si vendbanim, qysh në periudhën e neolitit (shekujt XVI-XV p.e.s). Si vendbanim i hershëm prehistorik ka shërbyer shpella në fshatin Tren, përfund një kodre shkëmbore rreth 15 m pranë bregut të liqenit të Prespës së Vogël. Ky vendbanim shpellor mendohet se i përket fundit të mijëvjeçarit të katërt p.e.s., periudhës së neolitit të vonë (eneolitit).<sup>11</sup> Ajo u zbulua për herë të parë në vitin 1952 dhe nga fshatarët njihet si Shpella në Grykën e Ujkut, Shpella e Spilesë, apo Shpella e Trenit. Këtu janë gjetur vegla pune të gdhendura në kockë, gur, strall, bri, e më pas, prej bronzi, hekuri e argjendi. Kalimi nga vegla guri e stralli në ato të përpunuara prej metali tregon për vijimësinë e një bashkësie shoqërore që nga periudha neolitike, në epokën e bronzit dhe të hekurit, në periudhën qytetare ilire (shek. IV-I p.e.s.), duke vazhduar në periudhën romake (shek. I-III e.s.), Antikitetin e Vonë (shek. V-VI e.s.) e deri në Mesjetën e zhvilluar.<sup>12</sup>

<sup>11</sup> Grup autorësh , Historia e popullit shqiptar , botim i ASH, Tiranë, 2002, f. 27.

<sup>12</sup> S. Aliu, Recent prehistoric research in southeast Albania: A review New direction in Albanian Archeology, Nr1, QNASH, Tiranë, 2005, f. 49.

Vlera të veçanta kanë dhe objektet prej qeramike që i përkasin neolitit të vonë dhe periudhës së bronzit e të hekurit (shekujt XIII-XII p.e.s.). Këto enë kanë mure të holla, të pjekura mirë, me ngjyra të çelëta të kuqërreme, okër dhe gri në të blertë, të zbukuruara me motive të larmishme gjeometrike<sup>13</sup>. Në literaturën arkeologjike ky tip qeramike është quajtur “qeramika devollite”<sup>14</sup> dhe gjurmët e punimit të saj vijnë deri vonë, në gjysmën e parë të shekullit të kaluar.

Në fillimet e epokës së hekurit Shpella e Trenit u rrethua me mure në shpatet jugore. Brenda së njëjtës kohë, në afërsi të shpellës, janë ndërtuar pranë njëra-tjetrës dhe disa kala të tjera. Kështu, ngjitur me kodrën, në anën lindore, ngrihet kreshta shkëmbore e malit të Trajanit (1245 m), e rrethuar me mure në jug dhe verilindje, që njihet nga banorët vendës si Kalaja e Trajanit me sipërfaqe rreth 20 ha. Në anën jugore lartësohet një kodër tjetër, e cila lidhet me të parën nëpërmjet një qafe që shërben si udhë kalimi. Në këtë kodër ruhet një mur rreth 50 m i gjatë dhe njihet si Kalaja e Mokut, që ka shërbyer si pritë në raste rreziku. Kalaja e Trajanit përmendet si një nga qendrat më të rëndësishme protourbane të vendit tonë dhe për të kanë shkruar autorë antikë grekë e romakë (Tit-Livi, Kurt Rufi, Ariani etj.).

Pranë kësaj shpelle, rreth 300 m në perëndim të saj, ndodhet Kalaja e Vëntrokut, ndërsa mbi një kodër të vogël shkëmbore, shpatet e së cilës zbresin në deri në ujërat e liqenit të Prespës së Vogël, ngrihet një kala tjetër, e quajtur Gradishta e Shyecit. Këto vendbanime me ledhe rrethuese, të ndërtuara me gurë të thyer të përzier me dhé, quheshin “gradina”, emërtim që është ende dhe sot në fjalorin aktiv të të folmes së Devollit. Kalaja e Vëntrokut dhe Gradishta e Shyecit përbëjnë të vetmet fortifikime të këtij lloji në Shqipëri, të ngritura në pika strategjike, ndërsa gjithë fortifikimet rreth liqenit të Prespës dhe Grykës së Ujkut kanë shërbyer si rrugë kalimi që lidhnin fushën e Devollit me pellgun e Korçës, Pelagoninë, Maqedoninë, Thesalinë dhe gjithë pellgun e qytetërimit të Egjeut.<sup>15</sup>

Nga Rufi dhe Ariani<sup>16</sup> përmendet dhe një qytet i fuqishëm i Desaretisë, me emrin Pelion. Pelionin, disa studiues janë munduar ta lidhin me fshatin e sotëm Pilur, i cili gjendet në perëndim të rrjedhës së Devollit. Por, në të vërtetë, ende nuk dihet mirë vendndodhja e këtij qyteti, megjithëse përmendet si rezidencë e mbretit ilir, Bardhylit. Gjatë kryengritjeve ilire kundër

<sup>13</sup> Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar I, botim i ASH, Tiranë 2002 f. 34.

<sup>14</sup> Këtë tip qeramike e përmendin dhe etnografët L. Mile e A. Onuzi si një nga vlerat etnografike më të spikatura të zonës, e cila paraqiet ngjashmëri dhe me tipe të tjera të qeramikës së lashtë ballkanase.

<sup>15</sup> S. Aliu, Recent prehistoric research in southeast Albania: A review, New direction in Albanian Archeology, n.1, QNASH, Tiranë, 2005, f.49.

<sup>16</sup> Historianë grekë të shekullit II p.e.s. (Histori e popullit shqiptar I, Toena, Tiranë, 2002, f. 70).

maqedonasve (pas vdekjes së Filipit, viti 355 p.e.s.), Kliti, i biri i mbretit Bardhyl, pushtoi Pelionin, qytetin e fortë buzë lumit Eordai<sup>17</sup> (ndoshta lumi i sotëm i Devollit).

Fakti që lugina e sipërme e Devollit (zonë ku shtrihet sot krahina e Devollit), ishte një nga arteriet kryesore të lëvizjeve tregtare, bëri që në këtë krahinë të depëronte hershëm krishtërimi, duke u përmendur si një nga qendrat episkopale pas shekullit VI (e.s.)<sup>18</sup>. Në shekujt IX-XII qyteti i Devollit lidhet historikisht me Mbretërinë Bullgare dhe me Perandorinë Bizantine. Kjo periudhë shtrihet që nga sundimi i mbretit të parë bullgar, car Borisit I dhe deri në rënien e Mbretërisë Bullgare dhe triumfin e Bizantit me Vasillin II, i njohur në histori si Vasil Bullgarovrasësi. Pavarësisht se kjo është një periudhë me lëvizje të mëdha të popullsisë, ka një përvijim kulturor-gjuhësor të dallueshëm të të gjithë zonës. Mendohet që këtu dy nxënësit e vëllezërve shenjtorë Kirilli dhe Metodi, që quheshin Klimenti dhe Naumi, punuan me vite të tëra për përhapjen e shkollave dhe kishave sllave në zonën e Korçës, Ohrit dhe Devollit<sup>19</sup>. Krahina shqiptare që njihej me emrin Kumtçevica përfshinte tri qendra kryesore: Ohrin, Devollin dhe Gllavenicën (Ballshin e sotëm)<sup>20</sup>. Për lokalizimin e e Kutmiçevicës dhe tri qendrave kryesore të saj D. Obolenski<sup>21</sup> i referohet “Biografisë së gjatë”, e cila mendohet se është nga shkruar Teofilakti, kryepeshkopi bizantin i Ohrit i shek. XI- XII. Disa studiues bullgarë, këtë emërtim (Kutmiçevica) e nxjerrin me burim nga protobullgarishtja me kupimin “tokat e reja të pushtuara”<sup>22</sup>, gjë që të lë të mendosh se këtu, në këto toka të huaja për bullgarët, u dyndën ushtri dhe popullsi bullgare, të cilat sollën me vete fenë dhe gjuhën e tyre.

Nën ndikimin e Despotatit të Epirit (shek. XIII) disa peshkopata, midis tyre dhe peshkopata e Devollit (ndoshta e njohur si Selasfor, emër me të cilin dokumentohet në shekullin IX) mori lulëzim si qytet mesjetar<sup>23</sup>.

Përfshirja e saj në Perandorinë Bizantine të Rindërtuar ndikoi në forcimin e karakterit ortodoks të besimit fetar<sup>24</sup>.

---

<sup>17</sup> Grup autorësh, Historia e Shqipërisë I, Toena, Tiranë, 2002, f. 70.

<sup>18</sup> Po aty, f. 200-203.

<sup>19</sup> Po aty, f. 218.

<sup>20</sup> P. Pepo, Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore (shek. XVIII-XX), Kodiku i Korçës dhe Selasforit I, Tiranë, 1981, f. 1.

<sup>21</sup> D. Obolenski, Klementi i Ohrit dhe Shqipëria, Etnogjeneza e popullit shqiptar, botim i ASH, Tiranë, 1988, f. 69.

<sup>22</sup> Dh. Bello, R. Damo, Mbi vendodhjen e Devollit nën dritën e toponimisë, Takimi II, IAL, Tiranë, 2008.

<sup>23</sup> P. Pepo, Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore (shek. XVIII-XX), Kodiku i Korçës dhe Selasforit I, Tiranë, 1981, f. 1.

<sup>24</sup> Grup autorësh, Historia e Shqipërisë I, Toena, Tiranë, 2002, f. 251.

Fuqizimi i feudalëve shqiptarë në shekullin XIII solli ndarjen e territoreve ndërmjet tyre. Në kronikat mbi historinë dhe gjenealogjinë e familjes së Muzakajve, të shkruar nga Gjon Muzaka më 1510<sup>25</sup>, thuhet se Devolli ishte pronësi e kësaj familjeje. Despoti Andrea Muzaka zgjeroi kufijtë e zotërimeve të tij drejt Korçës dhe Devollit. Ndërkohë, në tokat shqiptare kishin filluar sulmet e perandorisë osmane. Vdekja e Andrea Muzakës dhe ndarja e zotërimeve mes bijve të tij (ku Devolli i kaloi në pronësi djalit më të vogël, Stojës), sollën dobësimin e sundimit të Muzakajve dhe shthurjen e principatës, si rrjedhim, dhe osmanët në këtë kohë ishin bërë zotër realë të viseve fushore të Devollit<sup>26</sup>. Kështu popullsia e krishterë u detyrua të konvertohet ose të rrudhej në zonat malore. Këtë e dëshmon fakti që në fshatrat e Devollit të Poshtëm, ku mbizotëron popullsia myslimane, ka mikrotoponime të tilla, si: Klisha, De klishka, Lisi i madh te klisha, ose me emra shenjtorësh të krishterë, si: Shinepremtë (Vranisht), ndërsa fshatrat e Devollit të Sipërm kanë qenë ose vetëm me popullsi të krishterë, ose me shumicë të krishterë. Nga regjistri i Korçës dhe i Përmetit, më 1431-1432, fill pas pushtimit osman, Devolli bënte pjesë në kazanë e Korçës dhe Nikolica ishte një qendër e rëndësishme zejtaro-tregtare<sup>27</sup>.

### **1.1.3 Të dhëna etnofolklorike për krahinën**

Devolli është një nga krahinat më të veçanta nga pikëpamja etnokulturore. Në të ndërthuren larmi mikrokulturash, të cilat lidhen me rrethanat e historisë së themelimit dhe vazhdimësisë së kësaj krahine, me larminë e bashkësive fetare, por edhe me mënyrën e jetesës së zonave të ndryshme për shkak të mundësive që u jepte natyra.

Megjithëse në Devoll familjet janë ndërtuar dhe një pjesë e tyre vazhdojnë të jenë me më shumë se një kurore në shtëpi, nga pikëpamja e marrëdhënieve brenda familjes kanë qenë shumë më liberale se në krahina të tjera të Shqipërisë. Familjet e besimit të krishterë, për shkak të rrethanave historiko-shoqërore, ishin përqëndruar në zonat e larta malore, kryesisht në krahun e majtë të rrjedhës së Devollit. Te këto familje kishin depërtuar me kohë elementë të jetës në grupe të vogla. Kjo ndodhi se pjesa më e madhe e këtyre banorëve emigronin në vendet e Ballkanit, si:

---

<sup>25</sup> Ch. Hopf, *Chronique Greco-romane inedite ou peu connues ...*, përkth. Robert Elsie, Berlin, 1873.

<sup>26</sup> Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë I*, Toena, Tiranë, 2002, f. 295.

<sup>27</sup> P. Pepo, *Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore (shek.XVIII-XX)*, Kodiku i Korçës dhe Selasforit II, Tiranë, 1981, f. 130.



Bullgari, Greqi e Rumani ku krijuan dhe koloni, por sidomos ata emigruan në SHBA, nga ku sollën me vete elemente të mënyrës së jetesës dhe të kulturës evropiane dhe amerikane. Gjithsesi, duhet theksuar se dhe familjet myslimane në këtë krahinë kanë qenë shumë më liberale se në krahina të tjera shqiptare dhe kjo dukej, për shembull, në trajtimin që u bëhej grave dhe në mënyrën e veshjes së tyre. Gratë myslimane në Devoll s'kanë qenë asnjëherë të mbyllura brenda mureve të shtëpisë. Ato punonin në fushë dhe nuk mbulohehin me shami.

Pavarësisht se kjo krahinë e ka mbështetur historikisht ekonominë e saj në bujqësi dhe në blegtori, Devolli përmendet për lëvrimin e një sërë zejesh që e bënë atë të njohur edhe në Ballkan. Ushtrimi i zejeve dallohej sipas zonave dhe sipas feve. Zejtaria ishte e përqëndruar kryesisht në Devollin e Sipërm, për shkak të mungesës së tokës. Në këtë pjesë të Devollit ushtroheshin zeje industriale, si: poçeri, prodhim qymyri, përpunim lëkurësh etj.

Popullsia e Devollit ruajti për një kohë të gjatë veshjen tradicionale të punuar me dorë. Mjaft i përmendur është kostumi dardhar, i cili, me ndryshime fare të vogla, përfaqëson gjithë kostumet e grave në Devollin e Sipërm (Qytezë, Sinicë, Dardhë, Nikolicë). Etnografi A. Dojaka shkruan se veshjet më të bukura u përkasin grave të të fshatrave të kurrizit lindor të Moravës që zbret në Devoll, ku përfshihet kryesisht kostumi i Dardhës dhe Hoçishtit.<sup>28</sup>

Kostumi i fshatit Hoçisht ka kohë që është zhdukur, por pjesët e tij janë ndërtuar nëpërmjet të dhënave gojore, si dhe nga disa pjesë shumë të vjetra të gjetura në fshat. Fustani, prej stofi të leshtë jo shumë të trashë, me bazë jeshile të errët (ngjyrë smeraldi) apo kafe të mbyllur në të kuqërremtë, ishte i gjatë deri te nyjet e këmbëve. Në fund të fustanit kishte një shirit të zi shumë të hollë, në brendësi të tij ishte i ngjitur me qepje një shirit tjetër po i zi, me qimëza të holla që, për këtë shkak, quhej furçe. Kapakët e mëngëve ishin prej kadifeje të zezë, pregaçi, i cili përdorej nga të dy anët ishte blu ose jeshil me frutka të punuara prej astari mëndafshi të zi apo me tantella të punuara me grep dhe lidhej me dizga mbi fustan. Mbi të vihej brezi me ndërthurje ngjyrash të bardha të verdha e jeshile dhe me pafta metalike të punuara me filigram dhe me gurë shumëngjyrësh. Shamia e kokës ishte zbukuruar me rrota të zeza ose trëndafila, ndërsa shamia e belit dhe e qafës kishte thekë. Çorapet, për gratë e moshuara, thurreshin me fushë vishnjë të errët apo blu të thellë, ndërsa për gratë e reja motivet ishin me heqkë, me ngjyra më të hapura.

Në ndryshim nga kostumi i Hoçishtit, ai i gruas qytezare përbëhej nga xibuni i zi prej shajaku, i qëndisur në pjesën e përparme me fije ari, në pjesën e poshtme dhe anësore me gajtan

---

<sup>28</sup> A. Dojaka, Të njohim veshjet tona popullore 1, Tiranë, f. 159-160.

të kuq, nga fustani prej stofi ngjyrë vishnje me pafta metalike e pala, me brezka e dizga me xhufka, nga këmisha me hoja anash, nga shami të ndryshme, nga pregaçi i kuq me gajtan të zi, nga çorapet me vija “aliver” në ngjyrë vishnje. Deri në vitet 30’ të shekullit XX gratë mbanin dhe floçkë. Gratë qytezare nuk mbanin brez, ato vishnin fustane me klinda prej një lloj kadifeje që quhej manicë. Vajzat e reja zakonisht vinin në kokë dylbenka të bardha me hoja të zeza<sup>29</sup>.

Në emërtimin e veshjeve, myslimanët përdorin mintan “këmishë burrash, e bardhë e me mëngë të gjera, kryesisht pa jakë”, dolloma “lloj fustani grash, i gjatë deri te nyjet e këmbës”, setre “xhaketë burrash”, tallaganet me lara ose sivë “veshje burrash në formë jeleku”, kallcat “pjesa e poshtme e ngushtë e pantallonave” degërme “shami koke, kryesisht e përdorin gratë e moshuara”, perushan “tel i mbështjellë me pe të kuq që i vihet nuses në ballë ditën e martesës”, meste “lepitka”, sergi “shall i hollë që hidhet krahëve”.

Punimi i leshit bëhet me razboj (avlëmend), drugë, furkë, qerthull. Punohen kryesisht qilima e levenxe leshi për shtëpinë, si dhe veshje që merren në pajë. Përsa i përket veshmbathjes, në fshatrat e Devollit ka qenë dhe është e zhvilluar rrobaqepësia, qëndistaria dhe puna me shtiza e grep. Punimet e dorës dallohen për motivet dhe për ngjyrat e përdorura. Punimet me grep dhe qëndismat shërbejnë kryesisht për zbukurim, në çarçafë, veshje etj. Punët me grep e me sovalkë dallohen për larminë e motiveve, sepse në pjesën më të madhe kanë në bazë ngjyrën e bardhë, ndërsa qëndismat bien në sy për larminë e motiveve dhe të ngjyrave.

Përpunimi i lëkurëve bëhej kryesisht në Hoçisht. Aty kishte punishte për regjien e lëkurëve, e cila zotërohej nga familja e Tabakëve (dhe patronimi i familjes lidhet me këtë profesion). Sot kjo mjeshtëri nuk vazhdon.

Devolli i Poshtëm merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori, për shkak të kushteve më të përshtatshme natyrore, ndërkohë që fshatrat buzë liqenit të Prespës së Vogël (Shyec, Zagradec, Tren) merreshin dhe vazhdojnë të merren edhe me peshkim.

Urbanistika e fshatrave të Devollit është mjaft moderne në raport me krahina të tjera të Shqipërisë. Fshatrat, të vendosura në faqet e kodrave, janë në tipin e fshatrave të dendur, me banesa afër njëra-tjetrës në territore të kufizuara, me vendosje të rregullt të banesave të tyre, me rrugë të drejta me çezma e burime. Përgjithësisht fshatrat e Devollit i kanë pasur rrugët të

---

<sup>29</sup> Të dhënat janë marrë nga F. Proгри, Motivët popullore në veshjet e grave të Hoçishtit dhe Qytezës, Korça Almanak 2, Tiranë, 1980, f. 81-87.

shtruara me kalldrëm (sepse ishin të vendosur kryesisht në shpatet e maleve ku e gjenin gurin me lehtësi)<sup>30</sup>.

Tipi i banesës ndryshon sipas fshatrave, por dhe sipas fuqisë ekonomike të banorëve. Në Devollin e Sipërm mbizotëron banesa prej guri (kryesisht prej shtufi) me dy kate, rrallë dhe me tri kate, e mbuluar me rasa guri, ndërsa në Devollin e Poshtëm gjenden shtëpi të ndërtuara me gurë dhe me plitharë (tullë balte e tharë në diell), por që janë të mbuluara me qeramidhe (tjegulla)<sup>31</sup>.

Në këtë krahinë bie në sy arkitektura e kishave të vjetra (kryesisht të fundit të shek XIX dhe fillimit të shek. XX), të cilat janë të ndërtura me blloqe guri të gdhendura, me shtylla guri e me kapitete të zbukuruara me motive floreale dhe me afreske murale që kanë një bukuri të veçantë. Një nga më të bukurat është kisha e Shën Kollit në fshatin Hoçisht.



### **Kisha e Shën Kollit në fshatin Hoçisht**

Muzika e krahinës e Devollit, si pjesë e Toskërisë së Veriut, ka në bazë muzikën polifonike (me shumë zëra), por dhe këngë homofone të shoqëruara gjithmonë me vegla muzikore.

---

<sup>30</sup> Për tipin e banesës të dhënat janë mbledhur në terren nga banorët, si dhe nga dëshmitë e ndërtimeve të vjetra që ende ruhen. Megjithëse një pjesë e banorëve kanë emigruar, ata po rindërtojnë banesat e tyre duke ruajtur tiparet e banesës së vjetër (kjo vlen për banesat e ndërtuara me gur).

<sup>31</sup> Gjurmët e zejes së prodhimit të tjegullave dhe plitharëve janë ruajtur deri vonë (shekulli XX). Familja e Talurëve në Hoçisht prodhonte për fshatin dhe për fshatrat rreth e rrotull, por edhe në Menkulas gjendet toponimi “Qeramithana”, sepse aty dikur ka pasur punishte të prodhimit të tullave.

Ndër vallet veçohet devolliçja, si valle burrash, (megjithëse ka pasur raste që është kërcyer dhe nga gratë), me ritëm të shpejtë dhe mjaft e gjallë, çka lidhet ngushtë me karakterin bujqësor të krahinës. Mënyra e tërheqjes së këmbës në këtë tip valleje mendohet se simbolizon punimin e tokës. Në këtë krahinë mungojnë vallet luftarake mjaft të njohura në zonën veriore të Shqipërisë. Këtu bën përjashtim një valle, që quhet kasapçe dhe kërcëhet pa armë (është kërcyer në Kapështicë)<sup>32</sup>, që, më tepër se një motiv luftarak, mund të përbëjë një motiv flijimi në dobi të ringjalljes (ajo lidhet më shumë me ritet e flijimit). Po ashtu, është e njohur vallja kaçakçe që kërcëhet në fshatrat Hoçisht dhe Gracë. Edhe kjo është një valle që kërcëhet pa armë, por në lëvizje të kujton veprimet e kaçakëve. Karakteristikë e valleve të grave është ritmi i qetë dhe mjaft i rregullt i lëvizjeve të tyre. Më e njohura nga vallet është vallja dardhare ose vallja e Isuf Arapit, e cila lidhet me historinë e një kapedani kaçakësh, për nder a frikë të të cilit vajzat dardhare kërcyen një valle të kënduar për të qetësuar trimin e çartur, kapedan Isuf Arapin. Në tërësinë e vet, vallet e krahinës së Devollit janë kryesisht me shumë valltarë që lidhen në varg, çka dëshmon për karakterin miqësor dhe mjaft tolerant të banorëve të kësaj krahine.

Veglat muzikore më të përdorura janë ato idiofone (gërgërja, kërcaçka, xilkat), kordofone (si ungari që sot nuk përdoret, por dëshmitë për të i gjejmë në këngët folklorike të mbledhura në Devollin e Sipërm: *Mblidhuni o shokë,/ t'i bijem ungarit,/ të na mblidhen çupkat/ si dhentë pas barit*<sup>33</sup>; buzuku etj. Gjithashtu, në fshatrat e Devollit të Sipërm, këndoheshin serenatat që nga fundi i shekullit XIX të shoqëruara me kitara dhe mandolina, vegla aerofone (si shtambushka ose bardhaçka, bilbilka, pizga, gajdja e mirëfilltë, gërneta etj.).<sup>34</sup>

Në Devoll ende janë të gjalla këngët që lidhen me festa e rite të ndryshme fetare apo pagane, si: Kolendrat, Rusicat, Llazole, Të lidhurat, Sulltan Novruzi, Shën Vangjelizmoi, Shën Gjergji, Shën Gjini, Pashkët, festat me të lusura (që lidhen me kremtimin e shenjtit që quhej si mbrojtës i familjes)<sup>35</sup> apo me rite pagane, si: Dita e Verës, Festa e Luleve, këngët për shiun etj.<sup>36</sup>

---

<sup>32</sup> R. Sokoli, Gjurmime folklorike, Tiranë, 1981, f. 223.

<sup>33</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987, f. 83.

<sup>34</sup> Po aty.

<sup>35</sup> V. Xhaçka, Disa zakone në festa kalendarike popullore në Devoll, BUSSHT, SSHSH, nr. 3, 1956, si dhe nga materialet e mbledhura prej nesh në Grapsh, Vërlen, Ziçisht etj.

<sup>36</sup> Po aty.

## 1.2 Rreth prejardhjes së emrit “Devoll”

Historia e emrit të Devollit është mjaft e ndërlikuar. Nëse vendodhja e tij si qytet ende nuk është përcaktuar saktësisht, po aq dyshime ka dhe për etimologjinë e emrit. Fakti që ky emër haset si toponim i trefishtë: si emër qyteti, lumi e rrethi, e bën të vështirë të dallohet nëse ai fillimisht ka qenë hidronim apo oikonim.

Në dritën e dëshmimeve historike dhe arkeologjike, Devolli është një emër që dëshmohet diku nga shekulli II (e. s.). Si qytet për herë të parë është përmendur nga Ptolemeu, “Deabolis” (*Δηβολία*). Sipas këtij gjeografi të njohur grek, ka ekzistuar një qytet i fisit ilir të Eordejve, i quajtur “Divolia”, buzë lumit Eordakus (sipas të gjitha gjasave lumi Devoll i sotëm).



Harta e Ptolemeut<sup>37</sup>

Sipas kësaj harte, që mendohet se mund të jetë një riprodhim i hartës së Ptolemeut, fisi i eordejve shtrihet në një territor mjaft të gjerë, po të papërcaktuar qartësisht.

<sup>37</sup> Për variantin e plotë të kësaj harte shih në fund të punimit.

Sipas K. Paçit, eordejte banonin në Devollin e Poshtëm dhe në Shkumbinin e Mesëm, pak a shumë ku ndodhet sot fusha e Korçës<sup>38</sup>. Në Mesjetë emri paraqitet në variante të ndryshme fonetike. Qyteti i Devollit përmendet që në krisobulën e parë të perandorit Vasil II, si qytet i varur nga eparhia e Kosturit. Në letrat e Theofillaktit<sup>39</sup> thuhet se deri në kohën e tij Devolli ishte seli e eparhive të pavarura<sup>40</sup>. Nga vepra e Gjergj Kedrenit<sup>41</sup>, i cili kopjoi me besnikëri veprën e Jan Skilices, thuhet se perandori Vasil II, me gjithë ushtrinë e tij, pasi la Ohrin, kaloi në liqenin e Prespës. Në malin ku kaloi ndërtoi një kështjellë, të cilën e quajti “mbretëreshë” dhe një tjetër në po këtë liqen: “Prej Prespës shkoi në të quajturin Deabol, ku mbi një fron të lartë, që u ngrit, priti Prusianin dhe të barabartët e tij, të cilët i qetësoi me fjalë të buta dhe të njerëzishme.”<sup>42</sup> Te Vazhduesi i Jan Skilices<sup>43</sup> përmendet se Devolli ka qenë një qendër e rëndësishme në shekullin X (e. s.) dhe ka pasur patric dhe prokonsull Theognost Vurcin.

Po me këtë emërtim e përmend dhe Pukëvili, i cili, kur përshkruan rrugën e lumit Eribea, thotë se ky lumë që buron nga malet Kandavian, pasi kalon nën fshatin Helmës (fshat që ndodhet dhe sot në rrethin e Skraparit), “... bashkohet me Osumin që rrjedh pesë lega në malin Slobokoe, maja më e lartë e maleve Deabolis, tani Devoll”<sup>44</sup>

Te Ana Komnena<sup>45</sup> përmendet shpesh si emërtim qyteti: “Perandori (Aleksi I), duke ngritur kampin e tij rrëzë ngushticave dhe në Deaboli, pengonte ata që kishin ndërmend të kalonin tek *Boemundi...*” (VII, Lib.XIII, 196-206). Po sipas Ana Komnenës, ky qytet ndodhej rrëzë rrugëve të pakalueshme, gjë që e vërtetojnë dhe një sërë rrënojash me mure të larta që kanë qenë në fshatra dhe vende të krahinës së Devollit.

---

<sup>38</sup> V. Kamsi, Gjurmime në toponiminë mesjetare të Shqipërisë, Studime për nder të A. Xhuvanit, ASH, Tiranë, 1986, f. 40.

<sup>39</sup> K. Bozhori, F. Liço, Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, botim i ASH, Tiranë, 1975, f. 36.

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> Murg, i cili jetoi në shek. XI. Vepra e tij “Përmbledhje historish” fillon me krijimin e botës dhe arrin deri te perandori Isak Komneni (1057). Kjo vepër ka një rëndësi të veçantë se na jep të dhëna interesante mbi gjendjen në tokat shqiptare gjatë konfliktit bizantino-bullgar në kohën e Vasilit II.


<sup>42</sup> K. Bozhori, F. Liço, Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, botim i ASH, Tiranë, 1975, f. 36.

<sup>43</sup> Dokumenti që përmendet këtu është një nga dorëshkrimet që pasqyron ngjarjet deri në vitin 1079, ndërkohë që Skilice e mbyll kronikën e tij deri më 1057. Kështu është menduar se ka qenë dikush tjetër, të cilin Moravçiku e quan Joannes Skylitzes Continuatus, që i ka vazhduar kronikat. (Byzantinoturcica, 340, në Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, botim i ASH, Tiranë, 1975, f. 63).

<sup>44</sup> F. Pukëvil, Në oborrin e vezirit të Janinës, Horizont, Tiranë, 2000, f. 135.

<sup>45</sup> Ana Komnena (1083-1148), vajza e perandorit Aleks I Komnenit, shkroi veprën e saj “Aleksiada” me dy vëllime, ku jep shumë të dhëna interesante për krahinat, qytetet dhe fshatrat e Ilirisë së asaj periudhe (Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, botim i ASH, Tiranë, 1975, f. 125).

Në fakt, problemi i përcaktimit të vendndodhjes së këtij qyteti është mjaft i ndërlikuar. Duke nisur që nga Ptolemeu, ky qytet mbetet i papërcaktuar, përdërisa dhe shtrirja e fisit të eordejve buzë këtij lumi nuk dihet me saktësi. Dihet vetëm që ky fis zinte vend në jug të lynkestëve, të cilët gjendeshin në lindje të enkelejve, përtej liqeneve të Ohrit dhe të Prespës. Duke iu referuar toponimisë, disa studiues e vendosin këtë qytet në fshatin e sotëm Zvezdë, në juglindje të Korçës. Ky fakt ka dalë nga jetëshkrimi i peshkopit Mihal të Devollit në fillim të shekullit XII. Në të thuhet se qyteti i Devollit është quajtur Selasforos “dritëmbajtës”. Sipas studimeve të Th. Kacorrit, këtë e vërtetojnë dhe disa mbishkrime bullgare të periudhës bizantine. Në librin e Jordan Ivanovit gjendet shënimi: “u ndërtua dhe u pikturua ky tempulli i Zotit i nderuar prej të gjithë shenjtorëve kryepeshkopit të Kostandinopojës, Grigorit, folës i zoti, me ndihmën dhe shpenzimet e peshkopit të përndriturtë Devollit- *Selasforit*...”<sup>46</sup>



**Fragment nga mbishkrimi<sup>47</sup>**

Ndërsa në librin “Prespa”, të botuar më 1923 në Sofie, shkruhet për peshkopatën e Selasforit si peshkopatë më vete dhe në faqen 84 tregohet për kishën e Shën Akilit, e cila kishte marrë këtë emër nga Samuili, mbret bullgar në vitet 980-1014. Brenda absisës së kishës janë shkruar në greqisht emrat e 18 peshkopatave, midis tyre dhe Selasfori<sup>48</sup>.

<sup>46</sup> Th. Kacorri, Mbishkrime sllavo-bullgare në ndihmë të historisë shqiptare”, Tempulli, I, Korçë, 2000, f. 26.

<sup>47</sup> Po aty.

<sup>48</sup> Po aty, f. 23.

1.	. . . . .	. . . . .	. . . . .
2.	θρόν(ος)	π... πεδ...	престолъ . . . . .
3.	† θρόν(ος)	π. Βιδήγη	" Видински
4.	† θρόν(ος)	Κεφαλονίας	" Главнички
5.	θρ(όνος)	π. Βερ...ίας	" Берски
6.	† θρόν(ος)	πο Ήρακλ...	" Βιτολски (Иракл.)
7.	θρ(όνος)	π Β...νδ...ς	" Велбуждски (?)
8.	(θρόνος)	π . . . .	" . . . . .
9.	θρόν(ος)	Σελασ...	" Селасфорски (Селасфорски)
10.	(θρόν)ος	π8 Σκωπίων	" Скопски
11.	† θρόν(ος)	πο Σαρδικής	" Србдешки
12.	θρό(νος)	π8 έδρου (?)	" . . . . .
13.	θρό(νος)	π8 ιρσις (?)	" . . . . .
14.	† θρόν(ος)	. . . . .	" . . . . .

### Fragment nga emërtimet e peshkopatave<sup>49</sup>

Këtë fakt e përmend dhe W. M. Liku, i cili thotë: “Peshkopi i Deabolisit (në pjesën e Shqipërisë që sot quhet Devoll), i ftoi nga Italia frankët dhe ata përbënin një pjesë të po atyre normanëve, të cilët pas pak kohësh u sollën shumë shqetësime perandorëve grekë.”<sup>50</sup>

Burimet tregimtare nga studiuesi J. G. Hani tregojnë se në shekullin IX, me përhapjen e fiseve maqedono-bullgare, kjo trevë ku lulëzoi dhe qyteti i hershëm mesjetar Selasfor-Devoll përfshihej në krahinën e quajtur Kutmiçevica.<sup>51</sup> Në Kodikun e Korçës dhe Selasforit, në një dokument të vitit 1677, thuhet se: “Kodikun i Mitropolisë së Shenjtë të Korçës dhe Selasforit, në kohën që ishte ekzark dhe patrik shumë i lumturi dhe shumë i dituri arkipeshkop i Justinianës Parë të Ohrit zoti Partheni nga Korça; iu bë dhuratë shpirtërore prej tij mitropolisë së shenjtë.” Po ashtu, emërtimin Devoll i Sipërm dhe dhe Devoll i Poshtëm e hasim në testamentin e Andrea Muzakës<sup>52</sup>.

Po cila mund të jetë etimologjia e këtij emri? Për këtë duhet t’u referohemi trajtave fonetike që paraqet ky emër në rrjedhën e kohës dhe ligjësi që kanë vepruar në gjuhën shqipe për të arritur në trajtën e sotme fonetike.

<sup>49</sup> Po aty, f. 24.

<sup>50</sup> W. Martin-Leak, Kërkime për shqiptarët dhe gjuhën shqipe, Përkth. Xh. Lloshi, Bota shqiptare, Tiranë, 2006, f. 134.

<sup>51</sup> P. Pepo, Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore (shek. XVIII-XX), Kodiku i Korçës dhe Selasforit, Tiranë I, 1981, f. 26.

<sup>52</sup> Ch. Hopf, Chronique Greco-romane inedite ou peu connues ..., përkth. Robert Elsie, Berlin, 1873.



Në hartën e Ptolemeut trajta fonetike e emrit është “*Δήβολία*” dhe përmendet për herë të parë si qytet. Trajta fonetike e Ptolemeut është mjaft e ngjashme nga përbërja tingullore me trajtën e sotme. Jireçek<sup>53</sup> thekson se ky është një emërtim qyteti, i cili, më pas i ka kaluar lumit, por transkriptimi i emërtimit të Ptolemeut është jo i saktë, përderisa në atë kohë /β/ e greqishtes ishte kthyer me kohë në /v/.<sup>54</sup>

Sipas Mlladenovit<sup>55</sup> toponimi fillimisht mund të ketë qenë substrat hidronimi me rrënjë trakase Dev-ula (dheë-ula), me kuptimin “rrjedh”. Por nga ana tjetër, sipas Vojnikovit<sup>56</sup> toponimi mund të jetë me burim nga protobullgarishtja (gjuhë ugro-fine), duke e lidhur këtë me semantikë paralele me iranishten deō-diēol me kuptimin “mur”, për analogji dhe me rrënjën indoevropiane të trakishtes dava-deva (fortesë, qytet). Studiuesi A. Majer, duke mbështetur tezën e kalimit të emërtimit të këtij qyteti që ndodhej në Ilirinë Jugore, pranë lumit me të njëjtin emër (që sipas tij e kishte marrë nga qyteti i lartpërmendur), pranon një ndërmjetësi të sllavishtes së vjetër Devolb<sup>57</sup>.

Selishçevi<sup>58</sup>, po ashtu, pranon se emri i lumit vjen nga emri i qytetit të përmendur nga Ptolemeu dhe e rendit atë midis emrave të lumenjve të mëdhenj të Shqipërisë që sllavët i morën “... nga popullsia që gjetën aty ose në viset fqinjë”. Ai shton se “...në burimet bizantine lumi dhe qyteti *Δήβολ* jepen kështu: *Δήβολις; τήν Δήβολιν; τή Δήβολιν*”, pa përmendur ndonjë ndërmjetësi sllave lidhur me të. Ndërkohë, kur ai bën fjalë për reflektimin e /l/ në disa toponime sllave si Bellovoda, Gllava, ai përmend dhe *Deωoll-Deωoι*, duke nënkuptuar kështu këtë ndërmjetësi sllave. Në dëshmitë e Ana Komnenës hasim një devijim semantik ku trajta fonetike (*ποταμεος Δήβολεος*) jepet si flumen Diaboli- lumi i Djallit.

Duke iu referuar historianit që ka jetuar në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, Kostandin Jireçek, Th. Kacorri vë në dukje se në leksionet e tij të mbetura në dorëshkrim me titull “Thema e Durrësit”, vetëm sa thotë se Devolli i lartpërmendur që në shekullin XII (Selasfor) ndodhet në Korçë që më 1490.<sup>59</sup> Nëse e vërejmë me kujdes emërtimin në dorëshkrim,

<sup>53</sup> Sh. Demiraj, Rreth disa hidronimeve të lashta, SF, nr. 4, 1999, f. 27.

<sup>54</sup> Po aty.

<sup>55</sup> Dh. Bello, R. Damo, Mbi vendndodhjen e Devollit nën dritën e toponimisë, Takimi II IASH, sesioni i Albanologjisë, Tiranë, 2008.


<sup>56</sup> Po aty.

<sup>57</sup> Sh. Demiraj, Rreth disa hidronimeve të lashta, SF, nr. 4, 1999, f. 27.

<sup>58</sup> Po aty.

<sup>59</sup> Th. Kacorri, Mbishkrime sllavo-bullgare në ndihmë të historisë shqiptare, Tempulli, I, Korçë, 2000, f. 28.

Jireçeku vë shenjën e barazimit midis fjalës Lucifer, që është përkthimi latinisht i Selasfor, dhe Diaboli dhe Debol, duke u bazuar ndoshta në këtë lloj devijimi semantik që është bërë qysh në dëshmitë e Ana Komnenës. Një shpjegim i tillë do t'i shkonte për shtat karakterit të rrembyeshëm të këtij lumi, i cili buronte nga malet dhe përmbyste tokat e krahinës.



**Fragment nga dorëshkrimi i leksionit të Kostandin Jireçek<sup>60</sup>**

Te V. Kamsi hasim një sërë trajtash fonetike të përmendura gjatë Mesjetës, si: Deaboli, Deabolis, Deebu (1273), Deavois, Dievolis, Euali (1351, 1367), Drevale, Jevali (1360, 1363),

<sup>60</sup> Fragmenti është marrë nga Th. Kacorri, Mbishkrime sllavo-bullgare në ndihmë të historisë shqiptare, Tempulli, I, Korçë, 2000, f. 30.

Dievali (1344, 1347, 1359), Devoli (1380)<sup>61</sup>. Ky studiues e vendos këtë si emërtim të një skele tregtare në lumin Seman. Faktin që banorët e sotëm e përdorin emërtimin topik Dell për shtratin e tharë të lumit, i cili ndodhet afër brigjeve të Semanit, e shpjegon si një kalim fonetik Deabolis>Deebolis>Deell>Dell, duke theksuar se ka një rënie të mbylltores b, pra një zgjatje të zanores në trup të fjalës, rrjedhim i natyrshëm për gjuhën shqipe.<sup>62</sup> Për E. Çabejin emri Devoll i përket shtresës parasllave, bashkë me emrat e Matit dhe të Bunës.<sup>63</sup> Ai thekson se në gjuhët e lashta të Ballkanit, që vijnë ngushtësisht të afërta me shqipen, ky toponim i trevës ilire jugore lidhet me numërorin dy në trajtën fonetike di (*Διβολία* -me burim nga ilirishtja).

Nëse shohim emërtimin si me burim vendës, grek, latin apo sllav, së pari duhet gjetur vjetërsia e këtij emërtimi për të përcaktuar më pas se çfarë ligjësisht fonetike kanë vepruar deri në trajtën e sotme. Si qytet, Devolli përmendet që në shekullin II e. s., më pas krijohet një shkëputje dhe ai përmendet rreth shekullit XIII. Pushtimi turk e ka gjetur plotësisht të shkatërruar këtë qytet. Lidhur me idenë e emërtimit të Devollit si “lumi i djallit”, fjala djall është me burim të diskutuar. Fakti që Devolli është një qytet jo fort i lashtë, sipas Thumbit, mund të lidhet me futjen e kësij emri si huazim i greqishtes së vjetër i marrë pas epokës latine, ndërkohë që G. Majeri, Pedersen e Mikloshiçi janë për një rrjedhojë nga latinishtja.<sup>64</sup>

Duke u nisur nga pohimi i Selishçevit se sllavët e morën emrin nga popullsia që gjetën, mund të arrihet në përfundimin se kjo popullsi duhet të ketë folur ilirisht, latinisht ose greqisht. Sipas Sh. Demirajt, nëse do kishim një popullsi që mund të ketë folur greqisht, grupi /li/ vështirë të ketë dhënë /l/.

Po sipas tij, po t'i përmbaheshim tezës se në këto territore përdorej latinishtja, grupi /li/ s'mund të ketë dhënë /l/. Ndërkohë, në gjuhët sllave, ky grup nuk mund të gjendet para zanoreve të përparme /i/, /e/, /j/.<sup>65</sup>

Gjithashtu, në gjuhët sllavo-jugore, në pozicion fundor /l/ alveolare apikale ka dhënë ose bashkëtingëllore të lëngët /lj/, si tipar i protosllavishtes, ku /l/ para një zanoreje të përparme shqiptohet “e butë”, ose bashkëtingëllore të fortë /l/, e ndjekur nga një zanore e prapme. Sipas këtij arsytimi, ky emërtim nuk mund të jetë me ndërmjetësi sllave, aq më tepër kur në fjalët e

<sup>61</sup> V. Kamsi, Gjurmime në toponiminë mesjetare të Shqipërisë, Studime për nder të A. Xhuvanit, ASH, Tiranë, 1986. Ndërkohë ai thekson se mund të shtohet dhe emërtimi Leualli, siç del në disa harta të shekullit XVI, ku ndihet ndikimi i qartë i italishtes Le valli-luginat. f. 464.

<sup>62</sup> Po aty.

<sup>63</sup> E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes III, botim i ASH, Tiranë 1981, f. 369.

<sup>64</sup> Po aty, f. 258.

<sup>65</sup> Sh. Demiraj, Rreth disa hidronimeve të lashta, SF, nr. 4, 1999, f. 28.

trashëguara dhe huazimet latine, /l/, në pozicion ndërzanor, ka dhënë rregullisht /l/ dhe kur është ndodhur para zanoreve të përparme (molinum> mulli, oliva> ulli)<sup>66</sup>.

Ruajtja e bashkëtingëllores /v/ ndërmjet dy zanoreve përligjet nga fakti që ky emërtim ka zëvendësuar një emërtim më të vjetër, por jo që t'i përkasë greqishtes së vjetër, si rrjedhim, bashkëtingëlloret e zëshme ndërzanore janë ruajtur.

Gjithsesi, megjithë përpjekjet e shumta që janë bërë për shpjegimin e etimologjisë së këtij toponimi, si dhe faktit që trajta e vjetër ka ngjashmëri të madhe fonetike me trajtën e sotme, emërtimi Devoll tregon për një qëndrueshmëri të theksuar gjuhësore, e cila mund të ketë ardhur qoftë si rrjedhim i një vazhdimësie të së njëjtës popullsie në këto territore, qoftë si rrjedhim i ruajtjes së gjendjes së vjetër të të folmes, sidomos në zonat malore, të cilat kanë prirje të theksuar ndaj konservacionit gjuhësor, pavarësisht lëvizjeve të mëdha migratore.

Fakti që ende nuk dihet me saktësi vendndodhja e qytetit të vjetër të Devollit (afër qytetit të Korçës, në fshatin Mborje, në Zvezdë apo në zonën ku sot shtrihet krahina e Devollit) lë të hapur mundësinë e hulumtimeve të dëshmimeve dhe burimeve historike. Megjithatë, duhet vënë në dukje se e gjithë krahina ka qenë nga më të zhvilluarat në trojet shqiptare, si nga pikëpamja ekonomike, ashtu dhe nga pikëpamja kulturore. Si e tillë, ajo ka lënë gjurmët e saj në traditat dhe historinë shqiptare, është studiuar për veçoritë e saj etnofolklorike, por ende përbën një krahinë me interes për studimin e dukurive që lidhen me veçoritë e të folmes së saj.

Edhe punimi që po paraqesim si tezë doktrate është një përpjekje për të nxjerrë më në pah disa nga veçoritë gjuhësore dhe etnofolklorike që lidhen ngushtë me historinë, kulturën dhe mënyrën e jetesës të kësaj krahine.

---

<sup>66</sup> Sh. Demiraj, Rreth disa hidronimeve të lashta , SF, nr. 4, 1999, f. 28.

## **2. E FOLMJA E DEVOLLIT BRENDIA NDARJES DIALEKTORE TË SHQIPES**

### **2.1 E folmja e Devollit si pjesë e toskërishtes veriore**

Dialektet, si kategori historike, kanë lindur në kushte të caktuara të zhvillimit të shoqërisë. Ato kanë pësuar dhe pësojnë ndryshime në rrjedhë të kohës. Këto ndryshime kanë qenë të pranishme qysh në kohë të hershme, por gjurmët e tyre treten në vite. Ato mund të zbulohen vetëm në dëshmi të shkruara të dialekteve, si dhe në veprimin e ligjësisve të brendshme të zhvillimit fonetik dhe gramatikor të tyre. Sot, në të folmet e shqipes, në një vështrim diakronik të dialekteve në përgjithësi dhe të të folmeve në veçanti, dallojmë kryesisht tipare që kanë lindur gjatë mesjetës dhe një numër të vogël tiparesh që vijnë prej periudhës së vonë antike.


Tiparet dalluese më të hershme janë ato që ndajnë dy dialektet dhe kanë shtrirje të plotë në territoret përkatëse të secilit dialekt. Vetëm ndonjë tipar i hershëm haset në grupe të folmesh me territore shumë të kufizuara. Tiparet dalluese më të reja u përkasin dy, tre apo katër shekujve të fundit dhe kanë shtrirje të ndryshme gjeografike. Disa prej këtyre tipareve, duke u përhapur, janë bërë tipare të një dialekti duke iu mbishtresuar tipareve dalluese të hershme, por pa arritur të marrin të gjitha të njëjtën shtrirje të plotë në truallin e dialektit të tyre. Disa prej tyre kanë marrë një shtrirje më të kufizuar, por njëkohësisht kanë kapërcyer kufijtë gjeografikë për shkaqe të ndryshme. Kështu, këto tipare të veçanta, janë bërë tipare dhe për disa të folme të dialektit tjetër.

Dy sistemet e mëdha dialektore shqipe ndahen në Veri dhe në Jug të Shqipërisë. Kufiri i përfaqësuar gjeografik i ndarjes së këtyre dialekteve është lumi Shkumbin. Në të djathtë të këtij lumi shtrihet dialekti geg, ndërsa në të majtë ai tosk.

Theksojmë se Shkumbini është kufi i përfaqësuar gjeografik, sepse midis dy dialekteve, më tepër përgjatë krahut të majtë të Shkumbinit, janë formuar disa të folme kalimtare me përzierje të tipareve të qenësishme të toskërishtes e të gegërishtes. Në disa nga këto të folme, si shtrat është toskërishtja e, në disa të tjera, gegërishtja. E. Çabej thekson se: “Në pikëpamje gjuhësore nuk vëhet re kurrkund ndonjë kufi: midis dy dialekteve shtrihet nga perëndimi në lindje, ku më i gjerë

e ku më i ngushtë, një brez ligjërimesh kalimtare, në të cilat dalin krah për krah tipare të toskërishtes dhe të gegërishtes.”<sup>67</sup>

G. Hani<sup>68</sup> është i pari që ka bërë një ndarje të dialekteve mbi bazën e ndarjes territoriale të Shqipërisë në antikitet, në mbretërinë e Ilirisë dhe në atë të Epirit. Duke iu referuar një shënimi të Strabonit<sup>69</sup> ai thekson se Shkumbini është kufi territorial si për ndarjen krahinore dhe për atë dialektore. Kjo ndarje territoriale, e cila përkon me periudhën e vonë antike, shpie në përfundimin se ndarja dialektore ka filluar të bëhet në atë kohë. Sipas të dhënave historike, një shpjegim i tillë do t'i binte ndesh faktit se Epiri arrinte në Veri deri te bregu i majtë i Vjosës dhe përfshinte një territor tepër të ngushtë në krahasim me atë të toskërishtes së sotme.



**Harta 1. Shtrirja e territoreve ilire<sup>70</sup>**

<sup>67</sup> E. Çabej, Për historinë e strukturës dialektore të shqipes, BSHSH, SSHSH, nr. 4, 1956, f. 429.

<sup>68</sup> J. G. Hahn, Studime shqiptare, Bota shqiptare, Tiranë, 2007, f. 27.

<sup>69</sup> Shënimi i Strabonit, i cituar nga Hani, thekson se fiset epirote dhe ilire ndodhen përkatësisht në të dhjathtë dhe në të majtë të rrugës Egnatia, që shkon përgjatë rrjedhës së Shkumbinit (“Studime shqiptare”, f. 27).

<sup>70</sup> Grup autorësh, ADGJSH I, L’Universita degli Studi di Napoli L’Orientale, 2008, f. 57.

G. Majeri, duke pasur parasysh shqipen që flitet në Greqi, e sheh ndarjen dialektore në një periudhë më të vonë.<sup>71</sup> Duke u shtyrë përpara në kohë, në shekujt I-IV të erës sonë, mund të përqasen territoret e disa ndarjeve të tjera dialektore. Kështu, të folmet e gegërishtes jugore dhe ato të toskërishtes veriore shtrihen sot në territorin e provincës Makedonia (shek. I-III e.s.) dhe Epiri i Ri (shek. IV-VI e.s.)<sup>72</sup>.

Dialektet, si degëzime gjuhësore të lidhura me ndarjen territoriale, lidhen ngushtë dhe me një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me kulturën shpirtërore dhe materiale të këtyre territoreve. Në qoftë se dialektet vështrohen dhe trajtohen thjesht dhe vetëm nga pikëpamja gjuhësore, nuk mund të përvijonim një pamje të plotë të ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet tyre. Janë kushtet historike, shtrirja gjeografike e tyre, një sërë rrethanash etnografike që lidhen ngushtë me mënyrën e jetesës, shijet, besimet pagane e fetare, marrëdhëniet me kulturat e fqinjëve të së njëjtës kombësi, por dhe të popujve që flasin gjuhë të ndryshme në kufi me ta, të cilat kanë ndikuar në një diferencim të dukshëm të dialekteve të shqipes.

Duhet theksuar se dallimet dialektore në gjuhën shqipe janë të tilla që nuk ndikojnë në të kuptuarit e ndërsjellë të përdoruesve të dialekteve përkatëse, ndryshe nga mendimi i shprehur nga J. G. Hani se: “Toskë dhe gegë nuk merren vesht shoq me shoq, ose me shumë zor në qoftë se nuk e dijnë dialektin e huej dhe u duhet disa kohë sa ta mësojnë.”<sup>73</sup>

Sipas J. Gjinarit: “Ndryshimet që ka pësuar gjuha shqipe gjatë zhvillimit të vet nëpër territore të ndryshme nuk kanë çuar në krijimin e varianteve dialektore me dallime shumë të thella, ndryshe nga ajo që ka ndodhur në disa gjuhë të tjera të Evropës”.<sup>74</sup>

Shkalla e madhe e njësisë që përshkon tejendanë dialektet e gjuhës shqipe nuk shfaqet vetëm nëpërmjet tipareve që janë krejtësisht të përbashkëta nga forma dhe nga përmbajtja (d.m.th. si nga shprehja tingullore dhe struktura ashtu dhe nga ana funksionale), por ajo duket dhe më shumë në tiparet dalluese që janë shfaqur në vijën e prejardhjes së gjuhës dhe në shfaqjet e saj në planin sinkronik.

Duke e parë të folmen e Devollit në lidhje me tiparet e përbashkëta ndërmjet dy dialekteve, vihet re se në këtë të folme shfaqet, në rrafshin fonetik, sistemi i njëjtë i fonemave zanore të shkurtra gojore dhe bërthama e njëjës e sistemit të fonemave bashkëtingëllore.

---

<sup>71</sup> E. Çabej, Për historinë e strukturës dialektore të shqipes, BISH, SSHSH, nr. 4, 1956, f. 433.

<sup>72</sup> Për më gjerë shih sythin 1.1.2. të këtij punimi.

<sup>73</sup> J. G. Hahn, Studime shqiptare, Bota Shqiptare, Tiranë, 2007, f. 27.

<sup>74</sup> J. Gjinari, Struktura dialektore e shqipes e parë në lidhje me historinë e popullit, SF, nr. 3, 1976, f. 130.

Në vijë diakronike fondi i lashtë, i trashëguar nga indoevropianishtja, në rrafshin fonetik shfaqet në reflekset th/[θ], dh[ð] dhe d si dhe të grykoreve qiellzore *k'*, *g'*, në reflekset s, z të grykoreve labiovelare *k<sup>w</sup>* *g<sup>w</sup>* të ndjekura nga i dhe e, në refleksin a të o-së së shkurtër, në monoftongimin e diftongjeve si dhe në reduktimin e shumë grupeve të bashkëtingëlloreve.<sup>75</sup> Ky njësim i përshkon dialektet edhe në zhvillimet e brendshme që ka pësuar shqipja pas fazës indoevropiane. Kjo duket te prirja e përbashkët e të dy dialekteve në reduktimin e zanoreve në rrokje të patheksuar (në të folmen e Devollit vihet re në reduktimin e ë-së patheksuar në disa pozicione), në theksin dinamik dhe rregullimin mekanik të theksit (i dallueshëm në të folmen e Devollit te disa huazime turke), në diftongimin e zanoreve në rrokje që mbyllet nga një bashkëtingëllore e tingullt (fton>ftua, del>diell, fel>fyell), në ndërrimin fonetik a>e (metafonia) (dal-del, mar-mer).

Në rrafshin morfologjik, tiparet e përbashkëta lidhen me krijimin e kundërvënies gramatikore trajtë e shquar//trajtë e pashquar, strukturën e formimit të përemrave pronorë, e ardhmja me do+lidhore, trajtimi i njëjtë i elementeve të huazuara nga greqishtja, latinishtja, sllavishtja e turqishtja.

Dukuri më të reja si qiellzorëzimi i grykoreve pas zanoreve i dhe e (miki>miq, zogi>zogj), bashkë me këto dhe zhvillimi i grupeve kl dhe gl në q dhe gj përfshihen në zhvillimet e mëvonshme që i përkasin kryesisht periudhës mesjetare. Gjithsesi, duhet vënë në dukje se disa shekuj më parë (deri në shekullin XV kur u shfaqën shkrimet e para të shqipes), pavarësisht ndarjes së dialekteve, nga studimi i autorëve të vjetër shqiptarë, në disa prej dukurive gjuhësore vihen re më shumë pika të përbashkëta sesa dallime.<sup>76</sup> Këto pika të përbashkëta pasqyrohen dhe në gjendjen e sotme të dialektit, sidomos në të folmen e Devollit. Ky njësim gjuhësor ka shkuar krah për krah me njësimin shpirtëror dhe kulturën materiale (guna, fustanella, vallja me përmbajtje plastike, tipi asimetrik i valles, trehapshi i dyzuar). Megjithë ndarjen territoriale të mënyrës së të kënduarit (homofonia në veri të Shkumbinit dhe polifonia në jug të tij), shtrirja e polifonisë në një territor shumë të gjerë, si në Kalabri, Sicili e deri në Kaukaz, tregon për një shtrirje të hershme të kësaj dukurie në të gjitha viset mesdhetare. I parë në këto lidhje, veçimi i dialektit jugor të shqipes që në kohë relativisht të hershme u shtohet të dhënave të toponimisë,

<sup>75</sup> J. Gjinari, Struktura dialektore e shqipes e parë në lidhje me historinë e popullit, SF, nr. 3, 1976, f. 130.

<sup>76</sup> E. Çabej u referohet L. Matrëngës në Jug (1592, Siçili) dhe Gj. Buzukut (1555) në Veri ("Për historinë e strukturës dialektore të shqipes", BISH, SSHSH, nr. 4, 1956, f. 434).



arkeologjisë, historisë dhe etnografisë për një shtresëzim vendës të shqiptarëve dhe gjuhës së tyre në trojet e sotme.

Gjithsesi, midis ligjërimeve toske dhe gege, ka një varg dallimesh, të cilat, përfshijnë, ku më shumë e ku më pak, të gjitha sistemet dhe nënsistemet e gjuhës. Sigurisht, dialektet dallohen në një sërë tiparesh të qenësishme, të cilat kanë shtrirje të caktuar gjeografike. Këto tipare shtrihen kryesisht në rrafshin fonetik dhe leksikor, por nuk mungojnë dhe në sisteme të tjera të gjuhës.

Përsa u përket dallimeve dialektore në rrafshin fonetik, e folmja e Devollit, si pjesë e toskërishtes, shfaq një sërë tiparesh që lidhen kryesisht me sistemin e fonemave zanore dhe më pak me sistemin e fonemave bashkëtingëllore. Këto tipare duken në:

- 1) Mungesën e serisë së zanoreve hundore në këtë të folme. Kështu, në të folmen e Devollit mungon kundërvënja zanore hundore//zanore gojore, që është tipar karakteristik i gegërishtes. E folmja e Devollit ka vetëm shtatë zanore gojore.
- 2) Në të folmen e Devollit ruhet mjaft qartë zanorja ë në serinë e zanoreve të theksuara, ndërkohë që në gegërishte asaj i përgjigjet një â hundore (bënj-bâj, lëmë-lâmi, tënde-tâne, lëndë-lâ:n). Prania e zanores ë në gjuhën shqipe është një dukuri ballkanike (ajo është e pranishme dhe në rumanishte dhe bullgarishte), e cila shfaqet në të dy dialektet, por me zhvillime të ndryshme.<sup>77</sup> Ndërkohë që në dialektin geg ajo del vetëm në rrokje të patheksuar ku pëson reduktim deri në rënie të plotë, në dialektin tosk ajo del si në rrokje të patheksuar dhe në rrokje të theksuar. Në rrokje të patheksuar zanorja ë del në pozicion paratheksor (lëpjetë, lëçoj, i lëmpitë) dhe në pozicion pastheksor, kryesisht në pozicion fundor<sup>78</sup>. Rëgjimi zanores ë është një dukuri që ka përfshirë dhe dialektin e jugut, përkatësisht dhe të folmen e Devollit, ndërsa në rrokje të theksuar ajo gjendet vetëm në toskërishte dhe në këtë të folme dallohet qartë (bënj, llagëm, gjilpërë, tërë). Gjuhësisht, lindja e zanores ë të toskërishtes, sipas J. Gjinarit<sup>79</sup>, shpjegohet me shndërrimin e â-së hundore si një zanore e prapme e buzorëzuar nëpërmjet humbjes së tiparit të hundorësisë dhe buzorëzimit, duke u ruajtur si një zanore më qendrore se a-ja dhe

<sup>77</sup> Në analizën që i bën pranisë së kësaj zanoreje në gjuhën shqipe Sh. Demiraj, duke iu referuar Mikloshiçit, thekson se ajo ka ardhur nëpërmjet substratit ilir në gjuhët ballkanike (“Gjuhësi Ballkanike”, f. 89-90).

<sup>78</sup> Në pozicion fundor zanorja ë del si një zanore fundore e temës e disa emrave femërorë të tipit: baltë, vajzë, te disa emra burimisht asnjans të tipit: brumë, gjalpë etj.

<sup>79</sup> J. Gjinari, Struktura dialektore e shqipes në lidhje me historinë e popullit, SF, nr. 3, 1976, f. 133.

pak më e mbyllur. Vetë fakti që sot areali i zanores ë shtrihet në jug të Shqipërisë deri në lumin Shkumbin, ku fillon areali i â-së hundore të gegërishtes, mund të na çojë në përfundimin se areali i kësaj zanoreje shtrihej në një zonë më të gjerë se e ajo e sotmja, që nga brigjet e Adriatikut dhe të Jonit e deri në brendësi të Gadishullit të Ballkanit, çka vërtetohet dhe me faktin që një ë e tipit të toskërishtes gjendet dhe në rumanishte dhe bullgarishte, dy gjuhë të degëve të ndryshme, por me nënshtrat të hershëm nga gjuhë dhe dialekte të Ballkanit.

- 3) Në të folmen e Devollit mungon plotësisht kundërvënia zanore të gjata//zanore të shkurtra, që është tipar i të folmeve të dialektit geg. Në këtë të folme janë karakteristike zanoret e shkurtra dhe të mesme.
- 4) Diftongut *ue* të gegërishtes i përgjigjet *ua* e toskërishtes (*luej-luanj*, e *due-e dua*).<sup>80</sup>
- 5) Grupit nistor *vo-* të gegërishtes, në toskërishte i përgjigjet grupi *va-* (**vojin-vajnë** e **kandiles**, **vo**trën-e ndezi **vatrën**, **vorr-var** etj.).
- 6) Në të folmen e Devollit, është mjaft i dallueshëm rotacizmi i n-së ndërzanore (freri, verën, lakrat, vura, bëra). Në lidhje me rotacizmin, nyjëtimi i labërguar i n-së ndërzanore kaloi fillimisht si variant i bashkëtingëllores n e më pas në dridhësen e tingullit r<sup>81</sup>. Rotacizmi ka përfshirë fjalët e vjetra anase (emër, zëri), disa huazime nga greqishja e vjetër (lakër), si dhe disa huazime nga latinishtja (mulliri)<sup>82</sup>. Fakti që rotacizmi nuk ka vepruar më vonë duket në disa huazime turke, si: *inat*, *iman*, *lanet*, *këna* etj.
- 7) Në toskërishte, përkatësisht në të folmen e Devollit, ruhen mjaft qartë grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*, ndërkohë që në gegërishte ato janë asimiluar në bashkëtingëlloren hundore përkatëse<sup>83</sup>. Fakti që këto grupe në shqipen paralettrare shfaqen në veprat e atyre që u quajtën shkrimtarë të Veriut (Buzuku, Bogdani, Budi), arsyetimi se ata i shkruan shpërthyeset pas hundoreve jo thjesht duke ndjekur

<sup>80</sup> Siç dihet, në një pjesë foljesh, në trajta të caktuara gramatikore, ky diftong është monoftonguar në o (të pagujaë-të pagojë)

<sup>81</sup> J. Gjinari, Struktura dialektore e shqipes në lidhje me historinë e popullit, SF, nr. 3, 1976, f. 133.

<sup>82</sup> Sh. Demiraj thekson se kjo dukuri përfundoi para depërtimit të sllavizmave, deri nga shek.VII-VIII (Gjuhësi Ballkanike, 2004, f. 93-94), ndërsa Çabej dhe Jokli e shtyjnë deri nga fundi shek. X, ndoshta dhe më vonë (Çabej thekson shprehimisht: “Me Norbert Joklin do të pranojmë që më të vjetrat huazime sllave të shqipes i janë shtruar në këtë gjuhë dhe nazalizimit dhe rotacizmit”, “Për historinë e strukturës dialektore të shqipes”, BISH, SSHSH, nr. 4, 1956, f. 436).

<sup>83</sup> Në disa raste, në të folmen e Devollit, në këto grupe ka ndodhur asimilim, por në të kundërt, në disa parafjalë është asimiluar plotësisht bashkëtingëllorja hundore.

një traditë shkrimi, por ato kanë qenë të pranishme dhe në të folmet e këtyre krahinave që i përfshinte gegërishtja, është logjik. Kjo na çon në përfundimin e E. Çabejt, që dallimet kryesore dialektore i përkasin kryesisht periudhës së Mesjetës<sup>84</sup>.

- 8) Po ashtu, ruhet qartë bashkëtingëllorja nj, si në pozicion ndërzanor (lanja, fshinja), ashtu dhe në pozicion fundor (ftonj, rëminj), kurse në gegërishte ajo ëshë kthyer në j.<sup>85</sup>
- 9) Në gegërishte, për një numër huazimesh, kryesisht nga turqishtja, ka ndodhur rregullimi mekanik i theksit (pra nga fjalë me theks fundor janë bërë me theks parafundor), ndërsa në toskërishte ato kanë ruajtur theksin fundor të gjuhës nga janë huazuar.<sup>86</sup>

Për lashtësinë e këtyre tipareve dalluese dialektore, të cilat ndajnë dy dialektet, nisur nga historia e brendshme e shqipes dhe nga gjurmët e marrëdhënieve të saj me gjuhë të tjera, mund të vihet në dukje se procesi i kalimit të â-së hundore në ë si dhe rotacizmi, ishin duke përfunduar andej nga fundi i periudhës antike, duke u përcaktuar si dy nga dallimet më të hershme midis dy dialekteve. Brenda shqipes kjo zbulohet nga fakti se këto procese kanë përfshirë fjalë të fondit vendës të shqipes dhe fjalë të huazuara nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja, por nuk ndihet në në fjalët e huazuara më vonë nga sllavishtja, greqishtja e mesme dhe e re, nga gjuhët neolatine dhe turqishtja. Këto dy veçori thelbësore, tregojnë diferencimin nga pikëpamja etnografike (kryesisht me dukuritë që lidhen me mënyrën e të kënduarit, polifoninë dhe homofoninë) të këtyre zonave, Toskërisë dhe Gegërisë.

Në sitemin morfologjik, në të folmen e Devollit, tiparet më të dallueshme përfshijnë kryesisht kategori të caktuara gramatikore të emrave dhe më tepër të foljeve. Te këto tipare përfshihen si dallime të plota, ashtu dhe të pjesshme.

Në lidhje me dallimet e plota, në inventarin e formave dhe kategorive gramatikore mund të përmenden:

- 1) Kategoria gramatikore e numrit shumës të disa emrave, të cilët në gegërishte dalin me prapashtesën trajtëformuese -a, në toskërishte dalin me -ë (doktora-doktorë, demela-dembelë), me -e (aure, puse, zjare). Megjithatë, mund të theksohet se kjo

---

<sup>84</sup> E. Çabej, Për historinë e konsonatizmit të gjuhës shqiptare, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1976. f. 35-37.

<sup>85</sup> Këtë dukuri e ka vënë në dukje J. Gjinari, si dukuri të izoluar në Progër, por ne e kemi hasur dhe në fshatra të tjerë ("Mbi të folmen e Devollit", BUSSH, nr. 4, 1960, f.109)

<sup>86</sup> Megjithatë në të folmen e Devollit vihen re të dyja dukuritë, shih më gjerë në sythin 3.3.1 të këtij punimi.

dukuri nuk përbën një tipar binar mungesor për këtë dialekt, sepse, po në të folmen e Devollit, gjenden emra që e formojnë shumësin me -a.

- 2) Përdorimi i numërorit tre për gjininë mashkullore dhe tri për gjininë femërore, formë që gjendet dhe në gegërishten jugore (kam tri ditë ktu).
- 3) Në toskërishten veriore, përkatësisht në të folmen e Devollit, mungojnë mbiemrat e formuar me prapashtesën -shëm të cilët tregojnë mundësi, aftësi (të tipit i punueshëm, i lexueshëm, i besueshëm)<sup>87</sup>. Për më tepër, në këtë të folme edhe mbiemrat e këtij tipi që kanë hyrë nëpërmjet ndikimit të gjuhës standarde, pësojnë ndryshime fonetike që lidhen me tiparet fonetike karakteristike për këtë të folme, duke shmangur shqiptimin e togut zanor ue apo ye (i besushmë, i shkëlqyshmë).
- 4) Në toskërishten veriore, përkatësisht në të folmen e Devollit, mungojnë përemrat dëftorë të përngjitur të tipit *nj'ai, qeky*, karakteristike për gegërishten.
- 5) Po ashtu, mungojnë format e mbipërbëra të foljeve, të cilat janë karakteristike për gegërishten (kam pas shkue).

Përsa u përket dallimeve të pjesshme, ato vihen re kryesisht në një sërë tiparesh gramatikore, të cilat lidhen kryesisht me emrin dhe me foljen dhe më pak me pjesët e tjera të ligjëratës. Këto dallime janë të pakta në numër dhe e folmja e Devollit paraqet disa forma tepruese (pra në këtë të folme ka një formë më tepër).

- 1) Në lidhje me gjininë e emrave midis dy dialekteve nuk ka dallime strukturore, por në toskërishte ruhet në forma të ngurosura (në frazeologji) ose jo gjinia asnjëse e disa emrave që tregojnë lëndë (ngjesh brumët, u sos grurët, gjalpët dhe lakrort, ujët e jazit), ndërsa në gegërishte këta emra paraqiten kryesisht si mashkullorë (ujti, gjalpi etj.).
- 2) Po ashtu, emrat që mbarojnë me grykoret k, g, h, në gegërisht trajtën e shquar e bëjnë me mbaresën -i, kurse në toskërishte ata marrin mbaresën -u (kra(h)-u, zog-u, mik-u).

---

<sup>87</sup> Duhet theksuar se në gjendjen e sotme të dialektit këta lloj mbiemrash kanë zënë vend si rrjedhim i ndikimit të gjuhës standarde, mjeteve të informimit masiv dhe lëvizjeve të mëdha të popullsisë. Megjithatë, dhe në këtë rast, në të folmen e Devollit kemi forma fonetike të ndryshme nga ato të gegërishtes, që vijnë si rrjedhim i proceseve të caktuara fonetike.

- 3) Në toskërishte ruhet mirë prapashtesa e shumësit të emrave me -nj, (ullinj, shkëmbinj, stapinj, aganj, shkopinj etj.), ndërsa në gegërishte kjo dukuri shfaqet kryesisht me prapashtesën -j ose me -na.
- 4) Përsa i përket kategorisë gramatikore të rasës, në toskërishte, më saktësisht në të folmen e Devollit, është e pranishme ende e ashtuquajtura rasë vendore me parafjalët përkatëse (*bë diellt, dëpër lumt, d'aurt*).
- 5) Në rasën kallëzore, mbaresa -n (ë) i ngjitet drejtpërdrejt temës (takova kushërinë-kushëririn, mullinë e kishnë hapur-mullirin).
- 6) Në toskërishte mungon përemri pronor i vet, e vet i pranishëm në gegërishte. Këtë funksion e mbulon pronori i vetës së tretë i tij, e saj dhe në format e emëruara (shkoj dë punë të tij, e kishte të sajnë).
- 7) Vihet re përdorimi i rasës dhanore të përemrave të vetës së parë dhe të dytë shumë për rasën emërore dhe kallëzore (ne-neve, ju-yve) (neve na kërkuanë, yve arthtë)

Që nga koha e formimit të dialekteve me tiparet e tyre të veçanta (rreth shekujve V-VIII), në territorin shqiptar ndodhën procese të ndryshme historike që lidhen kryesisht me shpërbërjen e rendit fisnor, madje dhe në brendësi të territorit. Kuptohet që, në zonat malore, ky proces vazhdoi më gjatë. Shturja e këtij sistemi solli me vete zhvillimin e sistemeve të bashkësive fshatare. Zhvillimi ekonomik dhe administrimi i një sërë bashkësive fshatare me afërsi gjeografike çoi në formimin e krahinave. Deri në shekullin X bashkësitë shqiptare bien në kontakt me bashkësitë sllave. Dyndjet bullgare të shekujve V dhe VI sollën ngushtime të territoreve shqiptare, po ashtu dhe zhvendosje të mëdha të popullsisë. Ndërkohë kjo është një nga periudhat kur në këto territore kemi lëvizje të mëdha të popullsisë për shkak të dyndjeve masive sllave përgjatë luginës së lumit Devoll. Diku andej nga shekulli VI, grupet të veçanta sllavësh u vendosën në lartësitë përgjatë këtij lumi, të cilat nuk u organizuan në bashkësi kompakte.<sup>88</sup> Aty-këtu, në zona të caktuara, u krijuan ishuj me banorë që flisnin gjuhë sllave, kryesisht në disa fshatra të Korçës e të Devollit. Nuk është ende e qartë nëse në këta ishuj mbeti popullsi e ardhur, nëse kjo popullsi u asimilua nga ata që erdhën apo nga ata që ishin. Udhëtari i famshëm anglez Ë. Martin-Leak (Lik) i cili ka kaluar në krahinën e Devollit, thekson: “Në lindje të Korçës është Devolli, që në historinë bizantine përmendet me emrin Deabolis dhe si i banuar prej shqiptarëve.

<sup>88</sup> Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar I, Botim i ASH, Tiranë, 2002, f. 206

Aty është qyteti Biklisht (Bilishti i sotëm) i cili në zanafillën e vet ka qenë një koloni bullgarësh.”<sup>89</sup>.

E vërteta është se në të folmen e Devollit ka mjaft huzime sllave, si: leksikore, gramatikore dhe onomastike që u përkasin periudhave të ndryshme, shumë syresh shumë të vjetra e ende të pashpjeguara<sup>90</sup>.

Këto fakte e bëjnë të vështirë të përcaktohet me saktësi periudha e saktë e ndarjes së dialekteve, ndërkohë që lëvizjet e mëdha të popullsisë i kanë përzier më tepër veçoritë gjuhësore. Fakti që në shqipen paraletrare pasqyrohen dukuri që i kanë veçori si gegërishtja dhe toskërishtja, tregon që këto dy dialekte, përveçse kanë një bazë të përbashkët, janë degëzuar në një periudhë pak a shumë të vonë (në periudhën e Mesjetës, shekulli XV).

## **2.2 E folmja e Devollit në grupin lindor të toskërishtes veriore**


Nën termin historiko-gjeografik “Toskëri Veriore”, përfshihen të folmet që fliten mbi Vjosë, ku hyjnë të folmet e Beratit me rrethinat, Myzeqesë, të krahinës së Skraparit, të folmet e qarkut të Korçës (Gorë-Opari, fusha e Korçës, Devolli, Pogradeci, Kolonja, Leskoviku), të krahinës së Dangëllisë, të Shqerisë, si dhe të Tepelenës toske (që ndodhet në të djathtë të Vjosës)<sup>91</sup>

---

<sup>89</sup> W. M. Leak, Kërkime për shqiptarët dhe gjuhën shqipe, përkth. Xh. Lloshi, Bota shqiptare, Tiranë, 2006, f. 149.

<sup>90</sup> Për këto shih më gjerë në kapitullin për leksikun, fjalëformimin dhe toponiminë.

<sup>91</sup> J. Gjinari, Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965, f. 242.



**Harta 2. Shtrirja gjeografike e Toskërisë Veriore**

Emërtimi “toskë” ka shënuar qysh herët pjesën më veriore të shqiptarëve të jugut, ndërsa “gegë” pjesën më jugore të shqiptarëve të veriut.<sup>92</sup> Zgjerimi i emërtimit “toskë” për një territor më të gjerë në jug u krye shkallë-shkallë. Pikërisht, këtu merr rëndësi fakti që në dokumentet mesjetare dalin shumë emra fisesh, por nuk dalin këto të dyja që sot janë kryesore.

Duke iu referuar J. G. Hanit, emërtimi “toskë”<sup>93</sup>, në dallim me “gegë”, përdorej për gjithë shqiptarët e Jugut, por kjo vetëm për gegët dhe për fqinjët e tjerë të Shqipërisë së Jugut, sepse në këtë krahinë ky emërtim kishte një kuptim shumë më të ngushtë.


Ë. M. Liku, në veprën e tij “Research in Greece”, toskët i përfshin në territoret që nga kodrat e Durrësit deri në Berat dhe Vlorë dhe në anën lindore, gjithë malet deri në krahinën e Korçës. Kështu, ai veçon labët dhe çamët.<sup>94</sup>

<sup>92</sup> E. Çabej, Për historinë e strukturës dialektore të shqipes, BISH, SSHSH, nr. 4, 1956, f. 438.

<sup>93</sup> J. G. Hahn, Studime shqiptare, Bota shqiptare, Tiranë, 2007, f. 31.

<sup>94</sup> W. M. Leake, Kërkime për shqiptarët dhe gjuhën shqipe, përkth. Xh. Lloshi, Bota shqiptare, Tiranë, 2006, f. 147.

Në ndarjen e të folmeve të toskërishtes veriore që ka bërë J. Gjinari, nën termin “Toskëri” ka përfshirë gjithë Jugun e Shqipërisë (nga Shkumbini drejt viseve jugore), por thekson se Toskëria Veriore dhe të folmet e saj përfshijnë territoret midis lumenjve Shkumbin dhe Vjosë, atë që dikur e quanin si Toskëria e vërtetë.<sup>95</sup> Në ndonjë krahinë, toskërishtja veriore shtrihet dhe më në jug të Toskërisë së vërtetë, matanë Vjosës, duke përfshirë qytetin e Vlorës si dhe fshatrat e saj veriore dhe verilindore (deri te vija Radhimë-Dukat).



**Harta 3. Shtrirja gjeografike e toskërishtes veriore**

Duke qenë se të folmet e dialektit jugor kanë qenë më njësuara se ato të gegërishtes, dallimet midis këtyre të folmeve kanë që më të pakta.

Në grupimin që u ka bërë J. Gjinari këtyre të folmeve, theksohet se ato janë studiuar hershëm dhe për to është mbledhur një material i pasur dialektologjik. Kjo dëshmohet sidomos nga punimet e hershme në fushën e dialektologjisë, duke përmendur punimet për të folmen e

<sup>95</sup> J. Gjinari, Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965. f. 241.



Devollit të V. Xhaçkës dhe J. Gjinarit, e sidomos dhe lëndën e shumtë etnofolklorike e frazeologjike të mbledhur nga studiues të folklorit dhe të gjuhësisë. Për më tepër, kjo e folme dëshmohep nëpërmjet toskërishtes letrare së shkruar.

Duke i parë në tërësinë e tipareve të përgjithshme, të folmet e toskërishtes veriore paraqesin dallimet më të mëdha me toskërishten jugore në fushën e fonetikës dhe morfologjisë.

### 2.2.1 Dallimet në rrafshin fonetik

- 1) Në të gjitha të folmet e këtij nëndialekti ka vetëm zanore të gjatësisë së shkurtër ose të mesme. Në të gjithë të folmen e Devollit nyjëtohen vetëm zanore të shkurtra gojore. Ndërsa në disa të folme të toskërishtes jugore (sidomos në të folmet e Bregdetit dhe të Kurveleshit) dhe në çamërishte, zanoret e gjata ndihen edhe sot.
- 2) Ë-ja e theksuar (këmba, nepërka, kënga, mënga, lëngu) ndryshon si timbër nga varianet e saj në labërishte dhe në çamërishte. Ajo i afrohet më tepër një e-je të hapur (madje në folës të veçantë, të cilët nuk kanë lëvizur nga fshati i tyre, ky tingull dëgjohep plotësisht si /ɛ/ e hapur)<sup>96</sup>. Zanorja ë e kësaj të folmeje është gjegjëse gojore e â-së hundore të gegërishtes.
- 3) Në sistemin vokalik janë të shtatë zanoret themelore, d. m. th. përfshihet dhe zanorja y, e cila në të folmet jugore të toskërishtes mungon fare. Megjithatë, për këtë zanore vihen re dukuritë e përfimit të saj nëpërmjet qiellzorimit të u-së apo buzorëzimit të i-së (gjyrmë, pyperka, pyper).
- 4) Përveç disa trevave anësore, diftongu *ya* ruhet në të gjitha pozicionet, ndërkohë që në të folme të tjera të toskërishte jugore është zbërthyer në *togzanor*<sup>97</sup>, ndërsa në gegërishte shfaqet me variantin *ye*. Devolli, si një trevë skajshmërisht lindore, e ka të ruajtur mjaft mirë këtë diftong dhe në pozicion fundor në rrokje të hapur (*dya-dyanë, ftya-ftonjtë* etj.).
- 5) Po ashtu, në të folmet e toskërishtes veriore, posaçërisht në të folmen e Devollit, diftongjet e mirëfillta ose jo, *ie* dhe *ye*, që vijnë nga zbërthimi i një e-je të theksuar, janë ruajtur mjaft mirë (mjell, fyell), ndërkohë që në gegërishte ato janë monoftonguar.

---

<sup>96</sup> Kjo dukuri është vënë re dhe në materialin dialektologjik të mbledhur nga banorë të moshës së re në fshatrat Sul, Vranisht, Braçanj, të cilët ishin rreth moshës 18- vjeç dhe nuk kishin vazhduar shkollën e mesme. Gjithashtu, dhe nga subjekte të tjerë të kësaj moshe, të cilët shkollën e mesme e kishin kryer brenda krahinës së tyre.

<sup>97</sup> Kjo dukuri ka veçori të caktuara në të folmen e Devollit, të cilat trajtohen në sythin 3.2.3 të këtij punimi.

- 6) Ruhet mirë bashkëtingëllorja hundore qiellzore -nj si mbaresë foljore e kohës së tashme dhe të pakryer në foljet e zgjedhimit të parë të tipit: lanj, bluanj, punonj, lëronj.<sup>98</sup> Në të folmet e toskërishtes verore, dhe pikërisht në të folmen e Devollit, ku vazhdon të ruhet forma foljore me -nj. Kjo duket sidomos në kohën e pakryer të dëftores, ku pas –nj së temës vjen mbaresa e foljes (punonja, flinja, anja, rëminja, lëvrinja, nakatosnja).
- 7) Po në këto të folme të këtij grupimi vihet re shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme fundore ose para të shurdhëtave (zok, i math, bakti etj.).

### **2.2.2 Dallimet në rrafshin morfologjik**


- 1) Në të folmet e toskërishtes veriore është e pranishme rregullisht e ashtuquajtura “rasë vendore” (dë gropët, nëpër lumt, dëpër Devollt, bë diell), rasë e cila gjendet dhe në disa të folme të gegërishtes jugore.
- 2) Në raport me labërishten dhe çamërishten, që kanë ruajtur format e vjetra të së pakryerës, me ndryshime të vogla fonetike, në të folmet e toskërishtes veriore ka një larmi më të madhe formash, si rrjedhim i ndryshimeve morfologjike në të folme të ndryshme (lanja, por dhe laja).
- 3) Në të pakryerën e foljeve kam dhe jam të folmet e toskërishtes veriore dalin me variantet kisha dhe isha, ndërsa në Jug janë ruajtur format e vjetra: keshë, jeshë etj.

Pozicioni i krahinës së Devollit në anën jugore të Shkumbinit, e bën të folmen e saj pjesë të dialektit tosk. Kjo e folme shtrihet në fshatrat përgjatë dy krahëve të lumit Devoll, duke filluar nga burimet e tij në malin e fshatit Nikolicë e deri në Cangonj, ku ndahet si kufi me rrethin e Korçës.

Kjo e folme, ashtu si dhe dialekti tosk në tërësi, ka tipare të përbashkëta me dialektin geg, në veçanti me të folme të veçanta të saj, por, nga ana tjetër, paraqet tipare karakteristike që e përfshijnë në grupin lindor të të folmeve të toskërishtes veriore.

---

<sup>98</sup> Duhet theksuar se kjo dukuri ka kufizimin e vet brenda toskërishtes veriore. Kështu në Pogradec, fushën e Korçës si dhe në të folmet e Tepelenës toske vihen re format foljore me –j, madje dhe brenda të folmes së Devollit (p.sh. në Progër, Vranisht, Pilur etj.).



**Harta 4. Shtrirja territoriale e të folmeve të toskërishtes veriore**

Në të folmet e toskërishtes veriore dallohen dy grupime të mëdha të folmesh: grupi perëndimor dhe ai lindor. Për shkak të pozicionit gjeografik, e folmja e Devollit bën pjesë në krahun lindor të të folmeve të toskërishtes veriore. Territoret ku shtrihen këto të folme kanë qenë pjesë e njësive administrative të ndryshme, pak a shumë të veçuara nga njëra-tjetra. Kështu, të folmet perëndimore, si kufij territorialë, kanë qenë pjesë e sanxhakut të Vlorës dhe Beratit, kurse të folmet lindore kanë qenë në varësinë e sanxhakut e Ohrit dhe të Selasforit. Para pushtimit turk këto grupime ndaheshin pikërisht aty ku mbaronin zotërimet e Muzakajve.<sup>99</sup> Sot, me ndarjet administrative në qarqe, grupimi perëndimor bën pjesë në qarkun e Beratit dhe atë të Fierit dhe të folmet lindore përfshihen në qarkun e Korçës. Megjithatë, brenda këtij grupimi të folmesh lindore, e folmja e Devollit është më e veçantë dhe më interesante, si nga pikëpamja e ruajtjes së gjendjes së vjetër të gjuhës, ashtu dhe nga pikëpamja e dukurive të veçanta gjuhësore që janë zhvilluar në këtë të folme. Ajo paraqet karakteristika të dallueshme dhe për faktin se ajo është skajore dhe nga pikëpamja territoriale.

<sup>99</sup> Ch. Hopf, *Chronique Greco-romane inedite ou peu connues ...*, përkth. Robert Elsie, Berlin, 1873.

Në grupimin e të folmeve lindore, e folmja e Devollit ka karakteristika të përbashkëta të të gjithë grupit në rrafshin fonetik dhe morfologjik. Këto karakteristika vihen re në disa drejtime:

- 1) Kështu, është karakteristike dukuria e pranisë së një e-je të theksuar që në gegërishte i përgjigjet një e hundore (zemra, vendi, embri). Por kjo dukuri vihet re dhe në të folmet e grupit perëndimor<sup>100</sup>. Kjo nuk përjashton disa raste të rralla në të cilat e-ja hundore është zhvilluar në ë (na more mëntë) si në pjesën më të madhe të të folmeve të grupit jugor.
- 2) Diftongu *ya* ruhet në të gjitha pozicionet, madje dhe në rrokje fundore të hapur. Kjo dukuri vihet re dhe në të folmet e grupit jugor dhe perëndimor<sup>101</sup>. Megjithatë, karakteristikat e diftongjeve në këto të folme janë të ndryshme nga grupi lindor. Ndërsa në grupin perëndimor zanorja rrokjeformuese e diftongut a është një a e prapme e buzorëzuar (kryesisht në të folmet e Myzeqesë, Beratit dhe Mallakastrës), në të folmen e Devollit kjo zanore është plotësisht e hapur, ndërkohë që, në dallim me të gjitha grupimet e të folmeve të tjera të toskërishtes veriore, diftongjet gjenden edhe në rrokje fundore të hapur.
- 3) Përemrat pronorë të vetës së parë në rasat e zhdrejta dalin me dy trajta, (djali tim-djali tem, çupa ime-çupa teme). Në këtë rast dallohen përkimet dhe me të folmet geqe për të cilat kjo formë është mbizotëruese. Në grupet e tjera të të folmeve të toskërishtes veriore nuk hasen trajta të tilla pronori.  
Po te përemrat pronorë të vetës së parë dhe të dytë (ku prona është shumës dhe pronari njëjës), trajtat e rasave të zhdrejta janë shtrirë për analogji dhe te pronorët e vetës së parë dhe të dytë, ku prona dhe pronari është njëjës (djali tim-djemtë tim, çupa time-çupat time, djali tënd-djemtë tënd etj.).
- 4) Përemri vector i vetës së tretë njëjës dhe përemri dëftor njëjës që tregon frymor ose send në largësi ai paraqitet në trajtën ay. Kjo dukuri del në të folmen e Korçës dhe rrethinave të saj, si dhe në të folmen e Devollit.

---

<sup>100</sup> J. Gjinari, Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965, f. 241.

<sup>101</sup> Po aty, f. 252.

- 5) Ndryshe nga të folme të jera të Jugut, foljet, në vetën e dytë njëjës të kohës e tashme dhe të pakryer, në diatezat pësore dhe vetvetore dalin me mbaresat –esh, -eshe (lodhesh-lodhshe, zireshe-zireshe, laesh-lashe etj.)<sup>102</sup>.
- 6) Foljet me temë në zanore, në kohën e kryer të thjeshtë, në vetën e tretë të numrit njëjës marrin bashkëtingëlloren anihiatizuese –v- në dy vetat e para (punovi, pivi, lavi, fshivi, lërovi).
- 7) Foljet me temë në bashkëtingëllore, në tri vetat e shumësit të kohës së kryer të thjeshtë, dalin zakonisht me mbaresat -më, -të, -në (qepmë, qeptë, qepnë).
- 8) Në kohën e pakryer, si foljet me temë në zanore dhe në ato me temë në bashkëtingëllore, në tri vetat e njëjësit, kanë mbaresat -nja, -nje, -te (nte). Këtu, përgjithësisht del në pah karakteristika e të folmes së Devollit si e folme lindore e toskërishtes veriore, sepse në këtë të folme ruhet qartë -nj, si pjesë e mbaresës foljore.
- 9) Foljet e zgjedhimit III, IV, në vetën e dytë të njëjës të kohës së tashme të mënyrës lidhore, dalin me mbaresën –sh, në ndryshim nga të folmet e tjera të Jugut që mbarojnë me –ç<sup>103</sup> (të lash, të punosh, të ash).
- 10) Përgjithësisht, si parashtesa që u japin foljeve kuptim të kundërt, në të folmen e Devollit dalin, x, ç dhe xh (xhvesh, çkarkon, çkul, xberthenj etj.). Shurdhimi i këtyre parashtesave nuk përkon me asnjë të folme të toskërishtes veriore.<sup>104</sup>
- 11) Kanë përhapje të madhe prapashtesat zvogëluese dhe përkëdhelëse me burim nga sllavishtja, si: -kë,-çkë, -ckë (çupkë, njëckë, jamaçkë etj.). Në të folmet e grupit perëndimor prapashtesa zvogëluese është -z(ë) dhe shumë më pak prapashtesa zvogëluese -th. Gjithsesi, dhe në të folmen e Devollit nuk mungojnë dhe fjalë me këto lloj prapashtesash (cazë, njëzë, atythi etj.).

Përkimet më të mëdha ky grup i ka me të folmet juglindore, por, përta i përket të folmes së Devollit, mund të theksojmë se ka veçori të tilla që e karakterizojnë atë dhe brenda grupit lindor të toskërishtes veriore. Këtu mund të vëmë në dukje tipare të tilla, si: ruajtja e ë-së paratheksore

<sup>102</sup> Në të folmen e Devollit kemi hasur dhe format lodhçe, zirçe për të cilat mendojmë se janë rrjedhojë e afrikimit të sh-së dhe jo mbaresë e veçantë.

<sup>103</sup> Në të folme si labërishtja dhe çamërishtja këto forma janë të zakonshme (Q. Haxhihasani, Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, f. 183; M. Totoni, Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, f. 73). Megjithatë, dhe në të folmen e banorëve të brezit të vjetër të Devollit si dhe në materialin folklorik të mbledhur nga K. Zdruli në Devollin e Sipërm i kemi hasur trajta me –ç, si: të laç, të gjeç etj.

<sup>104</sup> Në të folmet jugore të toskërishtes veriore dalin format me zh.

në shumë fjalë (në dallim nga të folmet e Korçës dhe rrethinave të saj<sup>105</sup>), ruajtja e diftongjeve në të gjitha pozicionet (në të folmen e Strelcës të krahinës së Gorës dhe në fushën e Korçës janë zbërthyer në togzanor, sidomos në rrokje fundore të hapur<sup>106</sup>, ruajtja deri vonë i grupeve kl dhe gl, vazhdimësia e grupeve lg dhe lk etj.).

Pavarësisht përkimeve dhe dallimeve me grupet e tjera të të folmeve të toskërishtes veriore, e folmja e Devollit, për shkak të pozitës gjeografike, ka karakteristika të tilla që ndodhen vetëm në këtë të folme dhe jo në të folme të tjera.

Studimi i të folmeve të toskërishtes veriore ka një rëndësi të veçantë sepse ato janë pasqyruar gjerësisht në toskërishten e shkruar, në raport me të folmet e tjera jugore.<sup>107</sup>

### **2.3 Bashkëpërkimet me gegërishten jugore**

Të folmet e toskërishtes veriore kanë një sërë përkimesh me gegërishten jugore. Pozicioni gjeografik i territoreve ku fliten këto folme është pranë me territoret ku përdoret gegërishtja jugore. Historia e zhvillimit të marrëdhënieve midis dy bashkësive gjuhësore të ndryshme lidhet me marrëdhëniet tregtare, kulturore dhe afërsia territoriale me krahinat e Shqipërisë së Mesme. Duhet theksuar se këto marrëdhënie, në kohë dhe territore të ndryshme, kanë qenë të ndryshme, si rrjedhim dhe ndikimet gjuhësore janë me shtrirje të ndryshme.

Edhe pse krahina e Devollit, nga pikëpamja e grupimit të të folmeve përbën veçori brenda grupit lindor të toskërishtes veriore, kjo nuk e ka penguar të ketë ndikimet e saj në gegërishten jugore dhe anasjelltas.

Nga pikëpamja gjeografike, toskërishtja veriore dhe gegërishtja jugore shtrihen në një zonë relativisht të gjerë dhe të banuar qysh herët nga një popullsi me dendësi të lartë. Këto dy zona shtrihen në brezin ndërmjet lumenjve Vjosë dhe Shkumbin, brez që përfshin gjithë Shqipërinë e Mesme dhe zonat veriore të Shqipërisë Jugore. Relievi i kësaj zone vjen duke u ngritur në lartësi nga perëndimi në lindje, nga ultësira deri në territore të thyera malore. Luginat e lumenjve u kanë dhënë mundësi të mira komunikimi këtyre zonave që në antikitet, sepse përgjatë tyre ka kaluar

<sup>105</sup> V. Milkani, Vëzhgime mbi të folmen e Bulgarecit, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 165.

<sup>106</sup> Ç. Petriti, Vëzhgime mbi të folmen e Strelcës, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 214.

<sup>107</sup> J. Gjinari thekson se këto të folme shërbejnë për të njohur bazën dialektore të toskërishtes letrare si dhe faktin që kjo bazë dialektore që nga Rilindja Kombëtare ka ardhur duke u zgjeruar dhe duke u pasuruar ("Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj" f. 254).

rruga Egnatia me degët e saj që niseshin që nga Durrësi dhe Apollonia. Historikisht, në këto territore ka pasur qendra të zhvilluara nga pikëpamja ekonomike dhe social-kulturore. Një pjesë e territoreve që shtihen në brigjet jugore të Shkumbinit, qysh para pushtimit turk bënë pjesë në pronat feudale që e kishin qendrën e tyre në veri të Shkumbinit<sup>108</sup>. Ngulimet e Arvanitasve shtriheshin deri në Mokër.

Gjatë pushtimit turk, pjesa më e madhe e qarkut të Korçës bënte pjesë në sanxhakun e Ohrit. Devollin e përfshinte kazaja e Korçës, ndërsa pjesa jugperëndimore e tij në kazanë e Kosturit. Të gjitha territoret të quajtuara “Devollin e Poshtëm” dhe “Devollin e Sipërm” ishin në zotërim të Muzakajve. Në testamentin e Muzakajve thuhet shprehimisht se zot Andrea Muzaka “...gjithashtu zotëron dhe qeveris gjithë krahinën e Devollit të Epërm. Duhet shënuar që këtu ndodhet një vend që e quajnë Voskop, i cili është shkatërruar. Ai gjithashtu zotëron dhe qeveris gjithë qytetin e Korçës deri në fshatin e quajtur Sovjan...Ai gjithashtu zotëron dhe qeveris gjithë krahinën e Devollit të Poshtëm deri në Nestramo, qytet i cili është i shkatërruar.”<sup>109</sup> Zotërimet e Devollit deri në Kostur i mbetën trashëgim djalit të tretë të Muzakajve, Teodorit të Stojës.

Banorët e Devollit, historikisht, kanë pasur lidhje të hershme tregtare me krahinat e tjera të Shqipërisë, sepse luginat e Devollit, Drinit, Shkumbinit, Osumit dhe Vjosës përbënin arteriet kryesore të mallrave që në periudhën e shteteve ilire (shek. III-II p. e. s.), Këto rrugë tregtare vazhduan deri vonë. Lëvizjet e mëdha të popullsisë, afërsia gjeografike, komunikimi midis qendrave të rëndësishme ekonomike dhe kulturore të përmendura më sipër sollën si rrjedhim që në të folmet e gegërishtes jugore dhe të toskërishtes veriore të ketë përkime të plota apo të pjesshme, të cilat shfaqen në rrafshet e ndryshme gjuhësore.

Në të folmen e Devollit përkimet me gegërishten jugore vihen re më tepër në morfologji dhe më pak në rrafshin fonetik. Përkimet më të shpeshta janë:

- 1) Dukuria e reduktimit të ë-së së theksuar. Kjo dukuri ka përkime të pjesshme dhe vihet re në pozita paratheksore dhe pastheksore. Reduktimi sasiar i ë-së së theksuar vihet re në fjalë proklitike të cilat mbarojnë me zanoren ë dhe fjala e theksuar pas saj fillon me një zanore apo me bashkëtingëlloren h (*d'arët, d'aurt, i thiri mb'embrë*); në fjalë ku ë-ja ndodhet në pozicion një rrokje të hapur nistore (*vllaj-vëllai, ktu-këtu, kshu-kështu*); në

<sup>108</sup> Dibra është një nga këto qendra.

<sup>109</sup> Ch. Hopf, *Chronique Greco-romane inedite ou peu connues ...*, përkth. Robert Elsie, Berlin, 1873.

fjalë ku ë-ja ndodhet në pozicion paratheksor (bakti, puntor, plotsoj). Në raste të tjera procesi i reduktimit të ë-së së theksuar është në fillimet e veta.

- 2) Një përkim i plotë me gegërishten veriore është ekzistenca e së ashtuquajturës “rasë vendore”, e cila sot haset vetëm në toskërishten veriore, përkatësisht në të folmen e Devollit (bë diellt, dënë të, d’Oçisht);
- 3) Një veçori e përbashkët midis toskërishtes veriore dhe gegërishtes jugore që gjendet në të folmen e Devollit është dhe përdorimi i pronorëve përkatës për gjininë mashkullore dhe në gjininë femërore në rasat e zhdrejta (tat-tate, tënd-tënde). Në të dy folmet mbaresa e gjinisë është mjetei gramatikor i dallimit të dy formave;
- 4) Dukuri që mbulon pothuaj gjithë Toskërinë Veriore dhe Shqipërinë e Mesme është dhe ajo e formimit të emrave abstraktë nga emërimi i mbiemrave prejpjesorë (e vrara-e vramja, e lara-e lamja, e kënduara-e kënduemja);
- 5) Në togfjalëshat, të cilat si gjymtyrë kryesore kanë një emër në rasën kallëzore të paraprirë nga parafjalët në, mbi, nëpër, për, me, dhe si gjymtyrë të varur një emër në rasën gjinore ose një mbiemër të nyjshëm, si në gegërishten jugore dhe në toskërishten veriore, përkatësisht në të folmen e Devollit, gjymtyra e varur e togfjalëshit e ruan njënjë përkatëse (dë fushën e lëruarë; vajtmë bë shtëpinë e Fotinisë; për bajramnë e voglë; me pogaçen e dasmës etj.). Në toskërishten jugore nyja bie fare ose kthehet në të.

Por, në disa raste vihen re disa përkime që kanë të bëjnë jo me të gjitha të folmet e toskërishtes veriore, por vetëm me disa prej tyre. Këtu mund të vëmë në dukje disa tipare të përbashkëta midis gegërishtes jugore dhe të folmes së Devollit në veçanti.

- 1) Në përgjithësi, në toskërishte, është ruajtur theksi fundor i huazimeve turke, ndërsa në të folmen e Devollit hasim si fjalë me theks fundor (abllá, xhaxhá, pará, kafé, ashllamá, mertepé), ashtu dhe fjalë turke me theks parafundor (xhézve, qófte, shamátë, shíshe);
- 2) Në të folmen e Devollit vihet re dukuria e buzorëzimit të i-së para ose pas tingujve buzorë, dukuri që është e zakonshme në të folmet e Shqipërisë së Mesme (krypë-krypenicë, pyperkë). Në fakt, J. Gjinari këtë dukuri e përmend vetëm për të folmet e Beratit dhe të Myzeqesë<sup>110</sup>, por kjo dukuri vihet re në të gjithë fshatrat e Devollit ku është mbledhur materiali ynë dialektologjik. Duhet theksuar se buzorëzimi i i-së në y nuk është

---

<sup>110</sup> J. Gjinari, Tipare të të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore, SF, nr. 2, 1965, f. 129-137.



shtrirë në të gjitha fjalët ku i ndodhet para ose pas një tingulli buzor, siç ndodh rëndom në të folmet e Shqipërisë së Mesme (frykë, qylym, krymb). Kështu, mund të arrijmë në përfundimin se te këto fjalë, procesi i buzorëzimit mund të jetë zhvilluar në mënyrë të pavarur dhe jo si një ndikim i gegërishtes jugore.

- 3) Ashtu si në gegërishte, edhe në të folmen e Devollit vihet re dukuria e shndërrimit të ë-së së patheksuar në i përpara një rrokjeje të theksuar, megjithëse është dukuri më e kufizuar në raport me të folmet perëndimore të toskërishtes veriore (gjilpëra, livezhga, ginjeshtrë, njindizaj, të trashigohesh etj.). Kjo dukuri ka ndodhur më tepër kur zanorja ë është ndodhur më tepër pranë një bashkëtingëlloreje qiellzore.
- 4) Në të folmen e Devollit, bashkëtingëllorja laringale h nuk ndihet në asnjë pozicion, ndërkohë që në të folme të tjera (kryesisht në Shqipërinë e Mesme, si dhe në disa të folme të toskërishtes veriore si ajo e Myzeqesë) kjo bashkëtingëllore është shndërruar në buzore-dhëmboren f (i ngroft, me vefte). Në të folmen e Devollit, një refleks i tillë haset vetëm te fjalët llaftari-llaftaris-i llaftarisur, atfernaj etj.
- 5) Në të folmen e Devollit ndihet ndikimi i gegërishtes jugore në përdorimin e trajtës së pronorit tem-teme, krahas tim-time të përemrit pronor të vetës së parë, ku prona dhe pronari janë në numrin njëjës në rasat gjinore, dhanore e kallëzore (i djalit tem, djalit tem, djalën tem-i çupës teme, çupës teme, çupën teme etj.).
- 6) Në të folmen e fshatit Progër, por dhe në fshatrat Vranisht e Bitinckë, krahas mbaresës -nj për foljet me temë në zanore, hasen dhe format me mbaresën -j (lanj-laj, lëronj-lëroj, thanj-thaj).
- 7) Format pësore-vetvetore të foljeve në vetën e parë dhe të dytë njëjës, si në të folmen e Devollit dhe në gegërishten jugore, janë pa h (laesh, aesh), edhe ndërmjet dy zanoreve te disa folje hyjnë bashkëtingëlloret j dhe r kundër hiatit (ziresh, krijesh).
- 8) Në të folmen e Devollit hasen përkime dhe në format e shumësit të së kryerës së thjeshtë, në të cilat mbaresat -më, -të, -në të folmeve që mbarojnë me bashkëtingëllore u përgjigjen mbaresat -me, -te, -ne të të folmeve të gegërishtes veriperëndimore (khs. lithmë-lithtë-lithnë me lidhme-lidhte-lidhne). Mbaresat -më, -të, -në në toskërishten veriore janë më të hershme nga pikëpamja kronologjike.
- 9) Një dukuri interesante vihet re në përkimin e përdorimit të nyjës e dhe jo të në mbiemra me funksion predikativ. Kjo dukuri është shtrirë në të gjitha të folmet e fshatrave të

Devollit, kryesisht në ligjërimin e brezit të mesëm dhe të vjetër (e ka gjaknë e ëmbël; e ka vërnë e ngushtë; e ka viçnë e voglë).

Edhe toskërishtja veriore ka ndikuar te gegërishtja jugore. Këto ndikime duken në disa drejtime:

- 1) Grupet kl dhe gl, si në toskërishten veriore dhe në gegërishten jugore, kanë dhënë përkatësisht q dhe gj<sup>111</sup> (qumësht, gjuhë). E. Çabej sjell dëshmi të shqipes së shkruar në të cilat faktohet që këto grupe "...i ka folur gjithë lëma gjuhësore e shqipes..."<sup>112</sup>. Ruajtja e këtyre grupeve në të folmet e Çamërisë dhe në të folmen e Devollit kanë mbetur si gjurmë të fundit të një gjendjeje fonetike të hershme të gjuhës. Te këto të folme ka dallime thelbësore në zhvillimin e këtyre grupeve të bashkëtingëlloreve. Ndërsa në gegërishten veriore ka pasur një zhvillim të shkallëshkallshëm nga kl>kj dhe gl>gi (klumësht-kjumësht-qumësht, klaj-kjaj-qaj, gluri-giuri-gjuri), në toskërishten jugore ruhen më tepër format e vjetra me gl dhe kl (çamërishtja i ruan dhe sot grupet kl dhe gl, gluri, glëmp, klishë etj.). Në toskërishten veriore, këto grupe, në shembujt e përmendur më sipër, janë zhvilluar drejt qiellzoreve mbylltore q dhe g. Por, në fjalë të tjera, si: klyçi, klisha, të cilat ruhen në të folmet lindore të toskërishtes veriore (të folmet e fshatrave Sinicë, Qytezë, Bradvicë, Grapshi etj. deri diku dhe në Hoçisht) te grupi kl nuk ka ndodhur asimilim i anësore sonante l në mesoren qiellzore j dhe më pas në qiellzoren mbylltore të shurdhët q. Kështu, grupi kl nuk është zhvilluar drejt qiellzores q, por ka mbetur në grykoren k. Përsa u përket fjalëve që kanë pasur grupin gl, mund të vëmë në dukje se në të folmen e Devollit kalimi gl>gj nuk dëshmohet të jetë bërë në mënyrë të shkallëshkallshme nëpërmjet asimilimit, por format me mbylltoren qiellzore gj janë bërë menjëherë.<sup>113</sup>
- 2) Në të folmen e Devollit ende ruhen grupet lk, lg, lj, të cilat janë më të pranishme kryesisht në toskërishten jugore<sup>114</sup> (alkë, ulk, balgë-balgore), ndërkohë që në gegërishte këto grupe u asimiluan në j dhe rënie të plotë të saj (ujk-uk, formë që haset te antroponimet geqe). Asimilimi i këtyre grupeve, të cilat dikur kanë qenë të mbarë

<sup>111</sup> Për rastet e përdorimit të këtyre grupeve në të folme të veçanta të fshatrave të Devollit shih më gjerë në sythin 3.3.2 të këtij punimi

<sup>112</sup> E. Çabej, Për historinë e konsonatizmit në gjuhën shqipe, Studime gjuhësore III, 1977, Rilindja, Prishtinë, f. 54.

<sup>113</sup> Për më tepër shih në sythin 3.3.3 të këtij punimi.

<sup>114</sup> Q. Haxhihasani, Një vështrim mbi të folmen e Çamërisë, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, f. 118-194.

shqipes, u zhvillua në rrugë të ndryshme dhe kjo solli dhe diferencimin dialektor nga pikëpamja fonetike.

- 3) Po ashtu, bashkëtingëlloret qiellzore q dhe gj nuk afrikohen si në të folmet e gegërishtes veriore (qafë, gjak), një tipar mjaft i dallueshëm në të folmet e gegërishtes në përgjithësi.
- 4) Një dukuri mjaft e pranishme në gegërishten jugore që vjen si ndikim i toskërishtes veriore është dhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalëve (zok- zoq, i math, i lik etj.).
- 5) Në disa të folme lindore të gegërishte (Dibër) dhe në të folmen e Shestanit ruhen ende format e vjetra me -nj të foljeve në të pakryerën (dinja, lëronja)<sup>115</sup>, ashtu si gjenden dhe në të folmen e Devollit.
- 6) Te format e së kryerës së thjeshtë, format sigmatike të foljeve në mënyrën lidhore e dëshirore që hasen pothuaj në të gjitha të folmet e toskërishtes veriore, janë të pranishme dhe te të folmet e Shqipërisë së Mesme (por, në të folmen e Devollit, krahas përdorimit të formave të formave sigmatike të së kryerës së thjeshtë, hasen, madje, dhe format e vjetra me -ç, si: arçë, lënça, të punoç, të mësoç etj.)<sup>116</sup>.

Pohimi i J. Gjinarit se në anën lindore pikat më të mëdha të takimit vihen re në rrafshin morfologjik, mund të vërtetohet me të dhënat dialektore nga e folmja e Devollit, pavarësisht se në grupimin e të folmeve të toskërishtes veriore, kjo e folme dallon nga një sërë tiparesh që i ka vetëm ajo<sup>117</sup>.

Gjithashtu, duhet theksuar se e folmja e Devollit, nga pikëpamja e ruajtjes së formave fonetike dhe gramatikore është konservative. Në të ruhen një sërë tiparesh që dikur kanë qenë të mbarë shqipes, por në të folme të tjera kanë pësuar ndryshime të theksuara. Ndërkohë që format më origjinale ruhen kryesisht në zonat më jugore dhe më lindore të vendit (grupet kl, gl, grupet lg, lk, nj-ja fundore si mjet gramatikor) vërteton pohimin se ka një njësi më të madhe të të folmeve të toskërishtes.

Megjithatë, duhet vënë në dukje se rrethanat dhe kushtet historiko-shoqërore kanë bërë një lloj përzjerje të të folmeve apo ndryshime brenda vetë të folmeve. Nërkaq, deri në periudhën e Mesjetës e diçka më vonë mbaruan së vepruari një sërë ligjesh fonetike, ndikimet e dialekteve

---

<sup>115</sup> J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, Dialektologjia, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 228.

<sup>116</sup> Përgjithësisht këto forma janë hasur te banorët e Devollit të Sipërm.

<sup>117</sup> Shih J. Gjinari, Tipare të të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore, SF, nr. 2, 1965, f. 29-137.

dhe të folmeve të njëra-tjetra vinin si rrjedhim i shpërnguljeve të popullsisë për verimin dhe dimërimin e bagëtive, i lidhjeve tregtare të qendrave të zhvilluara, kryesisht vetëm në disa qytete, si rrjedhim i emigracionit dhe pushtimeve të gjata, ndërsa sot veprojnë rrethana të tjera.

E folmja e Devollit ka pësuar ndryshime nën veprimin e gjuhës standarde e sidomos asaj të shkruar, e lëvizjeve të mëdha të popullsisë për shkak të punësimit në zona të tjera industriale apo bujqësore, si në veri dhe në jug të Shqipërisë, e ndryshimeve të thella shoqërore në arsimimin e popullsisë. Në kushtet e sotme lëvizjet e mëdha migratore, tashmë jo në formën e kurbetit, por në formën e lëvizjeve familjare, zbrazja e pjesshme apo e plotë e fshatrave të tërë, trysnia e gjuhëve të “modës” etj., ka sjellë me vete zhdukjen dhe reduktimin e disa tipareve të vjetra dialektore, si dhe një përzierje të madhe të elementeve dialektore me forma të reja gjuhësore, shpesh dhe jo fort të përshtatshme me shqipen. Në këtë mënyrë, po bëhet gjithmonë e më i vështirë hulumtimi dhe mbledhja e dëshmive gjuhësore dialektore si dhe studimi i këtyre dëshmive në mënyrë të izoluar. Të dhënat e një rindërtimi të brendshëm të kësaj të folmeje në kuadrin e historisë së shqipes dhe dialekteve të saj tregojnë se, përveç një substrati vendës, në të folmen e Devollit nuk kanë munguar ndikimet nga gjuhët fqinjë me të cilat kjo krahinë historikisht ka qenë në kufi, por, njëkohësisht, dhe me ato gjuhë të cilat kanë lënë gjurmë në të për shkak të rrethanave të caktuara historike.

### 3. TIPARE DHE DUKURI FONETIKE TË TË FOLMES SË DEVOLLIT

#### 3.1 Vështrim i përgjithshëm për sistemin tingullor të të folmes së Devollit

Për të paraqitur tiparet e përgjithshme fonetike të një të folmeje, del e nevojshme që këto dallime të shihen nga pikëpamja strukturore dhe funksionale. Duke u bazuar në këto dy kritere, dallimet në sistemin fonetik të të folmes së Devollit ndahen në tri grupe të mëdha:


- Dallimet fonologjike (dallime në inventarin e fonemave, në sistemin e fonemave dhe në funksionin e tyre) që prekin sistemin fonologjik të të folmeve.
- Dallimet fonetike që lidhen me realizimin e varianteve fonetike në kushte të caktuara fonetike.
- Dallimet në përbërjen fonematike të së njëjtës fjalë, që lidhen me ndryshimet fonematike që mund të ketë pësuar një fjalë në rrjedhën e kohës, ndryshime që pasqyrohen dhe sot dhe dallon të folmet nga njëra-tjetra.

Sistemi tingullor i të folmes së Devollit përbëhet nga shtatë zanore, ose fonema themelore: /i/, /y/, /e/, /ë/, /a/, /u/, /o/ dhe prej njëzet e shtatë bashkëtingëlloreve /p/, /t/, /c/, /ç/, /q/, /k/, /f/, /th/, /s/, /sh/, /b/, /d/, /x/, /xh/, /gj/, /g/, /v/, /dh/, /z/, /zh/, /m/, /n/, /nj/, /l/, /ll/, /r/, /j/.<sup>118</sup>

Përsa u përket fonemave zanore të të folmes së Devollit, siç vihet në dukje dhe nga disa gjuhëtarë, inventari i tyre është i njëjtë me atë të gjuhës letrare dhe të pjesës më të madhe së arealit kryesor të toskërishtes veriore. Duke u nisur nga klasifikimi i të dhënave dialektore, zanoret e theksuara të kësaj të folmeje bëjnë pjesë në arealin e dytë, i cili ka një shtrirje mjaft të gjerë dhe përmbledh të folmet e Myzeqesë, Mallakastrës, qytetit të Vlorës, fshatrave përreth Mifolit dhe Selenicës, të folmen e Beratit dhe Skraparit, të Tepelenës dhe të anës së djathtë të Vjosës, të zonës së Oparit, Mokrës, Gorës, Korçës, të zonës së Prespës në Maqedoni, të Kolonjës, Përmetit, Zagorisë, Lunxhërisë, si dhe të folmet kalimtare të Lushnjës, Sulovës, Vërçës.<sup>119</sup> Këto zanore realizohen si fonema zanore të shkurtra gojore.


<sup>118</sup>J.Gjinari, Gj Shkurtaç, Dialektologjia, shblu, Tiranë, 2003, f. 114; f. 130-131.

<sup>119</sup>Në të folmet e arealeve të tjera numri i fonemave zanore është më i madh, përjashtuar arealin e parë që ka në inventarin e vet gjashtë zanore të shkurtra gojore ( J.Gjinari, Gj Shkurtaç, Dialektologjia, shblu, Tiranë, 2003, f. 180.)



**Fig. 1. Zanoret patheksuara të të folmes së Devollit**

Për nga inventari i zanoreve të patheksuara, e folmja e Devollit bën pjesë në arealin e parë, me inventar të plotë prej shtatë zanoresh, ku hyjnë dhe pjesa më e madhe e të folmeve të të dy dialekteve.



**Fig. 2. Zanoret e theksuara të të folmes së Devollit**

Nga pikëpamja e varianteve fonetike, dallojmë variantet fonetike absolute dhe ato të kushtëzuara. Të parat nuk varen nga kushtet fonetike të fonemës në një fjalë, ndërsa të dytat janë të kushtëzuara, d.m.th., nyjëtohen në variante të ndryshme për shkak të ndikimit të tingujve fqinjë dhe pozicionit që zënë në fjalë.

**Variantet fonetike absolute.** Në të folmen e Devollit zanoret e ngritjes së mesme (e, ë, o), realizohen në variante më të mbyllura se në zona të tjera të toskërishtes. Fonema ë, nga bartësit e vjetër të gjuhës, nyjëtohet disi më e buzorëzuar dhe më e prapme, ndërsa në raport me të folmet e tjera të toskërishtes, ajo nyjëtohet më e përparme (ashtu si dhe në Myzeqe dhe Berat). Kjo zanore, si e theksuar, është karakteristike vetëm për toskërishten<sup>120</sup>.

<sup>120</sup> J. Gjinari thekson se kjo zanore shihet në raport me zanoren ë të patheksuar, e cila gjendet në të gjitha të folmet (J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, Dialektologjia, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 184).

**Variantet fonetike të kushtëzuara.** Përgjithësisht këto variante dalin në të folmet e dialektit verior, por, në të folmen e Devollit, dalin variante të kushtëzuara të togjet e zanoreve ua, ye, ie. Këto grupe zanoresh në këtë të folme nyjëtohen si diftongje në rrokje të mbyllur në çdo pozicion të fjalës (duártë, djéllën) apo në rrokje të hapur vetëm në mes të fjalës (i përziérë, guáčkë, kuáčkë) si në të gjitha të folmet e toskërishtes, por realizohen si diftongje dhe në rrokje të hapur fundore (djé, kurískua, u rrëfyé, agáj etj.).

Po t'u referohemi dallimeve në përbërjen fonematike të fjalës, në ndryshim nga pjesa më e madhe e të folmeve të toskërishtes si dhe në tërë dialektin geg, ë-ja fundore e patheksuar ruhet dhe shqiptohet mirë (bukë, pulë, djathë). Kjo zanore, kur ndodhet një rrokje larg theksit, ka raste që shndërrohet në i (ginjéshtrë, fingjíl).

Po ashtu, ruhet qartë dhe shqiptohet mirë dhe zanorja y, duke u dalluar mirë nga toskërishtja jugore, ku kjo fonemë është kthyer në i. Por, njëherazi, vihet re që kjo zanore, në disa raste, është përfutur si variant i kushtëzuar fonematik, nga qiellzorëzimi i zanores u (lyes>lues>lves>vles).

I vetmi dallim i pakushtëzuar në përbërjen fonematike të fjalës vihet re në ruajtjen e e-së në ato fjalë ku në gegërishte kemi një e-hundore (zemër, dhen, brenda etj.).

Duke u nisur nga veçoritë nyjëtimore, akustike dhe funksionale të zanoreve të dialektit të Devollit, mund të vihet në dukje se sistemi vokalik i kësaj të folmeje përbëhet nga tri radhë fonemash në bazë të tiparit të lokalizimit: radha e fonemave të përparme /i/, /y/ dhe /e/, radha e fonemave të mesme /ë/ dhe radha e fonemave të prapme /a/, /u/, /o/. Nga pikëpamja e tiparit të shkallës së hapjes dallohen tri seritë fonologjike: seria e të mbyllurave /i/, /y/, /u/, seria e gjysmë të mbyllurave /e/, /ë/, /o/ dhe seria e të hapurave me fonemën /a/.

Në sistemin zanor të kësaj të folmeje dallohen pesë kundërvënie mungesore:

- 1) /i/-/e/, në bazë të tiparit të hapjes, ndërkohë që /i/ dhe /e/ janë të radhës së përparme dhe jobuzore, /i/ nyjëtohet si zanore e mbyllur, ndërsa /e/ nyjëtohet si zanore gjysmë e mbyllur.
- 2) /u/-/o/, po në bazë të tiparit të hapjes, ku zanorja /u/ nyjëtohet si e mbyllur dhe /o/ si gjysmë e mbyllur.
- 3) /y/-/u/, krijohet si kundërvënie mbi bazën e tiparit të radhës, ku /y/ është zanore e radhës së përparme, ndërsa /u/ e radhës së prapme.

4) /e/-/ë/, kjo kundërvënie mungesore krijohet te dy zanore jobuzore, gjysmë të mbyllura, mbi bazën e radhës. /e/ nyjtohet si zanore e radhës së përparme, ndërsa /ë/ si zanore e radhës së mesme.

5) /i/-/y/ kundërvihen mbi bazën e tiparit të buzorëzimit, ku /y/ nyjtohet si zanore buzore.

Për kundërvënien /e/-/ë/ duhet të vëmë në pah që në të folmen e Devollit, /ë/ nyjtohet disi më e përparme në raport me të folme të tjera të toskërishtes, por ky tipar nuk e neutralizon kundërvënien. Këtë e vërteton prania e çifteve minimale, si: ne-në, de-dë (parafjalë e emërores-parafjalë e kallëzores). Ndërsa /i/ dhe /y/ dallohen qartë, pavarësisht ndryshimeve fonemore të kushtëzuara që pësojnë në raport me tingujt fqinjë. Kjo duket në çiftet minimale në këtë të folme, si: tinë (lloj balte)-tynë, mbill-mbyll, sitë-sytë etj.

Lidhur me inventarin e fonemave bashkëtingëllore, kjo e folme bën pjesë në arealin e dytë, bashkë me të folmen e Beratit dhe rrethinave të tij, si dhe me të folmen e Korçës dhe fushës së Korçës<sup>121</sup>. Në këtë inventar, në dallim nga gjuha standarde, kanë dalë fare nga sistemi dy fonema: bashkëtingëllorja faringale /h/ dhe bashkëtingëllorja dridhëse /rr/, duke e kufizuar këtë inventar me 27 fonema bashkëtingëllore. Këto fonema nuk ndihen si në fondin e trashëguar të indoevropianishtes apo huazimet e vjetra nga greqishtja e vjetër (kallojer, lakrë, korë, bendevrekë etj.); nga latinishtja (kërqele, ljepur, fjeshtë, fembrë, kulloshtër etj.); po ashtu dhe në huazimet e reja nga sllavishtja (brokë, roshnicë, darovis, rizë, branë etj.) apo nga turqishtja (anxhar, asullde, amamçe, çarçaf, çërape, ambar etj.).

<b>p</b>		<b>t</b>	<b>ʈ</b>	<b>ʈʰ</b>		<b>c</b>	<b>k</b>
<b>b</b>		<b>d</b>	<b>ɖ</b>	<b>ɖʰ</b>		<b>ʃ</b>	<b>g</b>
	<b>f</b>	<b>θ</b>		<b>s</b>	<b>ʃ</b>		
	<b>v</b>	<b>ð</b>	<b>z</b>	<b>ʒ</b>			
	<b>m</b>	<b>n</b>				<b>ɲ</b>	
						<b>j</b>	
			<b>l</b>	<b>ɭ</b>			
			<b>r</b>				

**Fig. 3. Bashkëtingëlloret e të folmes së Devollit**

<sup>121</sup> J.Gjinari, Gj. Shkurtaj, Dialektologjia, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 195-196.



Bashkëtingëlloret në të folmen e Devollit kundërvihen në bazë tiparit binar të zëshmërisë, pra seria e të shurdhëtave me serinë e të zëshmeve.

**/p/, /t/, /c/, /ç/, /q/, /k/, /f/, /th/, /s/, /sh/  
/b/, /d/, /x/, /xh/, /gj/, /g/, /v/, /dh/, /z/, /zh/**


Në këtë bashkëlidhje, mbi bazën e tiparit të zëshmërisë, nuk merr pjesë fonema /h/, jo për faktin se nuk ka gjegjëse të zëshme, po, si një fonemë skajore e sistemit bashkëtingëllor, ajo nuk ndihet fare në këtë të folme. Duke u mbështetur në tiparin e mënyrës së formimit, seria e bashkëtingëlloreve mbylltore kundërvihet me serinë e bashkëtingëlloreve shtegore të kësaj të folmeje.

**/p/, /t/, /c/, /ç/, /b/, /d/, /x/, /xh/, /q/, /k/<sup>122</sup>  
/f/, /th/, /s/, /sh/, /v/, /dh/, /z/, /zh/, /j/,**

Dhe këtu, fonema mbylltore /k/ nuk ka gjegjëse shtegore, sepse shtegorja glotale /h/ ka dalë nga sistemi bashkëtingëllor i kësaj të folmeje.

Duke u nisur nga këto dy tipare vëmë në dukje se bërthama e sistemit bashkëtingëllor të së folmes së Devollit përbëhet nga 24 bashkëtingëllore në bashkëlidhjet përkatëse të vendosura përgjatë brinjëve të kuboidit (fig. 5). Të gjitha bashkëtingëlloret e bërthamës së sistemit janë të njëjtat me bërthamën e sistemit bashkëtingëllor të shqipes standarde. Në sistemin e bashkëtingëlloreve të të folmes së Devollit vihen re katër seri fonemash dhe pesë radhë të tilla.

Në këtë të folme ekzistojnë dallime me gjuhën standarde përsa i përket numrit të tufave korrelative trigjymtyrëshe për shkak të mungesës së dy fonemave /h/ dhe /rr/. Kështu janë neutralizuar kundërvëniet:




Fonemat hundore m, n, nj në të folmen e Devollit janë të njëjta me gjuhën standarde dhe gjenden të shqiptuara mirë në çdo pozicion të fjalës. Ato bëjnë pjesë në bërthamën e sistemit, megjithëse ato nuk mund të hyjnë në korrelacion me mbylltoret e zëshme dhe të shurdhëta. Por,

<sup>122</sup> Krahasimi me gjuhën standarde është bërë duke u bazuar në sistemin e vokalik dhe konsonatik të shqipes standarde, të dhënë nga R. Memushaj në “Fonetika e shqipes standarde”, Toena, Tiranë, 2009.

ato formojnë tufa trigjymtyrëshe me mbylltoret buzore dhe qiellzore përkatëse. Kjo vërtetohet dhe nga fakti që në pozicione të caktuara këto bashkëtingëllore asimilohen plotësisht (kjo dukuri ndodh në disa parafjalë të së ashtuquajturës “rasë vendore”, si: bi, dë, dënë, dëpër). Megjithatë, kjo nuk ndodh në çdo rast, rrallë ndodh që asimilohet bashkëtingëllorja buzore njëllor si në të folmet gege (p.sh., mbi>mi, ta gjezdis mal e mi mal; hipi macja mi Starovë,<sup>123</sup>). Si rrjedhim, ato ruajnë lidhje më të forta me bërthamën e sistemit të bashkëtingëlloreve se sa bashkëtingëlloret rr dhe h që nuk bëjnë pjesë fare në inventarin e fonemave bashkëtingëllore të kësaj të folmeje. Kështu në bërthamën e sistemit fonetik mund të futen dhe tri bashkëtingëlloret e tingullta hundore.

<b>f</b>	<b>th</b>	<b>s</b>	<b>sh</b>		
<b>v</b>	<b>dh</b>	<b>z</b>	<b>zh</b>	<b>j</b>	
<b>p</b>	<b>t</b>	<b>c</b>	<b>ç</b>	<b>q</b>	<b>k</b>
<b>b</b>	<b>d</b>	<b>x</b>	<b>xh</b>	<b>gj</b>	<b>g</b>
<b>m</b>		<b>n</b>		<b>nj</b>	

**Fig. 4. Bashkëtingëlloret e bërthamës të sistemit**



**Fig. 5. Kuboidi i bashkëlidhjeve të bashkëtingëlloreve të të folmes së Devollit**

<sup>123</sup> K. Zdruli: Folklor nga Devolli i Sipërm, Botim i ASH, Tiranë, 1987, f. 398.

Po kështu, ruhen në inventarin e bashkëtingëlloreve, grupet mb, nd, ng, në çdo pozicion: në fillim, në mes dhe në fund të fjalës dhe bëjnë përjashtim vetëm disa parafjalë vendore<sup>124</sup> të cilat asimilohen plotësisht bashkëtingëlloret hundore m dhe n. Ndërkaq, grupit kl, ka kohë që është asimiluar dhe te folësit e sotëm pothuaj nuk ndihet. Praninë e këtij grupi e hasim vetëm në disa toponime<sup>125</sup> dhe në disa banorë të moshuar të krahinës. Por prania e këtij grupi dëshmohet edhe në materialet folklorike e gjuhësore të mbledhura nga një sërë dialektologësh.

Ndër dallimet fonologjike, më karakteristike është shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme fundore (i math, urofnë, plump, qymes), por nuk bëjnë përjashtim dhe shurdhimet e të zëshmeve brenda fjalës apo në fillim të saj (dhëntin, xbres, i barthkë, lëçuánë), ndërsa si një dallim i kushtëzuar në përbërjen fonematike të fjalëve është kalimi j>nj si mbaresë foljore në të tashmen dhe të pakryerën e foljeve të zgjedhimit të parë dhe të tretë (punonj-punonja, shkonj-shkonja, vinj-vinja, a-anja, fle-flinja, ri-rinja). Këto tipare të përgjithshme bëjnë të mundur që nga veçoritë fonetike karakteristike të kësaj të folmeje, ajo të dallohet si një e folme që ka ruajtur mjaft tipare të vjetra, të cilat e veçojnë në grupimin lindor të toskërishtes veriore. Një pjesë e këtyre tipareve përbëjnë dukuri të konservacionit gjuhësor dhe vijnë prej gjendjeve të hershme fonetike të shqipës (ruajtja deri vonë e grupeve kl, gl, ruajtja dhe sot e grupeve lg, lk, bashkëtingëllorja -nj e pazhvilluar në -j, si mjet gramatikor sidomos si mbaresë foljore për trajtat gramatikore të disa foljeve.

Nga ana tjetër, në këtë të folme ka disa dukuri që lidhen me zhvillime fonetike të pavarura, të cilat nuk ruhen nga gjendja e vjetër e gjuhës. Në të folme të tjera, këto dukuri, janë zhvilluar në tjetër mënyrë, gjë që tregon inovacion gjuhësor, i cili ka ndodhur vetëm në këtë të folme dhe që, për një arsye ose një tjetër, sot është ndërprerë (p.sh. asimilimi i hundoreve në parafjalët e së ashtuquajturës “rasë vendore”).

---

<sup>124</sup> I quajmë të tilla sepse, në këtë të folme, mund të themi se ekziston ende një rasë e tillë, që sa vjen dhe po zëvendësohet me rasën kallëzore.

<sup>125</sup> Këto toponime lidhen kryesisht me emra vendesh ku diku ka pasur kisha, në strukturën gramatikore të këtyre toponimeve hasen ndërtimet parafjalë + emër (Dë klishtë, Ngaj klishta) ose togfjalësh emër + emër, ku emri i parë i referohet ndonjë objekti që ndodhet aty (Lisi i madh de klishta).

## 3.2 Sistemi zanor

### 3.2.1 Zanoret e theksuara

**Zanorja [ë].** Kjo zanore, si në të gjithë toskërishten, i përgjigjet një a-je që ndodhet para bashkëtingëlloreve hundore m, n, nj. Ky proces kthimi ka ndodhur dhe kur këto bashkëtingëllore kanë rënë historikisht dhe kur mbi hundoren n ka vepruar dukuria e rotacizmit (shkëmp, dhëmp, dhëntret, i mëngjër etj.).

V. Xhaçka thekson se: "...edhe këtu, si në të gjithë toskërishten, kemi ë-në tonike në ato pozita që ndodhet a-ja e gegërishtes."<sup>126</sup> Kjo a përpara bashkëtingëlloreve hundore është kthyer vetëm në disa fjalë turke, si: musëndër, nallëne, çallëm, por në të tjera ka mbetur, si: ashllama, Osman, Hasan, aksham, amamçe, ajvan etj. Te banorët e vjetër të Devollit, sipas J. Gjinarit, kjo ë është më pasme dhe më e buzorëzuar se në të folmet e Beratit, Skraparit, Myzeqesë dhe Mallakastrës<sup>127</sup>. Megjithatë, mund të theksojmë se sot kjo zanore, pavarësisht se shqiptohet si zanore e radhës së mesme në fjalë, si: këngë, këmbë, dhëmb etj. ajo nyjëtohet disi më e përparme se në të folmet e tjera duke iu përfruar zanores e.<sup>128</sup>

**Zanorja [e].** Si në të gjithë trevat e Korçës, zanorja e para hundoreve nuk është kthyer në ë (zembrë, pendë, gjembi, i shtrembrë, u trempmë). Kjo e, së cilës në gegërishte i përgjigjet një ê hundore, sipas Gjinarit<sup>129</sup> është shndërruar në ë vetëm në disa fjalë, si: mënt, vënt, mënde, të zëç, ta lëç (te dy foljet kjo dukuri ndodh kur ato janë në lidhore ose dëshirore, në trajta të tjera gramatikore ato shqiptohen me e: zere, lere). Në të folmen Devollit zanorja e përfron më tepër me një [e] të hapur.

**Zanorja [y].** Në ndryshim nga të folmet jugore të toskërishtes, y-ja e theksuar shqiptohet qartë si zanore e përparme e buzorëzuar, në të gjitha pozicionet në fjalë (yll, sy, tym, qymyr, tynë, atyreve etj.). Por, në disa raste, kjo zanore ka ardhur nga qiellzorëzimi i u-së në fjalë ku ky tingull gjendet para ose pas një tingulli alveo-dhëmbor, alveolar, alveo-qiellzor apo qiellzor (j, t, sh, q), si: yve (juve), flytyron (fluturon), yshqimnë (ushqimin), sëndyqkë (sënduqkë) etj.

<sup>126</sup> V. Xhaçka, Një shikim mbi të folmen e krahinës së Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 2, 1956, f. 108.

<sup>127</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 105.

<sup>128</sup> Nëse do të ndërtonim fushat e përndarjes të këtyre zanoreve, ato priten dhe në të folmen e Devollit zanoja ë ka vlera më të larta të formantit F<sub>2</sub> se në të folmet e tjera të toskërishtes, duke u shqiptuar si një zanore midis ë-së dhe e-së. Në labërishte dhe në çamërishte zanorja ë është e qartë në çdo pozicion.

<sup>129</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 105.

Në punimin e V. Xhaçkës<sup>130</sup> përmendet se në disa fshatra fjala kripë shqiptohet me y. Mendojmë se duhet të jetë një dukuri e vjetër, ngaqë kjo dëshmohet dhe nga fjala e prejardhur krypënicë “mbajtëse kripe”, e cila gjendet dhe si toponim (Kodra e Krypënicës në fshatin Kapështicë), po kështu, dhe në fjalën mbruj-mbryj (kam një javë e kam një muaj./ që po mbryj e po gatuj)<sup>131</sup> .

### 3.2.2 Zanoret e patheksuara

**Zanorja [ë].** Në të folmen e Devollit kjo zanore është ruajtur mirë dhe shqiptohet qartë në të gjitha pozicionet.

- 1) Ruhet dhe shqiptohet qartë si ë fundore në fjalët me theks parafundor, pavarësisht nga numri i rrokjeve (p.sh. në emra, si: farë, dizgë, zembrë, shçizë; në mbiemra, si: i butë, i lëmpitë, i fortë; në pjesoret e foljeve, si: vluarë, rëfyerë, gëdhirë; në numërorë, si: tetë, dhjetë; në vetën e parë dhe të tretë shumës të disa foljeve në të tashmen e dëftores, si: erthmë-erthnë, xbritmë-xbritnë, folmë-folnë, katandismë-katandisnë, kanështis- kanështisnë).

Në ndryshim nga disa folme të toskërishtes jugore (p.sh. në çamërishte ku ruhet ë-ja pastheksore në trajtat buritë-burënë, djalinë-djalënë)<sup>132</sup> kjo ë fundore ka rënë te emrat në rasën gjinore dhe kallëzore (burit-burën, djalit-djalën, fushës-fushën, malin-malën, lëmin-lëmën), te disa mbiemra të emëruar me theks parafundor, si: të mirit- të mirin, të keqes- të keqen. Po ashtu, kjo ë fundore ka rënë dhe te pjesoret e foljeve që mbarojnë me -ur (ardhur, ikur, vajtur, mbodhisur, inandisur), si dhe te disa ndajfolje (lark, anës, afër). Zanorja ë e patheksuar gjendet dhe në mes të fjalës kur ndodhet menjëherë pas rrokjes së theksuar (kopësht, çupëz, qumëshç, pe së vjetërve etj.).

- 2) Për ë-në e patheksuar para një rrokjeje të theksuar janë shfaqur dy mendime të ndryshme. V. Xhaçka thekson se kjo ë bie (vlla-vllezër, njerzija, ndronj, baktija,

<sup>130</sup> Shih V. Xhaçka, Një shikim mbi të folmen e krahinës së Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 2, 1956.

<sup>131</sup> Këngë popullore të rrethit të Korçës, ASH, 1982, f. 427.

<sup>132</sup> Shih Q. Haxhihasani, Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971.

xvoglonj etj.)<sup>133</sup>. Ndërsa J. Gjinari e kundërshton këtë përfundim, duke theksuar se kjo nuk është dukuri e përgjithshme, kjo ë e patheksuar, para një rrokjeje të theksuar gjendet në shumë fjalë, pavarësisht nga numri i rrokjeve (gërshërë, lagështirë, gëdhent, misërishtat, pe dërase)<sup>134</sup>. Duke u nisur nga materiali i mbledhur në terren, vërejmë se zanorja ë-e patheksuar paraqitet në disa variante:

- Ajo ndihet e qartë, e parrëgjuar në fjalë, si: dëborë, këteja-këtezajn; si dhe në disa fjalë ku ajo ndërfitet si zanore që lehtëson shqiptimin e një grupi bashkëtingëlloresh, si: gëdhent, dë të gëdhirë, ushtërija etj.
  - Është rrëgjuar në gjatësi në fjalë, si: përuea, përvëlaqe, sëpatë etj.
  - Ka rënë pothuaj plotësisht në fjalë, si: bakti, vlla-vllazëri-vllamë, misrok, ktu, kshu, të dorzonjë etj.
- 3) Ë-ja e patheksuar ka rënë në rastet kur është ndodhur në rrokjen fundore të disa fjalëve me theks tejfundor, si: kumbull(ë), uthull(ë), çupës(ë), krushkës(ë) etj. Megjithëse në variantet e këngëve popullore ruhen, kjo bëhet për efekt të ruajtjes së numrit të rrokjeve në varg.
  - 4) Kur në fund të fjalëve me theks parafundor, ndodhet një bashkëtingëllore e tingullt (m, n, l, r) që ka përpara një ose dy bashkëtingëllore të tjera, ë-ja e patheksuar gjendet pas të tingulltës (veglë, pjeprë, embrë, kulloshtërë, fjeshtërë, kësmetnë, *dysheknë, mjellnë, pyetmë, t'atnë, zbritnë* etj.).
  - 5) Në disa raste të veçanta ë-ja e patheksuar është kthyer në i (ginjeshtrë, fngjillos, gjilpërë). Kjo dukuri ka ndodhur sepse kjo zanore është gjendur para një bashkëtingëllores qiellzore, si rrjedhim është kthyer në zanore të mbyllur për shkak të afrimit të trupit të gjuhës drejt qiellzës së forte, nën ndikimin e nyjetimit të bashkëtingëllores përkatëse qiellzore pranë saj.
  - 6) Lidhur me fjalët lëmínj dhe lëmçínj, mund të themi se në to ka ndodhur zhvendosja gramatikore e theksit në shumës, pra këtu nuk kemi kalim ë>i, por kalim të theksit në prapashtesën trajtëformuese -nj të shumësit të pashquar të emrave përkatës, e cila është zgjeruar me zanoren fundore i të temës së këtyre emrave.

<sup>133</sup> Shih V. Xhaçka, Një shikim mbi të folmen e krahinës së Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 2, 1958.

<sup>134</sup> Shih J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960.

7) Përse i përket fjalëve të tjerit (të tjerët), tonit (tonët) erthnë të parit (erdhën të parët), J. Gjinari thekson se i ka mundësi të ketë lindur si zanore mbështetëse dhe jo të jetë përftuar nga ë-ja<sup>135</sup>. Është fakt që në këto fjalë i nuk është pjesë e temës së fjalës, ajo përdoret kur këta mbiemra dhe përemra emërzohen. Nga emërzimi, krijohen emra në rasën emërore dhe kallëzore të cilat i ndërfitet në grupin bashkëtingëllor të krijuar nga takimi i fundores së temës me nyjen shquese (të tjer(ë)-i-t, ton(ë)-i-t)<sup>136</sup>.

**Zanorja [i].** Kjo zanore, pranë një zanoreje të theksuar bëhet pjesë e diftongut. Kjo dukuri haset në rrokje të hapur fundore (punoí, martoí, babaí, agaí, etj.). Në diftongjet, të cilat gjenden në mes të fjalës i-ja shqiptohet e qiellzorëzuar, duke iu përafuar shumë nyjetimit të bashkëtingëllores j (mbjellëm, mjellnë, djelli etj.). Por, ka fjalë ku kjo i e patheksuar ka rënë (qell). Kjo dukuri, e vënë re nga V. Xhaçka, haset dhe sot, sidomos nga folësit e vjetër (flytyronte dë qellt). Është e kuptueshme se kjo ndodh meqënëse theksi bie në elementin e dytë të diftongut, aq sa element i parë i tij rrëgjohet pothuaj plotësisht.

Në disa fjalë zanorja i- e patheksuar është buzorëzuar për shkak të rrethimit fonetik nga bashkëtingëlloret buzore (varianti pyperka, pyper gjendet në të gjithë zonën e Devollit të Poshtëm, ku i, e ndodhur pas një mbylltoreje dybuzore, është asimiluar në y).

**Zanorja [u].** Kjo zanore është pjesë e diftongut *ua*, si në mes dhe në fund të fjalës. Në rastet kur kjo zanore shërben si mjet gramatikor për formimin e disa trajtave të fjalëve, vëmë re se:

- 1) Kur u shërben si mbaresë e trajtës së shquar të emrave mashkullorë ajo është kthyer në f (u>f dhef; më ngre dhef – më ngre dheu, e hëngri dhef- e hëngri dheu).
- 2) Kjo dukuri vihet re sidomos kur këta emra vihen në rasat e zhdrejta dhe në rasën kallëzore apo vendore (më futi dë dheft, shkoi de kadif, i thashë dyqanxhif, djali i Nazmift, takova daifnë, e ndreft - e drerit etj.).
- 3) Po kështu kemi kalim u>f, kur u shërben si mbaresë e vetës së tretë të foljeve në kohën e kryer të thjeshtë, në formën veprorë dhe joveprorë (e fitof atë ditë, u kthef bë të gdhirë, shkof e vate, arrif dimri etj.).

<sup>135</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 106.

<sup>136</sup> K. Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1995, f. 301.

Ndryshe nga J. Gjinari që e kufizon këtë dukuri vetëm në fshatin Bitinckë duke theksuar se kjo dukuri nuk vihet re në katunde të tjera<sup>137</sup>, mund të vihet në dukje se nga materiali dialektologjik i mbledhur në terren, kthimin u>f gjendet pothuaj në të gjithë fshatrat me popullsi myslimane<sup>138</sup>.

J. Gjinari shkruan se kjo dukuri shfaqet në të folmen e fshatrave Hoçisht dhe Sinicë si një proces që duket në ndërtimet sintaksore të tipit dheu i zi, ku nyja shquese u është kthyer në v për të shmangur shqiptimin e dy zanoreve, po këtu ka mbetur deri në këtë fazë. Në folklorin e Devollit të Sipërm kjo dukuri është e pranishme në disa nga këngët e katundeve Ziçisht, Miras, Arrëzë, te foljet që mbarojnë me eu, zanorja fundore u dëgjohet si bashkëtingëllorja buzore-dhëmbore f. Është me vend të besohet se në të folmet e fshatrave ku gjenden rëndom fjalët ku ndodh kalimi u>f ka ndodhur procesi i mësipërm dhe më tej kemi dukurinë e shurdhimit të të zëshmeve në pozicion fundor.

Megjithatë, në këngët e Devollit të Sipërm është hasur u>v, si pjesë e diftongut: **Dvall** andarët po lëftojnë,.. / po ne vendin nuk **va** dhamë,.. / **dvamë** Voriepironë.<sup>139</sup> Pavarësisht se është pjesë e diftongut, zanorja u pëson të njëjtat ndryshime. Dhe E. Çabej e quan këtë si një gjysmëzanore, e cila, në përbërje të diftongjeve me këtë zanore, përfaqëson një v dybuzore që përbën një rrokje të vetme me zanoren që vjen para ose pas saj.<sup>140</sup>

### 3.2.3 Togjet e zanoreve dhe diftongjet

Në përgjithësi, në zonën e Devollit, në ndryshim nga të folmet e tjera të toskërishtes, vihet re ruajtje e mirë e diftongjeve. Ato gjenden në çdo pozicion, megjithatë në diftongje të caktura vëmë re disa dukuri fonetike.

**Diftongu *ua*.** Ky diftong gjendet në të gjitha pozicionet në fjalë:

- 1) në rrokje të hapur në mes të fjalës (**gruaja**, **buallicë**, **kuaçkë**, i mësuarë, i çkolluarë, lëçuamë etj.);
- 2) në rrokje të mbyllur në mes të fjalës (**bluajmë**, **duallmë**, **suallmë**, përcuallnë etj.);

<sup>137</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 107.

<sup>138</sup> Shembujt e përmendur janë mbledhur në fshatrat Bitinckë, Vranisht, Pilur, Baban, Stropan, Braçanj etj.

<sup>139</sup> Këngë popullore të rrethit të Korçës, botim i ASH, Tiranë, 1982, f. 126.

<sup>140</sup> Shih E. Çabej, Diftongje e grupe zanoresh të gjuhës shqipe, BUSHT, SSHSH, nr. 3, 1958, f. 82.



- 3) në rrokje fundore të hapur (duket sidomos në antroponimet dhe në kohën e kryer të thjeshtë të foljeve me temë në o, si: Jorgua, u martua, u çpua, kuriskua, u ndrua, u lëçua etj.);

Te foljet martohem, fejothem, çpohem, të cilat, në formën veprorë, mbarojnë me temë në o të patheksuar, në të kryerën e thjeshtë o-ja kalon në diftongun ua. Ky diftong, ashtu si dhe të gjitha diftongjet e tjera të kësaj të folmeje, shqiptohet i shkurtër dhe ngjites, ngaqë në toskërishten veriore, në tërësi, nuk u ruajtën zanoret e gjata, për rrjedhojë dhe diftongjet e gjata.<sup>141</sup>

Por, nëse në foljet e mësipërme, diftongu ua ruhet dhe shqiptohet qartë në pozicion fundor në rrokje të hapur, kjo nuk ndodh te foljet që kanë këtë grup si togzanor, si: paguaj, them-thuaj, bluaj. Te këto folje ky togzanor ka kaluar në o (ku të pagojmë, thoji të vijë, vajti të blojë) dhe kjo vihet re te të gjithë folësit, si të brezit të vjetër, atij të mesëm dhe të ri, ndërkohë që pjesoren e po këtyre foljeve e gjejmë me diftong (paguarë, bluarë).

Ky diftong ruhet te emrat femërorë me o të patheksuar në temë. Kjo o e temës në trajtën e shquar të këtyre emrave kalon në diftongun ua, i cili, shqiptohet si i tillë, edhe pse ndodhet në pozicion fundor në rrokje të hapur. Një dukuri e tillë vihet re sidomos te emrat vetjakë të tipit Niko-Nikua, Maqo-Maqua, Miço-Miçua, të cilët në gjuhën standarde paraqiten Maqoja, Nikoja, Miçoja. Po ashtu, kjo dukuri ndodh dhe në emra të përgjithshëm, si kurizo-kuriskua, mapo-mapua. Sipas J. Gjinarit<sup>142</sup> te emrat e këtij tipi kemi takim të dy zanoreve të ndryshme, ku zanorja o e shkurtër e patheksuar e temës është takuar me nyjen e prapme shquese femërore a. Bashkimi i tyre ka dhënë një diftong jo të gjatë oa i cili, më pas u kthye në ua. Ky kthim lidhet me faktin që diftongu ndodhej në fjalë të tjera, në të cilat vinte nga zbërthimi i o-së së patheksuar.

Te emrat luadh, grua, bualli, mua grupi i zanoreve ua ndihet më tepër si togzanor sesa si diftong, ngaqë te këto fjalë nuk kemi zbërthim të një o-je të patheksuar. Elementi u (zanorja e mbyllur) në këtë grup zanor bart theksin e fjalës. Mund të thuhet se këtu grupi ua ruhet si togzanor, sepse kjo folje vjen si rrjedhim i prapashtesimit nga tema e foljes bluaj që e përmendëm më sipër. Gjithashtu, në disa raste, në të folmen e Devollit të Sipërm janë hasur dhe

<sup>141</sup> Shih J. Gjinari, Diftongjet ua/ue, ie dhe ye në të folmet e gjuhës shqipe, SF, nr. 1, 1968.

<sup>142</sup> Po aty, f. 103.

format muva, duva, ku një v epentetike hyn në mes të togzanorit ua dhe theksin e bart zanorja u (*Ty o plak unë s'të dúva, /se je plak e e s'bën për múva.*)<sup>143</sup>,

Për fjalët kllōčkë-**ku**ačkë, çfarë-**ç**uarë, xbathur-**xu**athur, J. Gjinari thekson se diftongu vjen si rrjedhim i një gjysmëzanore v(u) dybuzore e përftuar nga zhvillimi i bashkëtingëlloreve f, b, ll, të cilat fillimisht kaluan në buzore-dhëmboren v, e më pas u zhvilluan më tej duke përfunduar në u<sup>144</sup>. Ai, duke iu referuar Mirçevit, e lidh këtë me veçorinë e dikurshme të bullgarishtes për kthimin e v-së në v –dybuzore, e cila më vonë është zhdukur.<sup>145</sup> Peshën e diftongut, dhe këtu, e mban elementi i dytë, aq sa, te folësit e brezit të ri, fjala **ç**uarë ndihet më tepër çarë, sesa me diftong.

Diftongu **ua** dëshmohet qysh në në shekullin XIV edhe në dokumentet e shkruara, si te “Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve”, që vlerësohet si monumenti më i lashtë i toskërishtes, por ndërkohë është mbështetur dhe në onomastikën historike (emri i princit Gjin **B**ua Shpata, i cili gjallon dhe sot si patronim **B**ua në Dhërmi.<sup>146</sup>) Fakti që ua në të fomen e Devollit u ruajt si diftong dhe nuk u zbërthye në togzanor, tregon për një dukuri të konservacionit gjuhësor.

**Diftognu ié.** Ky diftong haset në të gjitha pozicionet:

- 1) në rrokje të hapur në mes të fjalës (**dié**llnë, **qié**llnë, **mjé**llnë etj.);
- 2) në rrokje të mbyllur në mes të fjalës (**mbjé**llëm, **pësh**tjéllëm-**fsht**jéllëm, **mjé**llëm etj.);
- 3) në rrokje fundore të hapur (**djé**, **bjé**, **atjé** etj.);

Diftongu ié, në këtë të folme është i shkurtër dhe ngjites dhe zanorja e e shkurter mban theksin e diftongut, meqënëse nga pikëpamja nyjëtimore zanorja e është me e hapur se zanorja i. Përsa i përket këtij diftongu, në fjalë, si: **mbjé**ll, **pësh**tjéllën, **vjé**llëm, kthimi i i-së në j ka ndodhur në të gjitha të folmet e shqipes, si në gjuhën standarde. Në toskërishten veriore nuk u ruajtën zanoret e gjata, për pasojë as diftongjet e gjata. Kjo solli që këto diftongje të shkurtra të ruheshin fillimisht në rrokje të mbyllura në trup të fjalës. Më pas, për analogji ose, ngaqë ndoshta dhe më parë këto diftongje nuk shqiptoheshin të gjata në këtë pozicion, ky proces përfshiu dhe diftongjet në rrokje të hapur në trup të fjalës.<sup>147</sup> Ndërsa fakti që ky diftong u ruajt edhe në rrokje të hapur fundore vetëm në disa të folme të toskërishtes veriore, ku përfshihet dhe e folmja e Devollit,

<sup>143</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, botim i ASH, Tiranë, 1987, f. 368.

<sup>144</sup> J. Gjinari, Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë jugore, Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve II, Tiranë, 1972, f. 270.

<sup>145</sup> Po aty.

<sup>146</sup> Shih E. Çabej, Diftongje e grupe zanoresh të gjuhës shqipe, BUSHT, SSHSH, nr. 3, 1958, f. 71-85.

<sup>147</sup> Shih J. Gjinari, Diftongjet ua/ue, ie dhe ye në të folmet e gjuhës shqipe, SF, nr. 1, 1968, f.102.

ende nuk mund të shpjegohet. Mbase, duhet të vështrohet si një dukuri e inovacionit të pavarur gjuhësor në këtë të folme.

Emrat **qiéll**, **miéll**, **diéll** etj. shqiptohen rëndom me diftongun ie, por te emri qiell kemi hasur dhe rastet të shqiptimit pa diftong (flytyronte dë qellt), kryesisht nga bartës të vjetër të dialektit. Sot, sidomos nga folësit e brezit të mesëm dhe të ri, nuk ndihet si rrjedhim i ndikimit të arsimimit dhe i përzjerjeve a lëvizjeve të mëdha të popullsisë.

**Diftongu yé.** Ashtu si diftongu ié, ai haset në të gjitha pozicionet dhe në rrokje fundore të hapur (lëryér, me të pyéturë, rëfyérë, rëmbyérë). Vlen të vihet në dukje që ky diftong, në pozicione të caktuara, ka kaluar në e (janë ktherë-janë kthyer, ndë kre-në krye, më ka rëmberë-më ka rrëmbyer). Në disa raste, ky diftong vjen si rrjedhim i buzorëzimit më të përparmë të u-së, duke u shndërruar në y, për shkak të bashkëtingëlloreve alveo-qiellzore para saj (lyes, Shyec).

Gjithashtu, diftongu zberthehet, por jo nga fakti se zanoret përbërëse ndahen në rrokje të ndryshme, por sepse në mes të diftongut ndërfitet një v (Shyec-Shyvec), që mund të jetë kundër hiatit.

Nga materiali dialektologjik i mbledhur në fshatrat Vishocicë, Hoçisht, Ziçisht, Vërlen etj. është hasur forma **byéj** (shumësi i emrit buall), të shqiptuar me diftong. Shndërrimi i diftongut *ya* në yé ka marrë vlerë gramatikore<sup>148</sup> dhe është një trajtë që gjendet e në format e vjetra po me këtë vlerë gramatikore.<sup>149</sup>

### 3.3 Sistemi bashkëtingëllor

#### 3.3.1 Bashkëtingëllore të veçanta

**Bashkëtingëllorja [h].** Bashkëtingëllorja glotale h nuk ndihet dhe nuk shqiptohet në çdo pozicion: në pozicion fundor, si: kra(h), tinë na nje(h), ple(h)), në mes të fjalës (të shomë-të shohim, kthesha- kthehesha, njerë-njëherë, aterë,atfere, atfernaj-atëherë) dhe as në pozicion nistor (ekurin, undë, ajdutnë, alë). Kjo bashkëtingëllore glotale nuk ndihet as te huazimet turke që e kanë këtë bashkëtingëllore në trup të fjalës (muabet, reat, muamedan), apo në pozicion

<sup>148</sup> Shpreh shumësin e emrit nëpërmjet metafonisë.

<sup>149</sup> Shih E. Çabej, Diftongje e grupe zanoresh të gjuhës shqipe, BUSHT, SSHSH, nr. 3, 1958.

nistor (alldup, auz, dë aurt, arabat, asullde, ebe, etj). Kjo dukuri ndihet më tepër te emrat vetjakë të, që e kanë këtë bashkëtingëllore në trup të fjalës (Muamet, Muamerali, Memetali).

Sipas J. Gjinarit, bashkëtingëllorja h ndihet disi në të folmen e banorëve të besimit mysliman<sup>150</sup>. Nga materiali dialektologjik i mbledhur në fshatrat Bitinckë, Vishocicë, Vranisht etj. të banuara me popullsi myslimane u vu re se kjo bashkëtingëllore nuk ndihej te bartësit e vjetër të gjuhës, më tepër ajo shqiptohej e qëllimshme (dukuri që ndodh më shumë te fëmijët në shkolla, në njerëz të arsimuar ose që kanë një lloj pozicioni shoqëror).

Ndërkohë, në antroponimin Mihal, rëndom haset forma Mikail (Bradvicë, Hoçisht, Ziçisht). Pra në këtë antroponim kemi procesin fonetik të velarizimit të h-së.

Te folja zë në formën joveprore zihem (me fjalë, me grushta), ky tingull glotal nuk ndihet, por ndoshta për të shmangur hiatin midis grupit prej dy zanoresh hyn bashkëtingëllorja r (zirem kos, ziren bash a bash).

**Bashkëtingëllorja [rr].** Bashkëtingëllorja dridhëse rr nuk bën pjesë në inventarin e bashkëtingëlloreve të kësaj të folmeje. Ajo nyjëtohet si r në çdo pozicion. Si rrjedhim i mungesës së kundërvënies rr//r, në këtë të folme nuk kemi formim të çifteve minimale të fjalëve: ara-arra, var-varr, ra- rra(h), të rinë(të riun)-të rrinë, por ato paraqiten si homonime gramatikore, të cilat dallohen ose nga konteksti, ose kur vendosen në trajta të ndryshme gramatikore.

J. Gjinari thekson se kjo bashkëtingëllore dridhëse, në fshatin Sinicë nyjëtohet si një r e ndërmjetme midis r-së dhe rr-së<sup>151</sup>. Mendojmë se kjo dukuri është më tepër një veçori e individit folës, sesa dukuri e veçantë e të folmes së këtij fshati.

**Bashkëtingëllorja [nj].** Bashkëtingëllorja e tingullt qiellzore nj është ruajtur mirë në çdo pozicion. Ajo ruhet në rrënjë të fjalëve (një, njeri, rrënja, dëllinja, nje(h), njëzet), në prapashtesat e shumësit të emrave dhe mbiemrave (ullinj, hunj, gjarpinj, lëminj, lëmçinj), si dhe në mbaresat e së tashmes dhe të së pakryerës të foljeve (lanj-a, punonj-a, pinja, lyenj-a, shkonj-a). Sipas J. Gjinarit, në të folmen e Progrit, vihet re zhvillimi i nj-së në j te mbaresat foljore të së tashmes<sup>152</sup>. Ky zhvillim është hasur dhe në fshatrat Vranisht e Pilur te foljet punoj-punoja, duroj-duroja, por krahas tyre dhe vinj- vinja, bënj-bënja). Mesa duket, zhvillimi i nj>j është një proces që vazhdon dhe në ditët e sotme.

<sup>150</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 109.

<sup>151</sup> Po aty.

<sup>152</sup> Në fakt kjo dukuri është vënë re dhe në fshatra të tjerë të krahut të majtë të lumit Devoll dhe mund të mendohet se është më tepër ndikim nga standardi i shkruar.

**Bashkëtingëllorja [th].** Bashkëtingëllorja ndërthembore e shurdhët th, në pjesën më të madhe të të folmeve të kësaj krahine, është shndërruar në buzore-dhëmboren e shurdhët f në pozicion nistor të fjalëve: i fellë, fingjill, fëllëzë, felë. Në trup të fjalës ajo ka mbetur th (uthull, dë Athinët). V. Xhaçka ka vënë në dukje dhe dukurinë e kundërt në të folmen e Ziçishtit, te fjala femër-thembrë në bartës të vjetër të gjuhës, ndërsa ne e kemi hasur edhe në të folmen e Hoçishtit

**Bashkëtingëlloret [I], [II].** Këto bashkëtingëllore nuk pësojnë shndërrime në pozicione të caktuara në fjalë. Bën përjashtim folja dal në tri vetat e shumësit të kohës së kryer të thjeshtë ku l>ll (duallmë, dualltë, duallnë). Po ashtu, kjo dukuri haset dhe në disa fjalë të huaja, si: llogjikë, pllani “vegël pune e mekanizuar me të cilën priten dërrasat duke ruajtur sipërfaqen e drejtë të saj”, Sollomoni etj. Gjithashtu ll vjen dhe si rrjedhim i asimilimit në distancë të dh-së në fjalën dhallë>llallë e në fjalët e prejardhura nga kjo temë (llallanik), apo edhe në foljen mbodhis>mbollis.

### 3.3.2 Grupe bashkëtingëlloresh

**Grupet mb, nd, ng.** Në të folmen e Devollit, grupet mb, nd, ng, ngj ruhen mirë dhe shqiptohen qartë:

- 1) në fillim të fjalës (mbush, u mbytç, mp(b)rojtës, ndanj, ndenja, ngre, ngas, ngjevi etj.);
- 2) në mes të fjalës (pëllëmbë, jamballi, këndje, kandilë, tundurashkë shtëllungë, çengelë, lengjer, mallëngjenjës, e mashëngjyerë etj.);
- 3) në fund të fjalës (shkëmp, pëllumb, vent, munt, mënd, deng, lënk etj.);

Këto grupe, si dhe në të folme të tjera të toskërishtes, nuk janë zhvilluar si në gegërishte. Por, në këtë të folme, vihen re dy dukuri:

**Së pari,** në parafjalët për rasën vendore këto grupe e kanë asimiluar pothuaj plotësisht bashkëtingëlloren hundore (shkoi dë malt, e ndeu bē djellët, dënë sergjen, b’atanë). Ky asimilim, sipas J. Gjinarit, ka ndodhur pikërisht te këto parafjalë dhe jo te fjalë të tjera që i kanë këto grupe sepse, duke qenë se parafjalët janë fjalë proklitike, të ndodhura larg theksit, u thjeshtuan në shqiptim.<sup>153</sup>

<sup>153</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 110.

**Së dyti**, sot kjo dukuri vihet re më tepër te folësit e brezit të vjetër dhe deri diku tek ata të brezit të mesëm. Te folësit e brezit të ri, këto parafjalë paraqiten si në mbarë shqipen të zhvilluara drejt ruajtjes së hundores, duke u përdorur si parafjalë të rasës kallëzore. Ky zhvillim ka ardhur si rrjedhim i ndikimit të gjuhës standarde nëpërmjet shkollimit, por dhe si rrjedhim i lëvizjeve të mëdha të popullsisë.

**Grupet nk, njk.** Në fakt këto grupe janë pranishme më shumë si raste të shurdhimit të grupit ng, sidomos në rrokje fundore, megjithatë, ka fjalë të cilat gjendet në përbërjen fonemore të fjalëve (banjkë, llainkë, finkë, stankë etj.). Këto bashkëtingëllore hasen kryesisht tek ato fjalë që kanë në temë bashkëtingëllore hundore dhe marrin prapashitesën zvogëluese –kë.

**Grupet kl, gl.** Këto grupe bashkëtingëlloresh të vjetra hasen shumë rrallë sot, kryesisht në folës mbi 60 vjeç dhe që banojnë në fshatrat e Devollit të Sipërm (Grapsh, Qytezë, Sinicë, Gjyres). Ato janë zhvilluar drejt qiellzoreve q dhe gj.

Prania e tyre në këtë të folme dëshmohet vetëm nga bartës të vjetër të gjuhës (klisha, klyçi, klinda, zgldh, zgledh, glemp, gluri). J. Gjinari thekson se këto grupe janë hasur vetëm në folës të krishterë (duke u mbështetur dhe në materialin e mbledhur nga V. Xhaçka).<sup>154</sup> Ai thekson se kjo mund të përgjithësohet për fshatra si: Sinica, Hoçishti, e Ziçishti, që janë në krahun e majtë të Devollit dhe kanë pasur vetëm popullsi të krishterë. Megjithatë, duhet të vihet në dukje se kjo dukuri dëshmohet dhe në Bitinckë me toponimin Varet e Klishës (varre që sot nuk janë më), në Kurilë me toponimin Klishka (vend ku më parë ka pasur kishë), në Eçmenik me toponimin Klisha, në Stropan me toponimin Lisi i madh de Klisha (dikur ka pasur një lis 150-vjeçar). Këto fshatra, ndodhen në anë të ndryshme të lumit Devoll. Fakti që emri i përgjithshëm klishë-a dëshmohet si toponim në formën e vjetër, përforcon mendimin që ky grup bashkëtingëllor është i hershëm në këtë krahinë, si në krahun e majtë dhe në të djathtë të lumit Devoll.

Tashmë procesi i kthimit të grupeve kl dhe gl, përkatësisht në q dhe gj, ka mbaruar. Për më tepër ky kalim nuk është bërë i shkallëshkallshëm, si në disa të folme të gegërishtes kl>kj, gl>gi (kian, giuri).<sup>155</sup> J. Gjinari vë në dukje se pleqtë e Sinicës e ndryshuan shqiptimin e këtij grupi që të mos ndiheshin të veçuar nga bashkësia territoriale ku bënin pjesë.<sup>156</sup> Megjithatë, duhet theksuar se, përderisa këto grupe janë hasur deri vonë në bartës të vjetër të gjuhës, kjo tregon për një dukuri të konservacionit gjuhësor. Për më tepër, ruajtja e grupit kl u bë te fjalët ku ajo u

<sup>154</sup> Po aty, f. 110.

<sup>155</sup> E. Çabej, Studime gjuhësore III, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 107.

<sup>156</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSSH, nr. 4, 1960, f. 110.

shndërrua në velaren k dhe jo në qiellzoren q (klisha, klyçi, klinda, ndërsa sot kemi kisha, kyçi, kinda). Ndërkohë, grupet kl dhe gl janë ruajtur në huazimet e mëvonshme, të cilat kanë hyrë pas zhvillimit të këtyre grupeve, si, p.sh., nga lat. glasë, sll. klečkë, gletë apo në disa toponime si Kokogllavë.

**Grupet lk, lg.** Këto grupe janë hasur vetëm në folës të brezit të vjetër dhe deri diku dhe atij të mesëm (alkë, sovlkë, balgë-balgor-balguce, ulku). Duhet theksuar se gjiithmonë e më tepër po vihet re kalimi i alveolares sonante anësore l në qiellzoren mesore j.

**Grupi sht.** Ky grup bashkëtingëlloresh është mjaft i veçantë në nyjëtim te banorët e kësaj krahine. Ai paraqitet në disa variante ku, mbylltorja alveo-dhëmbore t, duke u paraprirë nga shtegorja alveo-qiellzore sh, nyjëtohet me një ulje të lehtë të shpinës së gjuhës dhe i për afrohet shumë afrikates ç, në disa raste duke u shqiptuar si vetë ajo (shçatë, shçizë, shçytke, shçjere jashçë). Asimilimi i t në ç diku është i plotë, diku i pjesshëm e diku nuk ndihet fare. Në bartës të vjetër të gjuhës ky grup është më i qartë në variantin shç (në fshatrat Hoçisht, Bradvicë, Sinicë, Ziçisht), në folës të arsimuar ose që kanë lëvizur prej kohësh nga vendlindja t nuk ka kaluar plotësisht në ç, ajo ndihet më tepër si një t e qiellzorëzuar (pak a shumë si t e anglishtes), ndërsa te folësit e brezit të ri është shumë e reduktuar. J. Gjinari vë në dukje se kemi të bëjmë një inovacion regresiv, si rrjedhim i ndikimit të gjuhës së shkruar.<sup>157</sup>

J. Gjinari thekson se shndërrimi sht>shç është rrjedhojë e ndikimit sllav në këtë krahinë dhe gjendet vetëm në banorët e krishterë të kësaj zone.<sup>158</sup> Pavarësisht se sot, sipas Mirçevit,<sup>159</sup> nuk vepron si rregull fonetik në gjuhën bullgaro-maqedone, ky kalim ka qenë karakteristik për mjaft dialekte të bullgarishtes së vjetër.

**Grupet psh, fsh.** Grupi fsh haset në pozicion nistor si te: fshesë, fshat, fshinj, fshe(h), ndërsa grupi psh te fjalët: pështjell, kopësht, pështetem, kapshore. Te grupi psh ndërfitet një ë mbështetëse për të lehtësuar shqiptimin. Në disa raste ndodh që të përdoret grupi bashkëtingëllor psh (kapshore-kapshatë), ndërkohë haset dhe dukuria e përdorimit të grupit bashkëtingëllor fsh për grupin psh (pështjell-fshtjell, pështetem- fshtetem). Përsa i përket kthimit të grupit psh në fsh te këto fjalë ka ndodhur procesi i asimilimit në kontakt, ku bashkëtingëllorja mbylltore p, e pasuar nga një bashkëtingëllore shtegore, asimilohet në bashkëtingëlloren shtegore f, më e afërt

---

<sup>157</sup> Po aty.

<sup>158</sup> J. Gjinari, Mbi disa elementë sllavë në të folmet veriore të Shqipërisë jugore, Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve II, Tiranë, 1972, f. 267.

<sup>159</sup> Po aty.

në nyjëtim me sh. Ndërkaq, në disa fshatra, aty ku është ruajtur një gjendje më e vjetër e dialektit (Sinicë, Ziçisht, Qytezë, Bradvicë), grupi psh nuk ka pësuar ndryshime (e rite me copkat, me kapshorkat e dynjasë)<sup>160</sup>.

### 3.4 Modifikime të tingujve dhe ndërrime fonemore

E folmja e Devollit karakterizohet nga një sërë procesesh fonetike dhe ndërrimesh fonemore, të cilat e bëjnë të dallueshme këtë variant brenda të folmeve të toskërishtes veriore.

#### 3.4.1 Modifikimet e tingujve<sup>161</sup>

Modifikimet, duke qenë dallime jofonematike të tingujve në rrjedhën e ligjëritimit, paraqiten si variante të realizimit të një foneme brenda së njëjtës morfeme, në varësi të ndikimit të pozicionit që zë fonema në fjalë dhe rrethimit fonetik të saj. Kështu, modifikimet e tingujve klasifikohen në ndryshime kombinatorë dhe pozicionale.

#### Ndryshimet kombinatorë

**Akomodime.** Ky lloj procesi ka ndodhur në shoqërimet e tipit BZ (bashkëtingëllore/zanore) ose ZB (zanore/ bashkëtingëllore). Në këtë të folme dallohen:

- a) buzorëzimi i zanores i nën ndikimin e bashkëtingëlloreve buzore pranë saj (krypë, pyper, pyperka, ypa-kam ypur,). Në këtë rast bashkëtingëllorja mbylltore buzore p dhe ndikon në zanoren pasardhëse i duke i dhënë tiparet e një zanoreje buzore y.
- b) qiellzorëzimi i zanores ë nën ndikimin e bashkëtingëlloreve qiellzore para ose pas tyre (ginjeshtrë, gjilpërë, fingjill). Në këtë rast, bashkëtingëlloret qiellzore nj, gj, ndikojnë në ngushtimin e zonës palatale (pjesa e përparme e gjuhës ngrihet pak lart), duke përfutur një nyjëtim të përparmë të ë-së deri në i.

<sup>160</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Botim i ASH, Tiranë, 1987, f. 441.

<sup>161</sup> Për përcaktimin e modifikimeve fonetike dhe ndërrimeve fonemore janë marrë si bazë klasifikimet e këtyre dukurive sipas A. Dodit, “Fonetika she fonologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë, 2004, R. Memushajt, “Hyrje në gjuhësi” Tiranë, 2007 dhe “Fonetika e shqipes standarde” Tiranë, 2009.



- c) qiellzorëzimi i zanores e>i po nën ndikimin e bashkëtingëlloreve qiellzore pranë saj (u fiju, bënë cilibrinë, matirjali, iliktrinë etj.).
- d) kalimi i u>y, sepse para ose pas saj ndodhet një tingull palatal (flytyron, yshqimë, lyes, yve, dyke etj.).

**Asimilime.** Procesi i asimilimit është ai proces i fonetikës kombinatorë gjatë të cilit dy tinguj të ndryshëm për afrohen në tipare ose bëhen krejtësisht të njëjtë. Në të folmen e Devollit ky proces është mjaft i ndjeshëm si te zanoret dhe te bashkëtingëlloret.

a) Asimilimet të plota janë të pakta dhe kryesisht vokalike (nuku<nuk, shimitri<shënmitri, bukuvale<bukëvale, cilibrinë<celebrinë, iliktrinë<elektrinë, bylyri<bërryli) dhe, siç vërehen, janë asimilime në distancë, po nuk mungojnë dhe asimilime të plota konsonantike, si: llallanik<dhallanik.

b) Asimilimet e pjesshme janë zakonisht konsonantike dhe lidhen me zëshmimin e bashkëtingëlloreve të caktuara në kontakt me bashkëtingëllore më të tingullta se vetja apo me zanore (*kapërxej, gërbaç, graficë, z'dua, xbath, xhvesh, xvor* (Ixvor), mbërdhe, vasule, mezi etj.).

c) Asimilimi i plotë i hundoreve ndodh te grupet mb, nd të parafjalëve në të ashtuquajturën “rasë vendore” (**de** këta të dy, **de** kuzhinë, e solli **bë** shtëpit, **dë** bark, **dëpër** çdo vdekje, **dënë** këmbë, **dënë** buzë, **dë** trem të kishës etj.). Po në këtë të folme, në raste të rralla, te parafjala mbi asimilohet dubuzorja b, si në të folmet e veriut (palë mi palë, ta hipje mal mi mal).

d) Asimilimi i pjesshëm në kontakt ka ndodhur dhe në grupin sht, ku t është asimiluar në një tingull me afrikim deri në një afrikate të mirëfilltë ç (e shçunë, jashçë, shçatë).

**Disimilime.** Në këtë dukuri të fonetikës kombinatorë ndodh procesi i kundërt i asimilimit, kur dy tinguj të njëjtë ose të ngjashëm bëhen të ndryshëm në tipare për të lehtësuar shqiptimin. Disimilimet janë vokalike dhe konsonantike.

a) Si disimilime vokalike mund të përmenden rastet: alurin (ulërin), çokullatë (çokollatë), mëndjellarëskë (mëndjellaraskë), qërton (qorton), fërtunë (furtunë), bylezik (byzylyk), fërtomë (fortomë) etj.

b) Disimilime konsonantike hasen te fjalët: gjalpër (gjarpër), Xvezdë (Zvezdë), arthrit (artrit), orthodhoks (ortodoks) etj.

**Metateza.** Metateza haset në fjalë, si: velenxë>levencë, Rolandi>Lorandi, ligavec>gilavec, gëlqere>kërqe, portokall>protokall, trahan>tëran, spërkat>përskat,

karficë>graficë, trotuar>tortuar, minjollë>millonjë (shkarpë e hollë), byzylyk>bylezik, bërryl>bylyr etj.

Është interesante të shqyrtojmë rastin e emrit lyes. Në të kanë ndodhur një sërë procesesh fonetike, nga trajta mbles>vles>lves>lues>lyes. Grupi mb është asimiluar në v, që me anë të metatezës ka kaluar pas sonantes l. Kjo e ka bërë të vështirë shqiptimin e grupit bashkëtingëllor lv, si rrjedhim kemi shndërrimet v>u>y. Duhet vënë në dukje se, nga materiali dialektologjik i mbledhur në terren, forma lyes përdoret nga folës mbi 60-vjeç, folësit e brezit të mesëm dhe atij të ri gjithmonë e më tepër përdorin trajtën vles dhe mbles. Fonemat që ndërrojnë shpesh vendin e tyre me anë të metatezës janë lëngëzorja l me dridhësen r apo dridhësja r me buzoret apo velaret.

**Shtesa tingujsh.** Shtesat e tingujve janë një proces i zakonshëm që ndodh në të folmen e Devollit. Si tinguj joburimorë që shfaqen në pozicione të ndryshme në fjalë pa ndonjë funksion të caktuar, janë:

- a) **protetikë**, kur ata shtohen në fillim të fjalës (mburimnë, ntrashem, mbeso, ngjallavitem, ndra, ndardharë, nqasni, javash, javitem). Kryesisht si tinguj protetikë ndihen hundoret m dhe n dhe j<sup>162</sup>.
- b) **epentetikë**, kur shtohen në mes të fjalës (lëmpjetë, thembrë, embër, andre, merselera, mejtonesha, xbukuronem, shpërlaj, burxhak, afërzali). Si tinguj epentetikë shërbejnë kryesisht bashkëtingëlloret e tingulltat m, n, r, por në disa raste dhe qiellzorja j (lejmon, xhejnem, ljepur).
- c) **epitetikë**, kur shtohen në fund të fjalës (tynë, aynë, ngaj, e mij, andezaj, këtezaj, atfernaj, nashtinë). Si tingull epitetik më i zakonshëm është qiellzorja e tingullt j, por në shumë raste epiteza përbëhet dhe nga rrokje që shtohen në fund të fjalës pa ndonjë funksion të caktuar. Rrokja epitetike, në të folmen e Devollit, përbëhet nga hundorja n në variantin në te përemrat vetorë (tinë, aynë), në disa ndajfolje (këtunë, nashtinë). Në këtë rast rrokja fundore në mund të ketë qenë mbaresë e kallëzores, e cila është përdorur më pas dhe në raste të tjera. Dukuria e përhapjes së kësaj mbarese edhe në pjesët e pandryshueshme të ligjëratës tregon se kjo mbaresë e ka humbur vlerën gramatikore dhe ka mbetur në këto fjalë si rrokje epitetike<sup>163</sup>. Përsa u përket ndajfoljeve andezaj, këtezaj kemi një bashkim të

<sup>162</sup> Mikloshiçi thekson se shqipja ka një parapëlqim të veçantë për sonantet hundore (cituar sipas K. Topalli, Dukuri fonetike të sistemit bashkëtingëllor të shqipes, Tiranë 2004, f. 94).

<sup>163</sup> K. Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1995, f. 111-112.

një rrokjeje epitetike që mund të jetë përdorur si prapashtesë zvogëluese me tingullin epitetik j.

- d) **tingujt antihiatizues** (j baktija, palareja, ngrijem, krijju; v në kohën e kryer të thjeshtë të foljeve të zgjedhimit të parë dhe në vetën e tretë njëjës shkovi, lërovi, çpovi, kërevi, rërimi). E. Çabej e quan tingullin j si shtesë kundër hiatit dhe tek emrat i jati, e jëma<sup>164</sup>. A. Dodi<sup>165</sup>, K. Topalli<sup>166</sup> janë të njëjtë mendim, duke e parë si dukuri të sand'hit të jashtëm që ka lindur për të shmangur takimin e nyjës së përparme me emrin që fillonte me zanore. E njëjta gjë ndodh dhe te folja avitem (afrohem), e cila në të folmen e Devollit del javitem. Po ashtu, kundër hiatit del dhe dridhësja r te folja joveprore zihem në të gjitha vetat e së tashmes (zirem-ziremi), duke zëvendësuar glotalen h, që mungon në inventarin e fonemave të kësaj të folmeje.

**Rënie tingujsh.** Rëniet e tingujve në gjuhën shqipe janë mjaft të shpeshta dhe në të folmet e dialektore ato shfaqen më dendur. Disa bashkëtingëllore kanë rënë në çdo pozicion, pavarësisht se janë fjalë të burimit vendës apo të huazuara (p.sh., bashkëtingëllorja h), disa tinguj kanë rënë për shkak të pozicionit të tyre në lidhje me theksin (sa më tepër të ndodhen larg theksit aq më shumë rritet mundësia e rënies së tingullit), si dhe në rastet kur është gjendur një grup bashkëtingëlloresh ndërmjet dy zanoresh, aq më tepër kur këto bashkëtingëllore kanë qenë të ngjashme në nyjetim (i ergjendtë- i ergjendë).

- a) **Afereza** është rënia e një tingulli në fillim të fjalës dhe ndodh shpesh si dukuri e ligjëritimit bisedor për zvogëlimin e numrit të rrokjeve (kjo ndodh më shpesh në antroponimet, më tepër si dukuri e shkurtimit apo zbnimit të emrit, sesa si proces fonetik). Një nga bashkëtingëlloret që i është nënshtruar këtij procesi është h-ja, e cila ka rënë në ballë të fjalëve që fillojnë me këtë bashkëtingëllore, kjo duket sidomos në huazimet turke, si: iç, ammçe, allo, ajde, elbete, anko etj.
- b) **Sinkopa**, si një dukuri e rënies së një tingulli apo grupi tingujsh në trup të fjalës, vihet re në ligjërimin bisedor në fjalë, si: kthesha, zisha, shpi, aherë, kshu, ktu etj.
- c) **Apokopa** ndodh rëndom në të folmet dialektore duke qenë se tingujt në pozicion fundor janë më të prirur që të bien (kish-kishnë, ish-ishnë, erth të shçunë, zu të binte, po dhe tek emrat prindërit-prindët, grindje-grindë, sëmundje- sëmundë etj.

<sup>164</sup> E. Çabej, Studime gjuhësore III, Rilindja, Prishtinë, f.144.

<sup>165</sup> A. Dodi, Fonetikë dhe fonologji e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004. f. 153.

<sup>166</sup> K. Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1995, f. 314.

- d) **Elizioni** ndodh në ato fjalë që mbarojnë me zanore fundore dhe ndodhen para fjalëve, të cilat fillojnë po me zanore. Në këto raste zanorja fundore elidohet (tkurret derisa bie). Elidimi në të folmen e Devollit ndodh kryesisht te parafjalët që mbarojnë me zanoren ë (i *thashë b'emrë, kaloi b'at'anë, d'aurt, d'atë volltë, q'i dha, shkovi mb'udhë* etj.).

### **Ndryshimet pozicionale**

Një nga ndryshimet pozicionale më të dallueshme është reduktimi i ë-së së patheksuar në rrokje fundore, në fjalë me theks tejfundor (flytyr, kumbull), në kallëzoren dhe gjinoren e emrave mashkullorë me theks parafundor (burit-burën), në pjesoret e foljeve që mbarojnë me -ur (ardhur, vajtur etj.)<sup>167</sup>.

Po ashtu, është mjaft e ndjeshme dukuria e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme që ndodh kryesisht në rrokje fundore, por nuk përjashtohen dhe rastet dhe në rrokje të mbyllyra brenda fjalës apo në pozicion nistor. Rastet kryesore të shurdhimeve janë:

- a) b>p: elp, plump, shkëmp, prëmë, mproj;
- b) d>t: mëntë e saja, u gjent, dhëntret, rente, mejtonem;
- c) dh>th: më ngorthnë këmbët, më erthnë, lithshim bë trupt, i barthkë, trathtar;
- d) g>k: i lik, kërqe, zoknë, bakti;
- e) v>f: sikur ka ngrënë urof, shkof (shkovi) e vate, shtif;
- f) z>s: mëngjesnë, dë qymest, e thernë këndesnë, të zestë;
- g) gj>q: i squatë, e sqovi, të liqtë, i doq;

### **3.4.2 Ndërrimet fonemore**

Këto ndërrime paraqiten si këmbime fonemash gjatë eptimit të fjalëve ose gjatë fjalëformimit. Morfemat, të cilat shprehin kategori të caktuara gramatikore, duke u përdorur në kushte të caktuara fonetike, paraqiten në formën e alomorfeve.

Ndërrimet fonemore historike janë kryesisht vokalike dhe lidhen si me ndërrimet me metafoni, ashtu dhe me apofoni.

- a) Ndërrime eptimore metafonike janë ato lloj ndërrimesh historike të zanoreve nga të cilat përftohet një zanore e përparme. Në të folmen e Devolli ndërrimet metafonike përfshihen

---

<sup>167</sup> Për këtë dukuri shih rastet e përmendura në sythin 3.2.2 të punimit për zanoren ë të patheksuar.

në një sërë emrash dhe mbiemrash kur vendosen në numrin shumës, si dhe gjatë zgjedhimit të disa foljeve.

Rastet më të përgjithshme me ndërrime metafonike dallohen në:

a//e: plak-pleq, mashkull-meshkuj, natë-net, dal-del;

o//e: i voglë- të veckë;

a//i: heq-hiqnja, dreth-drithnja, mbleth- mblithnja, mer-mirnje bares-barisnja;

je// i: pështjell- pështillnja, sjell-sillnja;

ua// yé: buall-byénj;

a//*ue*: kalë-*kuej*;<sup>168</sup>

- b) Ndërrimet apofonike lidhen me ndërrime historike të zanoreve, si proces i përfutimit të një zanoreje të prapme, por në kuptimin më të gjerë të termit këtu hyjnë të gjitha ndërrimet që vihen re në alomorfet e një morfeme, me përjashtim të rasteve me metafoini. Kështu, apofonia në këto raste vepron si eptim i brendshëm. Rastet kryesore të ndërrimeve apofonike janë:

je//o: pështjell-pështolla, pjek-poqa;

a //o: mar-mora, nxjer-nxora;

o //ua: dolla-duallmë, solla-suallmë, përcolla-përcuallmë, mora-muarmë;

a//ua: kalë- *kuanjtë*, dorë- duar-duartë;

- c) Ndërrime në fjalëformim me zanore mbështetëse ndodhin në rastet kur tema fjalëformuese mbaron me bashkëtingëllore dhe morfema fjalëformuese fillon po me bashkëtingëllore. Për shkak të vështirësisë së shqiptimit të grupit prej dy a tri bashkëtingëlloresh ndërfitet një zanore mbështetëse. Kjo dukuri haset te disa mbiemra dhe përemra kur përdoren si të emëruar, si: të tjerë-të tjerit, tonë-tonit, të parë- të parit, të veckë-të veckit, etj.

Ndërrimet historike të bashkëtingëlloreve lidhen kryesisht me format eptimore të emrave dhe me ato të foljeve. Kështu mund të vihen re:

- a) Qiellzorëzime gjatë shumësit të emrave dhe mbiemrave

k//q mik-miq, fik-fiq, ulk-ulq, xverk-xverqe, bark-barqe;

ll//j buall-byéj, kalë- *kuej* (por dhe byénj dhe *kuanj*);

r//nj kushëri-kushërinjtë, ulliri-ullinjtë;

---

<sup>168</sup> Këtë trajtë shumësi e kemi hasur në fshatin Qytezë.

g//gj sllog-sllogje, breg-brigje, stërg-stërgje;

- b) Qiellzorëzime gjatë vendosjes së disa foljeve në të pakryerën dhe në të kryerën e thjeshtë, të mënyrës dëftore, si:

g//gj djeg-digjnja-dogja;

k//q pjek-piqnja-poqa;

### 3.5 Theksi i fjalës në të folmen e Devollit

Theksi i fjalës në të folmet e shqipes ka pak ndryshime nga gjuha standarde. Në të folmen e Devollit, ashtu si në gjuhën standarde, mbizotërojnë fjalët me theks parafundor. Problemin kryesor e përbëjnë huazimet nga gjuhë të tjera, të cilat kanë theksin të ndryshëm nga shqipja.

Së pari, te huazimet turke me theks parafundor, të cilat në gegërishte kanë pësuar rregullim mekanik të theksit, në këtë të folme paraqiten si fjalë me theks fundor, si: teneqé, pashá, kaúr, pará, mertepé, asulldé, ashllamá, anxhár, esáp, inshallá, ndërsa në huazime të tjera theksi ka kaluar parafundor (xhézve, shíshe, qóshe, penxhére, pérde, gjýle, qófte, çántë, býrde etj.).

Së dyti, te huazimet e reja nga gjuhët perëndimore prirja është drejt theksimit parafundor të tyre, kryesisht nga brezi i ri, i ndikuar dhe nga gjuha e shkruar dhe ajo e mediave (kompjuter, tórno, traktór).

Së treti, antroponimet femërore me prejardhje nga greqishtja kanë ruajtur theksin fundor të tyre (Fotíní, Athiná, Viktorí, Gliqírí), por në format e shkurtuara të tyre kalojnë me theks parafundor (teto Nía, Thína, Víka, Gríqe).

Së katërti, fjalë, të cilat janë formuar me prapashtesat sllave zvogëluese –kë, me prapashtesën turke -çe apo me prapashtesën thirrmore –o, shqiptohen me theks parafundor, sidomos kur mbi to bie theksi ngulmues, si: çúpken, shqérken, fsháçe, dérçe, hállo. Sipas K. Topallit, këto prapashtesa të huaja, që përbëhen nga rrokje të hapura, kanë qenë të patheksuara në gjuhët huazuese dhe të tilla dalin dhe në shqipe, duke iu përshtatur fjalëve me fundore të njëjtë.<sup>169</sup>

Së pesti, dukuria e lëvizjes së theksit për shkak të ndryshimeve morfologjike është e pranishme edhe në këtë të folme. Kështu, kemi lëmë-lëmínj, lëmç-lëmçínj, i keq-të këqínj, i math-

<sup>169</sup> K. Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1995, f. 70.

të mbëdhénj. Në këto raste theksi shërben si mjet gramatikor për formimin e shumësit të emrave bashkë me prapashtesën përkatëse. Një dukuri e tillë ndodh dhe në fjalë që në shumësin e një sërë huazimesh turke të tipit babá-baballárë, béj-bejlérë, ku theksi bie mbi prapashtesën e shumësit. Kjo dukuri është huazuar nga turqishtja, duke i shtuar prapashtesës turke prapashtesën shqipe -ë: baba-llar-ë për analogji me shumësin bullar-ë, mullar-ë.<sup>170</sup>

Si përfundim, mund të themi se e folmja e Devollit, pikërisht për shkak të këtyre tipareve fonetike të veçanta, përbën një variant dialektor të dallueshëm në grupimin e të folmeve të toskërishtes veriore. Në të ruhen ende disa dukuri fonetike, si në nyjëtimin e tingujve dhe në proceset fonetike, që ndodhin në leksikun e kësaj të folmeje, duke mbartur një sërë tiparesh të vjetra si dëshmi që pasqyrojnë një gjendje të hershme fonetike të shqipes.

---

<sup>170</sup> A. Dodi, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004, f. 176.

## 4. TIPARE MORFOSINTAKSORE TË TË FOLMES SË DEVOLLIT

### 4.1 Veçori të përgjithshme morfosintaksore

Ndryshimet dialektore midis të folmeve kanë prekur dhe sistemin gramatikor. Në raport me dallimet fonetike, dallimet në sistemin gramatikor janë më të pakta. Ndërsa në sistemin fonetik kriteri bazë i dallimeve është shkalla e prekjës së sistemit fonologjik të të folmeve, për sistemin gramatikor si bazë merren dallimet morfologjike që prekin strukturën gramatikore të të folmeve nga variantet morfologjike dialektore. Kuptohet që edhe tiparet dalluese morfologjike nuk kanë të njëjtën vlerë nga pikëpamja e prekjës së strukture. Ka dallime të tilla që prekin pjesërisht strukturën gramatikore dhe disa që e prekin në mënyrë të ndjeshme këtë sistem. Kështu, në klasifikimin e dallimeve morfologjike të të folmeve, dallojmë ato që prekin strukturën morfologjike dhe që mund të jenë dy llojesh: ato që prekin inventarin e strukturave morfologjike dhe variantet e tyre, si dhe dallimet që lidhen me funksionin e morfemave: me shpërndarjen e varianteve të strukturave ose morfemave dhe me variantet fonetike të formave gramatikore.<sup>171</sup>

Dallimet që prekin strukturën gramatikore janë mjaft të rëndësishme, sepse ato janë treguesi kryesor i ndarjes së dialekteve pa e copëzuar truallin dialektor. Si rrjedhim, vlera e dallimeve shihet si brenda një dialekti të caktuar, ashtu dhe brenda të folmeve në unitet me dialektin që e përfshin.<sup>172</sup>

Në të folmen e Devollit dallimet e grupit të parë përbëjnë një sërë dallimesh të mirëfillta që përfshijnë gjithë dialektin tosk. Kështu, në të folmen e Devollit mungon përemri pronor i vet /e vet. Po ashtu, mungojnë format e mbipërbëra të foljeve të tipit kam pasë shkuar. Përsa u përket formave të mbiemrave të prejardhura nga pjesoret e foljeve me prapashtesën –shëm, të cilat kanë ue dhe ye, në të folmen e Devollit kanë filluar të hyjnë nëpërmjet ndikimit të standardit, por duke pësuar ndryshime fonetike (i shkëlqyeshëm- i shkëlqyshmë; i mrekullueshëm-i mbrekullushmë).

Dallimet në inventarin e strukturave gramatikore që lidhen me forma të veçanta të një paradigme përfshijnë:

---

<sup>171</sup> J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, Dialektologjia, shblu, Tiranë, 2003, f. 207.

<sup>172</sup> Po aty, f. 207.



- a) Një formë rasore më tepër se në të folmet e tjera toske dhe gege (përjashto disa zona të gegërishtes jugore), siç është rasi vendore me parafjalët përkatëse.
- b) Trajatat rasore në rrjedhore të pashquar shumës që dalin me -ve dhe jo me -sh (pe maleve, ulicave, pe ca kuaçkave na dolën kaqe veçka). Kjo formë e njëjtë me gjinoren dhe dhanoren e lë me një formë më pak paradigmen e lakimit të emrave femërorë në të pashquarën.
- c) Po ashtu, me një formë më pak paraqitet lakimi i përemrave vetorë të vetës së parë dhe të dytë shumës (neve për ne, yve për ju).

Një vend të veçantë në të folmen e Devollit zënë dallimet strukturore që përfshijnë variante strukturash gramatikore. Në format gramatikore të pjesëve të ligjëratës, dallimet përfshijnë kryesisht foljen. Konkretisht, e ardhmja e foljeve paraqitet me formën do+lidhore (do të shkoj), por në ligjërimin bisedor, për shkak të ritmit të të folurit, pjesëza të e lidhores bie, duke lënë formën do shkoj (do të shkoj që pa gdhirë//to shkonj pa gëdhirë). Po ashtu, format pësore-vetvetore të foljeve në kohën e pakryer dalin me forma sintetike, si: lasha, lodhsha (lodhça), mersha. Paskajorja e foljeve del me pjesëzën trajtëformuese për të (për të shkuar, për të larë, për të lëruarë, për të rëmirë etj.).

Variantet strukturore të morfemave kanë një sërë veçorish që lidhen me dallime për gjithë dialektin, si mbaresa e shquarsisë së emrave mashkullorë që mbarojnë me velaret k, g dhe grykoren -h. Në gjithë toskërishten këta emra dalin me -u në të shquarën (mik-u, kra-u, zog-u).

Në të folmen e Devollit, foljet të cilat kohën e kryer të thjeshtë e formojnë nëpërmjet apofonisë (nxjerr-nxora, marr-mora), në vetën e parë shumës dalin me diftong (m<sup>u</sup>arëm, nx<sup>u</sup>arëm).

Dallimet që përfshihen në grupin e dytë, pra që bazohen në kriterin funksional, nuk prekin mirëfilli strukturën gramatikore të të folmes. Në këtë grup dallimesh hyn prania e gjinisë asnjane te disa emra që tregojnë lëndë, tek emra prejpjesorë, si dhe tek ata që e kanë prejardhjen nga mbiemrat përkatës. Megjithatë, pavarësisht se dallohen qartë emrat e kësaj gjinie, rrudhja e gjinisë asnjane po vepron ndjeshëm dhe në këtë të folme.

Prapashtesa e shumësit të disa emrave mashkullorë del në dy variante fonetike: -ë dhe -a (doktorë-doktora). Po ashtu, në kohën e kryer të thjeshtë, në vetën e tretë, foljet e zgjedhimit të parë mbarojnë me -vi (lavi, ponovi, shkovi).

Variantet fonetike të formave gramatikore janë të pranishme te përemri i vetës së tretë njëjës: ai-ay, po ashtu, dhe përemri i vetës së dytë njëjës e shumës del: y-yve.

Në këtë të folme është e dukshme prapashtesa -nj për shumësin e emrave të tipit: ullinj, lëminj, gjarpërinj dhe si mbaresë foljore te foljet e zgjedhimit të parë: lanj, pastronj, rëminj, lëvrinj, që në disa fshatra të Devollit të Poshtëm dalin me prapashtesën variante -j.

Për pjesën më të madhe të foljeve, në vetën e parë shumës të së pakryerës, ndodh metateza (vishnim-vishmin), ndërsa në të kryerën e thjeshtë të pësore-vetvetores mbaresat vetore të tri vetave të shumësit janë -më, - të, -në.

## 4.2 Emri

### 4.2.1 Kategoria gramatikore e gjinisë

Në të folmen e Devollit emrat kanë një sërë veçorish dialektore që lidhen me kategorinë gramatikore të gjinisë. Në të nuk ka dallime strukturore që e prekin ndjeshëm këtë kategori. Dallimet më të shpeshta gjenden në grupe të veçantë emrash, te të cilët vendosja në shumës u sjell ndryshime.

- a) Disa emra, të cilët dalin me temë në -o, kanë mospërputhje të gjinisë natyrore me atë gramatikore (për nga gjinia natyrore janë mashkullorë, ndërsa nga gjinia gramatikore janë femërorë). Këta emra në të shquarën nuk dalin me -ja<sup>173</sup>, por zanoren o të temës e zbërthejnë në diftong (kryesisht vihet re si dukuri tek antroponimet, si: Miço-Miçua, Lyto-Lytua, Ndreko-Ndrekua, por dhe në disa emra të përgjithshëm, si: kurisko-kuriskua, fëndo- fëndua, çalo-çalua, gramatiko-gramatikua etj.<sup>174</sup>).
- b) Disa emra mashkullorë, të formuar me prapashtesat -tar, -tor, -or, në trajtën e shquar nuk e zbërthejnë o-në e prapashtesës në diftong (lakror-i, puntor-i, gjahtar-i)<sup>175</sup> Emrat mashkullorë, që në trajtën e pashquar mbarojnë me velaret -k, -g, si dhe disa nga

---

<sup>173</sup> Këta emra, meqenëse mbarojnë me -o, te të folmet e tjera të toskërishtes dalin me mbaresën -ja, ku j, në fakt, është një tingull kundër hiatit.

<sup>172</sup> Sipas K.Topallit (Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë, 1995, f. 335), kjo dukuri ka ardhur si rrjedhim i prapavendosjes së nyjës shquese te këto fjalë që në të shquarën dalin me temë daktilike.

<sup>173</sup> Këta emra, të cilët mbarojnë me bashkëtingëlloren r, nuk e zbërthejnë zanoren o të temës në diftong, sepse vjen si rrjedhim i prapavendosjes së nyjës shquese (K. Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, f. 336).

huazimet turke që mbarojnë me -h, por që nuk shqiptohet në të folmen e Devollit, në të shquarën marrin mbaresën -u, ndryshe nga të folmet e veriut që mbarojnë me -i, si: krau, saba-u, guak-u, karabatak-u, porpollog-u, sivok-u, targaxhik-u, umjak-u, etj.

- c) Gjinia asnjëherë ruhet mirë në të folmen e Devollit. Ajo është e pranishme te mjaft emra që shënojnë lëndë, si: ujët e jazit, gjalpët dhe lakror; *t'u marr dhjamët*; qymyrë e bënin dhe Greqit; se tret plumb e tret barunë; ja ka ngrënë derri brumët etj.; te disa emra që tregojnë pjesë të trupit, si: ballët me sedef; mishtë e kish të çkolitur; këta lësh të skuqëruar; *t'ua* bësh hundët përshesh; etj.; te disa emra prejpjesorë, si: erth me të rendur; me të taksur ikte; e kishte të ndenjuri; të ecurit kshu e kam; unë ta njoh zënë që në të llafosur, të na vijë me të falë “të na vijë me dhuratë”; *pogaçet e t'uruarit, kulaçet* e të ftuarit; si dhe disa emra të prejardhur nga mbiemrat përkatës, si: i harxhon për të kuq e për të bardhë; pa të mirit e tij; të parit ishnë më të zotë.

Megjithatë, duhet theksuar se edhe në këtë të folme kjo gjini po rrudhet, ngaqë emrat që i përkasin kësaj gjinie po kalojnë në gjininë mashkullore apo femërore. Disa prej emrave që shënojnë lëndë po kthehen në gjininë mashkullore, si: Evlat i evlatit mjalta e mjaltit; pe një mjelli; ç'u bë mishi; gjalpi dhe lakror është; disa nga emrat prejpjesorë kanë kaluar në gjininë femërore, si: e pira, e para bilbil, e dyta mbret, e treta derr; e dhëna e botës, e gënjyera e gojës<sup>176</sup>; po ashtu, dhe disa emra të formuar nga emërzimi i mbiemrave me paranyjëzim kanë kaluar në femërore, si: e keqja e ka gjithmone pse in afër.

- d) Në lidhje me gjininë e disa emrave të huazuar nga turqishtja apo sllavishtja që lidhen me emërtimet për lidhjet farefisnore, në ndryshim nga të folmet geqe, në të folmen e Devollit janë të gjinisë mashkullore (babai, xhaxhai, daiu).

#### 4.2.2 Kategoria gramatikore e numrit

Kategoria gramatikore e numrit në të folmen e Devollit ka veçori që lidhen kryesisht dhe me të folmet e tjera të toskërishtes, por, ndërkohë, ka dhe forma karakteristike, të cilat hasen vetëm në këtë të folme.

---

<sup>176</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Botim i ASH, Tiranë, 1987.

1) Në të folmen e Devollit pjesa më e madhe e emrave të të tri gjinive e formojnë shumësin me prapashtesë trajtëformuese. Në bazë të këtyre prapashtesave emrat do të klasifikohen:

- a) Emra, që marrin në trajtën e shumësit prapashtesën trajtëformuese –ë, si një nga prapashtesat më të zakonshme për formimin e shumësit të emrave. Në këtë grup hyjnë:
- Emra mashkullorë (të parmë a të prejadhur, vendës a të huazuar), që në të shquarën njëjës mbarojnë me –i, si: tiganë, qilarë, kallauzë, gallanozë “lloj qypi prej balte”, evlatë, qymezë, kastravecë, begunë “lepur motak”, cingunë, gjelemenë “njeri pa shtëpi, njeri iardhur nga një fshat tjetër”, kularë, litarë, ajdutë, bandillë, çerepë, kopanë, kavallë, urupë, pregaçë, doktorë, infermierë, oficerë, rogozë.
  - Disa emra mashkullorë, që në të shquarën njëjës mbarojnë me –u, si: kërçakë “lepur motak”, lisnikë, llallanikë “lloj gatese me dhallë”, fasulnikë, motakë, musllukë, porpollakë “lloj shpendi shtegtar”, pojakë, gjizanikë “lloj gatese me gjizë”, vandakë, shinikë, vërsnikë, umjakë “lloj shpend uji”.
- b) Emra, që trajtën e shumësit e bëjnë me prapashtesën trajtëformuese -a. Në këtë grup hyjnë:
- Emra mashkullorë, që në të shquarën njëjës mbarojnë me -i, si: plisa, klena “lloj peshku i ujërave të ëmbla”, cfinqa “lloj zogu me gushë të verdhë”, kaptella, plepa, qilima, rogoza, doktora, oficera, leka <sup>177</sup> etj.
  - Emra femërorë, që në trajtën e pashquar të numrit njëjës mbarojnë me -ë të patheksuar, si: jariçkë-a, kukumjaçkë-a, kosorkë-a, roshkë-a, rëshetkë-a, latoshkë-a, mëleçkë-a “bimë barishtore me lule të verdha”, llozenkë-a, vastangarkë-a, lloznicë-a, petullnicë-a, <sup>178</sup> lesë-a, branë-a, lektyrë-a, mërezhdë-a, mësalë-a, mjarauzhgë-a, napë-a, oshtë-a, ostë-a, zogë-a, dizgë-a, shushërë-a “shkop i hollë dhe i gjatë” etj.
- c) Emra, që trajtën e shumësit e formojnë me prapashtesën trajtëformuese –nj. Në këtë bëjnë pjesë:
- Emra mashkullorë, që gjatë lakimit në të shquarën njëjës, dalin me bashkëtingëlloren r para mbaresës –i, si: huri-hunj, ulliri-ullinj, kërcuri-kërcunj, kërciri-kërcinj, druri-drunj, mulliri-mullinj, turiri-turinj, gjiri-gjinj etj.

<sup>177</sup> Këto trajta ka shumë mundësi të jenë ndikim i gegërishtes.

<sup>178</sup> Emrat, të cilët kanë marrë prapashtesat zvogëluese përkëdhelëse -kë, -çkë, -icë, pavarësisht nga gjinia e temës fjalëformuese (nëse ka qenë një emër), janë të gjinisë femërore.

- Emra mashkullorë, që në të shquar njëjës, dalin me -u, si: avxhinj, afërzalinj “varietet rrushi”, minj, zanatçinj, barinj, baltaxhinj, dyqanxhinj, stambollinj, lakraxhinj etj.
  - Pas këtij rregulli shkojnë dhe disa emra mashkullorë që në të pashquar njëjës dalin me diftongun -*ya*, si: ft*ya*-ftonj, th*ya*-thonj, potk*ya*- potkonj, lang*ya*- langonj (emri kr*ya* haset me trajtën e shumësit kr<sup>179</sup>orë).
  - Emra mashkullorë, të cilët në shumës ndryshojnë vendin e theksit në rrokjen fundore, ndryshim që shërben dhe si mjet gramatikor bashkë me prapashtesën. Prapashtesa del në variantet ër+inj, si: prift-pritërinj, gjisht-gjishtërinj, apo –inj, si: lëmë-lëmínj, lëmç-lëmçinj (po dhe lëmçe), përç-përçinj (por dhe përça), shkop-shkopinj, stap-stapinj, drapër- drapinj<sup>180</sup>.
  - Me -enj dalin pak emra mashkullorë, si: lumenj, maskarenj, budallenj etj.
- d) Emra, që trajtën e shumësit e formojnë me prapashtesën trajtëformuese -e<sup>181</sup>. Në të folmen e Devollit kjo prapashtesë është mjaft prodhimtare. Me të formohet shumësi i emrave mashkullorë që tregojnë frymorë: cape (po dhe cepinj<sup>182</sup>), viçe, kërçe “kërriç”, iriqe, dhëntre; sende dhe dukuri: puse, saçe, gjolle “sipërfaqe e ngritur toke ku mbillen bimë bujqësore”, qype, llagape, llome, tele, llafe, bashe, çape, derte, habere etj.

Po këtu hyjnë dhe emrat e veprimit të prejadhur me prapashtesën -im nga foljet përkatëse, por këta emra janë futur vonë në dialekt si rrjedhimi ligjërim i libror dhe gjuhës së mediave.

- e) Emra, që formojnë trajtën e shumësit me prapashtesën trajtëformuese –ra.
- Përgjithësisht kjo prapashtesë shërben për formimin e shumësit tek emrat femërorë, kryesisht tek emrat e lëndës: lyra (lyrëra), lymra, shurëra, glikora. Të përdorur në numrin shumës ata shënojnë lloje lëndësh ose sasi të ndarë në pjesë që mund të numërohet.

<sup>179</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987.

<sup>180</sup> Dukuria e formimit të shumësit me ndryshim të theksit ka hyrë dhe në gjuhën standarde në një numër më të kufizuar fjalësh të trashëguara nga fond i vjetër i shqipes, ku prapashtesa e shumësit del e theksuar (shih K.Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë, 1995).

<sup>181</sup> Në ndryshim me gjuhën standarde ku përcaktohet se këtë lloj prapashtese e marrin vetëm emrat abstraktë të prejardhur (Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe1, botim i ASH, Tiranë 2002, f. 97-98), në të folmen e Devollit -e shërben si prapashtesë e shumësit për një numër të madh emrash frymorësh e sendesh.

<sup>182</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987, f. 507.

- Këtë prapashtesë në të folmen e Devollit e gjejmë edhe në shumësin e disa emrave mashkullorë që shënojnë frymorë, si: nipra, priftra, apo emra mashkullorë që e formojnë shumësin me prapashtesa të tjera, si: detra, lumra.<sup>183</sup>
  - f) Emra, që e formojnë shumësin me prapashtesën –re. Kjo prapashtesë gjendet në një numër shumë të kufizuar emra frymorësh dhe duhet theksuar se është një prapashtesë që gjendet vetëm në këtë dialekt (gjyshre, bujqre, dhëntre, çalëre)<sup>184</sup>.
  - g) Emra, që e formojnë shumësin me prapashtesën –ër. Këtu hyjnë emra, si: kecër, evlatër, ajdutër, qenër, ulqër. Përdorimi i këtyre emrave në këtë trajtë shumësi merr më tepër kuptim të figurshëm (s’anë dy qenër dhe një govatë; janë bërë si ulqër etj.).
- 2) Numri shumë në këtë të folme formohet dhe me ndryshim tingujsh të temës. Në fakt, në shumë emra kjo dukuri vepron bashkë me prapashtesën trajtëformuese të shumësit duke u paraqitur si një mjet i vetëm gramatikor. Emrat që e formojnë shumësin në këtë mënyrë mund të klasifikohen:
- a) Emra, që e formojnë shumësin me metaforë:
    - a//e: kunat-kunetër, natë-net, kovaç-koveçë, kopaç-kopeçë;
    - o//e: i vocki- të veckit;
    - ua//ue: kalë-kuej (por dhe kalë- kuanj);
    - a//ye: buall-byénj, shuall-shyénj, (por edhe buallre, shuallre) (ndërkohë në këto fjale ka vepruar dhe qiellzorëzimi ll>nj);
  - b) Emra, që e formojnë shumësin me apofoni. Në fakt, në këtë grup klasifikohen emrat që u përmendën në pikën 1/c të këtij sythi për emrat me prapashtesën –nj (ftua-ftonj, thua-thonj, potkua- potkonj, langua- langonj). Por, gjithashtu ka dhe emra të tipit dorë–duar, derë–dyër ku apofonia ka sjellë zberthimin e një zanoreje në diftong si rrjedhim i eptimit.
  - c) Ndërrimi më i shpeshtë konsonantik për formimin e shumësit të emrave është qiellzorëzimi i bashkëtingëlloreve fundore, si: mik-miq, fik-fiq, zog-zoq (zogj), kungull-kunguj, turtull-turtuj, çakall-çakaj, fyell-fyej, (por qerthull-qerthulla), ljepur-ljepuj (por dhe ljepura).

<sup>183</sup> Këtë prapashtesë trajtëformuese Gj. Shkurtaç e ka hasur në të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe e shpjegon si një “hibrid” të të prapashtesës –ër të toskrishtes me prapashtesën –a të gegërishtes (Vendi i të folmeve të arbëreshëve të Italisë në izoglosat e ADGJSH-së, Studime albanologjike, nr. 1, 1997, f. 110) çka na bën të mendojmë se është një prapashtesë e hershme.

<sup>184</sup> Te materiali i mbledhur nga V. Xhaçka gjejmë dhe shuallre, buallre etj.

- d) Po këtu hyjnë dhe disa emrash, që shumësin e ndërtojnë me ndërrim zanoresh dhe me ndërrim bashkëtingëlloresh, si: mashkull-meshkuj, plak-pleq (këtu vepron si ndërrimi apofonik a//e dhe qiellzorëzimi i bashkëtingëllores fundore).
- 3) Një nga mënyrat e formimit të shumësit të emrave është dhe me ndryshim tingujsh dhe prapashtesë trajtëformuese. Këtu bëjnë pjesë:
- a) Emra mashkullorë, që kanë në temë bashkëtingëlloret velare k, g. Te këta emra bashkëtingëllorja velare kthehet në qiellzore dhe njëkohësisht marrin dhe prapashtesën –e të shumësit. Kështu mund të përmendim emra, si: breg-brigje, sllog-sllogje, tog-togje, xverk-xverqe, stërg-stërgje “lejlek”, dyfek-dyfeqje, potis/k-potiqe “mjet peshkimi” etj.
  - b) Disa emra mashkullorë, që mbarojnë me -ll, të cilat e kthejnë atë në qiellzore –j si: yll-yje, pyll- pyje (po dhe pylle, Y o male,/ y o pylle)<sup>185</sup>.
- 4) Në të folmen e Devollit, shumësi i emrave formohet edhe pa ndryshime të emrit, si në njëjës dhe në shumës. Ky grup është më i kufizuar dhe në të hyjnë:
- a) Kryesisht emra femërorë që në njëjës të pashquar mbarojnë me –e, si: feste, faqore, ebe “hejbe”, guguçe, kaçe, kanape, këndje “fundi i dhomës”, kurubishte “kërbishte”, koshere, milore, poçe, setre “xhaketë”, shemshie “çadër shiu” etj.
  - b) Emra femërorë që mbarojnë në temë me -o të theksuar, si: shpirto “shkrepse”, kondo “këmishë” etj.
  - c) Emra mashkullorë që mbarojnë në temë me -i të theksuar, si: hardhi, parashkëndi “xixëllonjë”, mërzi, lajthi. Bën përjashtim emri njeri, i cili në numrin shumës pëson një sërë ndryshimesh, merr prapashtesën –ëz, ndërron rrokjen në të cilën bie theksi (duke u kthyer në një fjalë me theks parafundor) dhe në këtë të folme ndodh dhe dukuria e asimilimit të plotë në distancë: njeri-njërëz (po njerëzija kur përdoret si emër përmbledhës).

**Emra që përdoren vetëm në njëjës.** Një sërë emrash në përdorimet e tyre nuk kanë forma të shumësit për shkak të kuptimit të tyre. Në këtë grup emrash dallojmë:

- 1) Emra përmbledhës, të cilët shënojnë shumësi frymorësh e më pak sendesh, si: njerëzija, djemuria, çupëria (tërësi vajzash dhe jo mosha), kallaballëku etj.

<sup>185</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1986, f. 418.

- 2) Emra, që shënojnë lëndë në formën e një tërësie të pandashme e të panumërueshme, si: brumë, gjizë, tinë “Iloj balte”, tëran, ufull etj.
- 3) Emra, që shënojnë tufë të pandarë (të përafërt nga kuptimi me emrat përmbledhës) allaji “tufë peshqish”, grunc “tufë peshqish të vegjël”.
- 4) Emra, të cilët shënojnë disa lloje bimësh, si: elb, thekrë, burxhak.
- 5) Emra dukurish atmosferike, si: sinjak, brymë, lloë, llapavec, meglënik “po fryn meglëniku”
- 6) Emra sëmundjesh, si: dalldi, damblla, zali, plasje, srybat, naçitok etj.
- 7) Emra abstraktë, si: mukaet, takat, xhan etj.
- 8) Emra procesesh unike: po bën nër (pocesi i hedhjes së vezëve të peshkut), e lidhi llainkën (proces i lidhjes së një peshe në shpinë).

**Emra që përdoren vetëm në shumës.** Në këtë grup emrash hyjnë ata emra që përfshijnë kuptime përmbledhëse, sepse tregojnë jo një shumësi të thjeshtë si sasi, por si një tërësi. Duke u mbështetur në kuptimin e tyre, emrat që përdoren vetëm në numrin shumës mund t’i grupojmë në:

- 1) Emra, që shënojnë masë të një lënde, sende të mbrujtura prej një lënde, mbeturina, shuma a grumbuj të hollash, si: krunde, petka, rosnica, të lënat, zarzavate, të mbjellat, t’ollturat “hijet” etj.
- 2) Emra të përbërë nga dy a më shumë pjesë të njëjta: bollkat, qillotat, gjyslyqet benevrekët, kryqet, ejbet, leqet, mestet etj.
- 3) Emra, që shënojnë shumësi qeniesh (frymorë, njerëz): shqera, dhen, saze, etj.
- 4) Emra që shënojnë veprime ose gjendje abstrakte, si: plakat “periudhë kohe në mbarim të marsit” të palarat; emra lojrash, festash pagane dhe fetare, si: cinglat, llazoret, rusicat etj.
- 5) Emra të përveçëm ose të përgjithshëm, që shënojnë vende (toponime), si: Llëngat, Pikot, Muzgat, Krekat, Cicat, Vreshtët, Rahët etj.



### 4.2.3 Kategoria gramatikore e rasës

Kategoria e rasës së emrave në të folmen e Devollit ka veçori të tilla që e bëjnë këtë të folme të dallueshme si të folme të toskërishtes veriore, por njëkohësisht dhe si e folme me tipare të veçanta brenda këtij grupi. Karakteristikat më të dallueshme lidhen me trajtat rasore të emrave në disa prej rasave, si dhe me pëdorimin e disa parafjalëve të veçanta.

- 1) Në rasën emërore parafjalët që përdoren janë *ne* dhe *de* (*ne* plepi i Bilishtit; *mu ne* hani i Sterjos; *shkova de lumi*; më prit *de yt'atë*; *erdhi de mua* etj.), ndërsa parafjala nga ka formën fonetike ngaj (ku j është tingull epitetik) (p.sh. *shkova ngaj lumi*, *mbante veshët për ngaj Izvori*, etj) edhe kur përdoret si përemër pyetës (*Ngaj to veni?*; *Pe ngaj jeni?*).
- 2) Disa emra, të cilët në emërore të pashquar mbarojnë me ditongun *ya*, ndërsa në emëroren e shquar këtë grup e kthejnë në *o*, në rasën kallëzore e shfaqin përsëri diftongun: *ftoi-ftyan*, *kroi-kruan*, *thoi-thuan*.
- 3) Në rasën gjinore kemi një dukuri të veçantë në raport me gjuhën standarde. Nyjet para emrave në rasën gjinore ruajnë trajtat e vjetra që, dikur, sipas J. Gjinarit kanë përbërë inovacion në këtë të folme<sup>186</sup>. Kështu nyja së e gjinisë femërore (*u* tha së motrave; *dë* mes të së mirave; *i* venë së motrës; *djali vdiq pe kulaçes së s'ëmës*) është shtrirë edhe në njëjësin dhe shumësin e gjinisë mashkullore (*u* rrit pe së lëpirit; *yxhym të shohë pe së afri*; *pe së Qafulit*; *të marrç pjesë pe së vlezërve*; *së vëllait i hipi etje për ujë*;<sup>187</sup> *pe vëndi së tij* etj.).
- 4) Në rasën kallëzore mbaresa *-në* i ngjitet menjëherë temës së emrave mashkullorë një a shumërokësh njëjës, të cilët mbarojnë në temë në zanore, si: *dhe-në*, *pëti-në*, *turi-në*, *ka-në*, *dolloma-në*. Tek emrat, të cilët mbarojnë me temë në zanore, mbaresa ngjitet dhe shqiptohet qartë. Te një pjesë emrash që mbarojnë me bashkëtingëllore, në temë ndodh procesi i asimilimit të plotë të hundores së mbaresës, si: *malnë* (*malë*), *breznë* (*brezë*), *bullgarnë* (*bullgarë*), *bandillnë* (*bandillë*), *avaznë* (*avazë*), *kaptellnë* (*kaptellë*), *pallamarnë* (*pallamarë*). Në disa prej emrave mashkullorë, të cilët mbarojnë me *-t*, grupi *tn*, i formuar nga përngjitja

<sup>186</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 114.

<sup>187</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987.

e mbaresës -në e rasës kallëzore asimilohet në bashkëtingëlloren hundore n (fshatnë> fshanë, suratnë> suranë, syretnë> syrenë “fotografi”, qytetnë> qytenë, tërmetnë> tërmenë, etj.)<sup>188</sup>. Po kështu, asimilohet dhe grupi me dy nn që formohet si rrjedhim i takimit të fonemës -n të emrave që mbarojnë me këtë bashkëtingëllore me mbresën -në të kallëzores, duke shmangur nyjëtimin e bashkëtingëlloreve dyfishe, si: kllapodanë, tallaganë, xibunë, mintanë<sup>189</sup> (por fustanen). Tek emrat mashkullorë a femërorë me theks parafundor, që mbarojnë me zanore ë të patheksuar, zanorja ë e mbaresës -në e rasës kallëzores, e ndodhur larg theksit, bie, si te fjalët: malën, kalën, djalën, shalën, pllotnicën “Iloj peshku gjoli”, xhëllirën, perpelugën “larvë bretkoce”, pisërëngën “salamandër” etj. Emrat, që mbarojnë me grup prej dy a më shumë bashkëtingëlloresh, midis grupit dhe fonemës n-së së mbaresës të kallëzores lind zanorja mbështetëse i, si: dhëntin, ekurin, gjishtin, bishtin, përçin, boshtin, cfinqin “Iloj zogu gushëverdhë”, për të shmangur vështirësinë e nyjëtimin të këtyre grupeve. Zanorja mbështetëse i është më e pranishme se zanoret e tjera pikërisht në sistemin rasor të emrave.

- 5) Në të folmen e Devollit është mjaft e gjallë e ashtuquajtura “rasë vendore”. Ajo dëshmohet herët, qysh në shkrimin e Buzukut (ndë bark të peshkut), apo te Matrënga (Kush vete ndë të të dhemburat të kathartirit; mbë të anastisurit të kurmit)<sup>190</sup>. Rasa vendore, si në të gjitha të folmet e toskërishtes veriore, ka trajtë të veçantë gramatikore. Emrat në rasën vendore dallohen se marrin mbresën -t dhe shoqërohen me parafjalë të veçanta, si: dëpër lumt; dënë të; gjer të pjekë bë ndonjë hundësh; *s’anë* dy qenër dë një govatë; bë pemët me mollë hedhin gurë; *s’bie* rufeja dë halet; *s’kursehet pyperi* bë dasmët etj. Në disa emra, të cilët mbarojnë me grup bashkëtingëlloresh, midis grupit të bashkëtingëlloreve dhe mbaresës –t(ë) të rasës vendore ndërfitet një zanore mbështetëse, si bë grazhdit, dë vreshtët etj.

<sup>188</sup> Rënia e bashkëtingëllores, qoftë e temës, qoftë e mbaresës, ka ndodhur për shkak të dukurisë së sand’hit të brendshëm në lakimin e emrave ( shih K.Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, f. 306-308).

<sup>189</sup> Asimilimi ka vepruar në gjuhë që në periudhat më të hershme e deri më sot, duke bërë të mundur thjeshtimin e grupeve të bashkëtingëlloreve, qoftë në fjalët e huazuara, qoftë në zhvillimet e trajtave fonetike dhe gamatikore të shqipes. Kjo dukuri haset që në format e hershme të shqipes të dëshmuara te Buzuku (“ashtu dhe Jakobnë e Gjonë”, dhe te Bogdani; tue shkuom Gjordanë përmbi 12 gurë”) (vep. cit. K. Topalli, Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe, f. 57).

<sup>190</sup> Shembujt janë cituar sipas K. Topallit, Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë, 1995, f. 239.

Kështu, paradigma e lakimit në këtë të folme del me një formë rasore më tepër, e cila është e dallueshme mjaft mirë edhe në gjendjen e sotme të kësaj të folmeje. Gjallimi i kësaj rase edhe sot tregon për prirjen e fortë të kësaj të folmeje ndaj konservacionit gjuhësor. Si rrjedhim i përhapjes së gjuhës standarde dhe kjo formë po zëvendësohet dalëngadalë me rasën kallëzore.

- 6) Në rasën rrjedhore të pashquar shumës, në të folmen e Devollit nuk ka formë të veçantë, që të jetë e dallueshme nga trajta e së njëjtës rasë në trajtën e shquar shumës (prej malesh-pe maleve), si: vinte pe maleve; fitilnë e nxirte pe penjrave; i pikonte pe leshrave etj. Po në rasën rrjedhore është karakteristikë përdorimi i emrit pa parafjalë, si: më rëzohej rahat; pranverave/kur hapin lulet që xbardhin kumbullat<sup>191</sup>; shkova prëmë asaj rrugice etj.

#### 4.2.4 Kategoria gramatikore e shquarsisë dhe pashquarsisë

Përsa i përket kësaj kategorie, e folmja e Devollit ka pak ndryshime nga gjuha standarde. Megjithatë, këtu mund të përmendim emrat, që në trajtën e pashquar dalin me diftongun *ua*, si: *ftua*, *krua*, *thua*, *limua*, në trajtën e shquar diftongu *ua* kthehet në *o*: *ftoi*, *kroi*, *thoi*, *lejmoi*, ndërkohë këto fjalë në trajtën e shquar në rasën kallëzore e shfaqin përsëri diftongun: *ftuanë*, *limuanë*, *thuanë* etj.

Po ashtu, disa emra (kjo vlen dhe për mbiemrat), të cilët mbarojnë me *-ër*, *-ël*, *-ëm* në të pashquarën njëjës, në të shquarën u bie *ë*-ja fundore (sikurse në gjuhën standarde), si: *dhëntër-dhëntri-dhëntret*, *veglë-vegla-veglat*, *poplë-popla-poplat*, *kanistër-kanistra-kanistrat*, *qiqrë-qiqra-qiqrat*, etj. *Ë*-ja fundore e këtyre fjalëve, pavarësisht reduktimit që ka pësuar për shkak të pozicionimit të saj larg theksit, nuk ka rënë, por është reduktuar në rrokjen parafundore.<sup>192</sup>

Përsa u përket antroponimeve, që për nga gjinia natyrore janë mashkullorë, por kanë formë gramatikore të gjinisë femërore, të cilët mbarojnë me temë në *-o* të patheksuar, në trajtën e shquar njëjës dalin me diftongun *-ua*, si: *Lyto-Lytua*, *Jorgo-Jorgua*, *Kiço-Kiçua*, *Gaqo-Gaqua* dhe jo mbaresën *-ja* si në gjuhën standarde.

<sup>191</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987.

<sup>192</sup> K. Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1995, f. 238.

Kjo dukuri vihet re dhe në disa emra të përgjithshëm të gjinisë femërore që mbarojnë po me -o të patheksuar, si: shpirt~~o~~-shpirt~~u~~, kondo-kond~~u~~,

### 4.3 Mbiemri dhe përemri

#### 4.3.1 Mbiemri

Në të folmen e Devollit klasa e mbiemrave, në përgjithësi, ka pak dallime nga gjuha standarde. Kryesisht, dallimet nuk lidhen me kategoritë gramatikore të mbiemrave, sesa me trajtat e tyre fonetike, të cilat marrin formante të caktuara fjalëformuese (kryesisht prapashtesa fjalëformuese).

- 1) Disa mbiemra që formohen nga tema foljore me anë të prapashtesave -shëm, -(ue)shëm, -(ye)shëm, pas togzanorit ue dhe ye, e rrëzojnë zanoren e të togut dhe, njëkohësisht, në prapashtesë ndodh procesi i metatezës, si: i mrekullueshëm-i mrekullushmë, i shkëlqyeshëm-i çkëlqyshmë, i pëlqyeshëm-i pëlqyshmë etj.
- 2) Mbiemrat, të cilët formohen me prapashtesë nga ndajfolje kohe ose vendi, pësojnë metatezë, si: i sotëm - i sotmë - i soçmë, i largët- i larkmë, i moçëm - i moçmë, i atëhershëm - i aerçmë (për më tepër në këtë mbiemër për shkak rrëgjimit ë ë-së paratheksore, mosnyjëtimin të h-së dhe, si rrjedhim i metatezës së dridhëses r me mbylltoren t, është krijuar grupi tsh, që sot ndihet plotësisht i afrikuar në ç, si te mbiemri i ndriçmë).
- 3) Mbiemrat e formuar nga pjesoret e foljeve që zërthejnë o-në e temës në togzanorin ua, në të folmen e Devollit dalin me diftong dhe me ë fundore, si: i besuar-i besuarë, i afruar-i anfruarë, i këkuar-i kërk~~u~~arë, i lëvruar-i lëvr~~u~~arë, i lëvd~~u~~arë-i lëvd~~u~~arë, i lëruar- i lër~~u~~arë, i harruar – i har~~u~~arë.
- 4) Mbiemri i tashëm, në ligjërimin e brezit të vjetër del i tashishmë, si rrjedhim i prejardhjes nga ndajfolja tani, e cila në të folmen e Devollit del në variantin fonetik tashi (lezeti i *tashishmë* s'është njëlloj si lezeti e aerçmë).

- 5) Mbiemrat prejpjesorë (kryesisht nga folje që formojnë pjesoren me -r(ë)) si mjet gramatikor për dallimin e gjinisë kanë vetëm nyjën e përparme (i larë - e larë, Guri i Shpuarë - vërë e çpuarë, i mashëngjyerë - e mashëngjyerë etj.).

#### 4.3.2 Përemrat

**Përemri vetor.** Përemri vetor në të folmen e Devollit ka forma të veçanta, që e dallojnë nga të folmet e tjera të toskërishtes veriore. Në këtë të folme karakteristikë e veçantë është përdorimi i vetës së tretë mashkullore njëjës në formën ay. Kjo trajtë fonetike, ku ka ndodhur buzorëzimi i zanores i, gjendet në të gjithë zonën e qarkut të Korçës, si: ay erth; ay do ta ketë marë për grua<sup>193</sup>, Mybeja solli kalnë e ay shkoj; vajta e më tha ay etj.

Po ashtu përemri i vetës së dytë shumës del në formën y-yve (y zoga që rrotulloni, y o male, y o pyllë<sup>194</sup>).

Përemri i vetës së dytë dhe të tretë në rasën kallëzore bëjnë tinë-tynë, aynë. Këto forma, mesa duket, dalin për analogji me trajtat e emrave të shquar në rasën kallëzore.<sup>195</sup> Në disa raste këta përemra përdoren dhe për rasën emërore p.sh.: ja tinë, ja Anila ta mbani ment; ngatërroje si di tinë; nga tynë qenë të futur; tinë në odë, shoqet në kënd; ay baba që ke tinë etj.

Në rasat emërore dhe kallëzore, përemri i vetës së parë dhe të dytë shumës kanë një trajtë më pak, përdoret neve për ne dhe yve për ju, si p.sh.: o po ç'jeni yve; yve të tëra mi muartë etj.

**Përemri i pacaktuar.** Në të folmen e Devollit hasim disa tipe përemrash të pacaktuar, si ata që tregojnë send të pacaktuar ose grupe sendesh në mënyrë të pacaktuar, si: gjëkafshë, asgjëkafshë, gjësend, xheç (xheç mori), ndërsa për të treguar frymor të pacaktuar përemrat njeri, ndonjeri, ndonjë etj.

Si përemër mjaft i përdorshëm për të treguar sasi të kufizuar të diçkaje del xhesa (variant çesa), p.sh.: muarnë xhesa pale; ju bënë xhesa vjet Greqi etj.

---

<sup>193</sup> K Zdruli: Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987, f. 464.

<sup>194</sup> Po aty. f. 33.

<sup>195</sup> Mbaresë -në e kallëzores i është ngjiur përemrit ti, njëlloj si emrave që përmendëm në sythin 4.2.3. Fakti që kjo mbaresë përdoret te këta përemra apo në rasta të tjera si dhe në pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, tregon që, më tepër se një trajtë gramatikore të përemrit vetor, kemi një rrokje epitetike (për më tepër shih K. Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, f. 111).

Përemri tjetër, tjetra del në variantin tjetër, tjatra, si: vallë mua më pritnje, apo ndonjë tjetër/ unë ty të pritnja, nukë pritnja tjetër<sup>196</sup> etj. Variantet me e>a janë rrjedhim i disimilimit.

Përemri i pacaktuar ca del me dy variante me prapashtesë zvogëluese: cazë dhe cackë. Kjo e dyta del në ligjërimin fëminor, por është shtrirë si formë dhe në ligjërimin e moshave më të mëdha, si: bë cazë shtie sytë jashtë njëri; *o nënë ce s'më le të fle* dhe cackë etj. Po kështu me prapashtesë zvogëluese del dhe përemri nja dy (nja dyckë).

**Përemri pronor.** Në lidhje me përemrin pronor, e folmja e Devollit ka forma të njëjta me të folmet e tjera të toskërishtes veriore, por gjithashtu paraqet dhe disa forma të dyta, të cilat në këtë të folme janë më të shpeshta për nga denduria e përdorimit<sup>197</sup>.

Më poshtë janë paraqitur tabelat e lakimit të përemrave pronorë të vetës së parë dhe të dytë si njëjës dhe shumës.

Prona-njëjës Pronari-njëjës	Veta I		Veta II	
	Mashkullore	Femërore	Mashkullore	Femërore
<b>Emërore</b>	Vëllaj jem	Çupa jeme	Vëllaj yt, jot	Çupa jote, jënde
<b>Rasat e zhdrejta</b>	Vëllajt tem, sem	Çupës teme, sime, seme	Vëllajt tënt	Çupës tënde
<b>Kallëzore</b>	Vëllanë tem	Çupën time	Vëllanë tënt	Çupën tënde

Prona-shumës Pronari-njëjës	Veta I		Veta II	
	Mashkullore	Femërore	Mashkullore	Femërore
<b>Emërore</b>	Vëllezërit tim, tem	Çupat time, teme	Vëllezërit tent, tem	Çupat tënde
<b>Rasat e zhdrejta</b>	Vëllezërve tem	Çupave time, teme	Vëllezërve tënt	Çupave tënde, sënde
<b>Kallëzore</b>	Vëllezërve tem	Çupat time, teme	Vëllezërve tënt	Çupat tënde

<sup>196</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987, f. 144.

<sup>197</sup> Larmia e formave të pronorëve në disa të folme është e madhe, sepse në to veprimi i analogjisë ka qenë aq i madh, sa dhe sot në të gjëlljnë disa variante për një pronor (J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, Dialektologjia, 2003, f. 219).

Prona-njëjës Pronari-shumës	Veta I		Veta II	
	Mashkullore	Femërore	Mashkullore	Femërore
<b>Emërore</b>	Sinori jonë, tonë	Gradina jonë, tonë	Sinori juaj, tuaj	Gradin juaj, tuaj
<b>Rasat e zhdrejta</b>	Sinorit tonë	Gradinës tonë	Sinorit tuaj, suaj	Gradinës tuaj, suaj
<b>Kallëzore</b>	Sinorë tonë	Gradinën tonë	Sinorë tuaj	Gradinën tuaj

Prona-shumës Pronari-shumës	Veta I		Veta II	
	Mashkullore	Femërore	Mashkullore	Femërore
<b>Emërore</b>	Sinorët tonë	Gradinat tona	Sinorët tuaj	Gradinat tuaja
<b>Rasat e zhdrejta</b>	Sinorëve tonë	Gradinave tona	Sinorëve tuaj	Gradinave tuaja
<b>Kallëzore</b>	Sinorët tonë	Gradinat tona	Sinorët tuaj	Gradinat tuaja

Nga tabela ku paraqiten paradigmat e lakimit të përemrave pronorë të vetës së parë dhe të dytë në njëjë dhe shumës vëmë re disa dukuri:

**Së pari**, në disa rase përemri pronor paraqitet me më shumë se një trajtë fonetike (yt/jot, jot/jënde, tënde/sënde, tuaj/suaj)

**Së dyti**, vlen të vihet në dukje se disa prej formave mjaft të dendura në përdorim përkojnë me format e pronorëve të përdorura në të folmet e gegërishtes jugore apo të folmet kalimtare. Kështu trajta tem/teme, jem/jeme, tem/semi gjenden dhe në të folmen kalimtare të Polisit<sup>198</sup>, por dhe në të folmet gege të veriut<sup>199</sup>. Në fshatrat Ziçisht, Vishocicë, Vranisht Progër, Sul, Qytezë janë hasur shumë shpesh këto forma: erdhur buri e thënë babajt tem që do bluanin (Progër), babaj jem u kthe (Ziçisht), i erdhën nënës teme (Vranisht). Përdorimi i dendur i këtyre formave

<sup>198</sup>Q. Haxhihasani, Vëzhgime rreth të folmes së Polisit, në Dialektologjia Shqiptare V, 1987, f. 109.

<sup>199</sup>B. Beci, E folmja e Shkrelit, Dialektologjia Shqiptare I, 1971; J. Gjinari, Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës, f. 331.

tregon pikëtakimet me gegërishten, duke lënë të kuptohet se këto dialekte dikur kanë qenë shumë të përhapura.

**Së treti**, trajta e përemrit pronor të vetës së parë (kur prona dhe pronari janë në numrin njëjës), trajta tim/e-tem/e, që u përket rasave të zhdrejta, është shtrirë dhe në rasën emërore (në vend të formave analitike e mi, e mia). E njëjta dukuri duhet të ketë ndodhur dhe me trajtën tënd për yt, jonë për ynë, p.sh.: vajtmë Selenik de nipi jonë (Ziçisht) dhe tonë për tanë, si p.sh.: djemtë *tonë s'i ka njeri*.

**Së katërti**, varianti i përemrit të vetës së dytë seme (dorës seme), i gjinisë femërore është shtrirë dhe për gjininë mashkullore (djalit sem, megjithëse jo fort e përhapur), po kështu ka ndodhur dhe me djalit suaj nga shtrirja e formës femërore çupës suaj.

**Së pesti**, në shembullin çupës sënde kemi një trajtë të derivuar: është përzier morfema s' e formës sate të rasave të zhdrejta (dikur një e gjinore para pronorit), me formën tënde të emërores (ku t është një e gjinore për pronorin). I njëjti proces mund të ketë ndodhur dhe te forma jënde (j(ote) e emërores+(t)ënde e kallëzores), por haset dhe forma sate, si: *penxheren 'e zotërisë sate/ e zuri pema jeshile*<sup>200</sup>.

**Së gjashti**, te përemrat pronorë të vetës së parë (prona e pronari njëjës), për gjininë mashkullore kemi zhvendosje të trajtës së gjinisë femërore dhe për gjininë mashkullore, ndërkohë për gjininë femërore kemi zhvendosje të trajtës së gjinisë mashkullore për femëroren (çupat time për teme).

**Së shtati**, trajta e kallëzores për pronorin e vetës së parë (prona dhe pronari njëjës) është e njëjtë me emëroren (prona shumë, pronari njëjës: djalin tim-djemtë tim, djalin tënd-djemtë tënd). Kjo vlen dhe për gjininë femërore

Ndërkohë, në të folmen e Devollit është mjaft e përdorur paravendosja e pronorëve, sidomos para emrave që shënojnë emra farefisnie. Këta përemra, kur paravendosen, e humbasin zanoren fundore edhe në rastet kur emri pas fillon me bashkëtingëllore, si: *jot'ëmë, jot'kunatë, tit biri, tit'eti*. Në përemrin e vetës së dytë, ku prona dhe pronari janë njëjës, ndodh shurdhimi i grupit bashkëtingëllor fundor nd dhe qiellzorëzimi i zanores ë, si rrjedhim i rrethimit fonetik me bashkëtingëllore qiellzore (tënd>tët>tit).

---

<sup>200</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987, f. 89.



Përemri pronor i vetës së pare, ku prona dhe pronari janë njëjës, dallohen në gjini me forma të veçanta, në gjininë femërore përemri merr mbaresën –e, si p.sh: im kunat/ ime kunatë; tim xhaxha/ time teto.

## 4.4 Folja

### 4.4.1 Kategoritë gramatikore të mënyrës dhe të kohës

#### Mënyra dëftore

**Koha e tashme.** Foljet e zgjedhimit të parë në kohën e tashme të tipit punoj, pilloj, pulloj “ndjek”, këndoj, rëmij “gërmoj”, lëvrij, fshij dalin me -nj. J. Gjinari thekson se përhapja e kësaj dukurie në Devoll është e ndyshme. Ka zona që këto folje i kanë me -j (Progër).<sup>201</sup> Ai thekson se të dhënat për këtë dukuri janë të pamjaftueshme, por është fakt që format me –j të këtyre foljeve shtrihen në një pjesë të Oparit (që ndodhet në të djathtë të lumit Devoll), si dhe në Gorë, Pogradec e fshatrat përfaq, deri në Çërravë, të cilat ndodhen po në të djathtë të lumit Devoll. Progri, si pozicion gjeografik, ndodhet po në të djathtë të Devollit, në grykën e luginës. Si rrjedhim, ky fshat dhe fshatra të tjerë afër me të (Cangonji, Maçurishti), që përdorin këtë formë, përbëjnë kufirin më të largët juglindor të izoglosës së përmendur. Duke i mëshuar faktit që kjo dukuri duhet marrë me rezerva nga materiali i mbledhur në terren, janë hasur dy dukuri:

**Së pari,** është e vërtetë që në format foljore me -j hasen në të folmen e Progri, por ato janë të kufizuara përgjithësisht në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore, ku pas j-së nuk ka tingull tjetër (zanore), si: i shikoj lulkat; mos e aroj; bëj esap; por, kur këto folje përdoren në mënyra dhe kohë të tjera, formanti -nj i mbaresës është mbizotërues (*s’mbanja mend*; vajta ta regjistronja; i shinja zonjat etj.).

**Së dyti,** kjo dukuri haset dhe në fshatra në të majtë të luginës së Devollit. Nga i njëjti folës përdoren të dy format (për këtë mund të përmendim materialin e mbledhur në Vranisht nga një folëse e brezit të mesëm, me katër klasë shkollë si dhe nga vajza e saj që vazhdonte arsimin e lartë. Të dyja përdornin pothuaj me të njëjtën denduri, si foljet me formantin –nj ashtu dhe me -j).

---

<sup>201</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f. 116-117.

Këto dy veçori na shtyjnë të mendojmë se format me -j është një dukuri e re, që është përhapur në ndikimin e arsimit të popullsisë<sup>202</sup>. Për më tepër, gjallimi i formave me -j krahas atyre me -nj, është ndikim i fuqishëm i gjuhës së librave dhe mediave.

Në lidhje me foljet e zgjedhimit të dytë, klasa e parë<sup>203</sup>, të cilat dalin me të njëjtën temë në tri vetat e njëjësit në të tashmen e dëftores, një pjesë e madhe e tyre mbarojnë me -t (vjasit, branovit, krastit, qerosit, luspit, ronis, babovit, kobet, përskat (po dhe përskas).

Disa prej foljeve të zgjedhimit të dytë, klasa e dytë, nënklasa e parë, të cilat në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimin apofonik e//o, mbaresat -më, -të, -në u ngjiten drejtpërdrejt temave të tyre (dreth-drothmë-drothtë-drothnë, flas-folmë- folnë etj.).

Foljet e zgjedhimit të dytë, klasa e dytë, që bëjnë pjesë në nënklasën e dytë, në vetën e dytë njëjës pësojnë ndërrimin metafonik a//e, ndërsa foljet e nënklasës së tretë, të cilat në vetën e dytë njëjës të së tashmes dëftore pësojnë ndërrimin metafonik a//e dhe në vetën e dytë shumës e//i, në vetën e parë dhe të tretë shumës marrin mbaresat -ëm, -ën (presëm-presën, dalëm-dalën, ngasëm-ngasën, flasëm-flasën, katos-katosëm, baras-barasëm, nagas-nagasëm etj.).

Foljet e parregullta josupletive dua, them në vetën e dytë shumës bëjnë duani, thuani, si: duani pa thuani; po, kjo që thuani ju; e këshçu që thuani ju. Po ashtu, te folja dua, në vetën e parë shumës, është hasur forma dvamë, ku zanorja e mbyllur u e diftongut ruhet ende si një v dybuzore<sup>204</sup> refleksi i gjysmëzanores indoevropiane që gjendet rëndom në foljet e së folmes të Devollit të Sipërm.

Folja e parregullt supletive vij (vij-erdha-ardhur) në vetën e parë njëjës nuk del me mbaresën -j (ja de vi), si rrjedhim, në vetën e parë dhe të tretë shumës, temës së kësaj vete i ngjiten mbaresat -më, -në (vi-më; vi-në).

Foljet joveprore ruhem, kruhem, quhem në vetën e tretë njëjës bëhen ruaet, kruaet, quajet duke ruajtur diftogun e formës veprare të foljes (ruaj, kruaj, quaj).

Një pjesë foljesh, të cilat mbarojnë me temë në zanore, në kohën e tashme të kësaj forme, në vend të bashkëtingëllores h marrin hundoren n (martonem, fejonem, bënet, sqonem, rëgjonesh): lan e qan e po mendonet/ kurbeti i largmë të shkretonet/ më vete buri më aronet; le të apen të lulëzonen/ pas dhënit tonë të maronen, por te foljet krihem, ndërrohem, hahem dalin

<sup>202</sup> Progri shquhet si një fshat ku arsimit është përhapur më shpejt dhe më shumë se në fshatrat rrotull tij. Aty është hapur dhe shkolla e parë shqipe për krahinën e Devollit në vitin 1908.

<sup>203</sup> Për ndarjen e foljeve në zgjedhime, klasa dhe nënklasa, është marrë për bazë klasifikimi i bërë në “Gramatikën e gjuhës shqipe 1”, botim i ASH, Tiranë, 2002.

<sup>204</sup> Për më tepër për këtë dukuri shih në sythin 3.2.2 të këtij punimi.

me j antihiatizuese: do të lajet, do të ndrojet/ pa do të na pispillojet<sup>205</sup>; njeriut si ajet, mishtë i ajet fjala.

**Koha e pakryer.** Foljet e zgjedhimit të dytë, të cilat mbarojnë me- t dhe -s në vetën e parë dhe të dytë të së pakryerës, e ruajnë bashkëtingëlloren fundore të temës dhe marrin mbaresat e së pakryerës -nja, -nje, si: bastisnje, barisnje, vaditnje, branovitnje, babovitnje, kobashitnje, donatisnje, lekovasnje; po a vallë vinje ti më mot, ti harronje e mënonje, unë ngordhnja. Karakteristikë është edhe veta e parë shumës e foljeve në mbaresën e të cilave ndodh procesi fonetik i metatezës dhe asimilimi i bashkëtingëlloreve në distancë, si: lonim>lomin>lomim, flinim>flimin>flimim, krasitnim>krasitimi>-krasitimim, shkarkonim>çkarkomin>çkarkomim, bënim>bëmin>bënim, hanim>amim>amim etj.

Foljet e parregullta josupletive dua them, nuk dalin me o në vetën e tretë njëjës, por me e (deshte, theshte dhe jo donte, thoshte). Ato ruajnë temën e vetës së parë njëjës dhe gjatë zgjedhimit të tyre nuk ndodh procesi i apofonisë. Po kështu, dhe folja dal në vetën e tretë të së pakryerës së dëftores ruan trajtën delte dhe jo dilte.

Foljet kam dhe jam në të pakryerën paraqiten me forma të shkurtuara kish dhe ish, për analogji dhe folja them (thosh). Në tri vetat e shumësit mbaresat u ngjiten formave të shkurtra: kishmë, kishhtë, kishnë/ ishmë, ishtë, ishnë/ thoshmë, thoshtë, thoshnë. Në disa variante të vjetra të këngëve popullore të mbledhura në krahinën e Devollit është hasur dhe trajta keshë, e cila është karakteristikë për të folmet e toskërishtes jugore, por sot nuk ndeshet.

Foljet në formën joveprorë, në vetën e parë të kësaj kohe, bëjnë: lodhsha, shtrisha, lasha, roptosha dhe për analogji, forma me sh shtrihet dhe për vetën e tretë njëjës: lashe, krishe, shtrishe, roptoshe dhe jo me (h)ej. Në tri vetat e shumësit janë format: lodhshi, lodhshit, lothshin. Pra, vihet re që në kohën e pakryer foljet e zgjedhimit joveprorë nuk dalin me mbaresat -(h)em, -(h)esh, -(h)ej, -(h)eshim, -(h)eshit, -(h)eshin. Në këtë të folme, mungesa e glotales h dhe reduktimi i e-së së patheksuar, sjell format e sipërmendura.

**Koha e kryer e thjeshtë.** Në kohën e kryer të thjeshtë foljet e kësaj të folmeje kanë disa karakteristika të veçanta. Në vetën e tretë foljet e zgjedhimit të parë marrin një v antihiatizuese për analogji me dy vetat e para (punovi, lërovi, rëmivi), si: të lavi të levi, bishtin ta krevi, hap sytë të gënjevi.

---

<sup>205</sup> Në këtë rast folja pispillosem, e cila në formën joveprorë mbaron me temë në bashkëtingëllore, merr trajtën me j për analogji me foljet e sipërmendura.

Foljet e parregullta shtie, shpie, zë, vë, e zgjerojnë temën me r-në e vjetër të temës së këtyre foljeve: shtiri, shpuri, zuri, vuri. Folja zë, kur përdoret si gjysmëndihmëse për të treguar fillim veprimi, rëndom përdoret në trajtën zu, si: u ap sabau, zu zbardhëllon. Kjo ndodh edhe kur përdoret me kuptim të plotë leksikor: seç u err na zu një shi; në majë të malit më zu një furtunë etj.

Në disa fshatra, në të kryerën e thjeshtë të foljeve të zgjedhimit të parë, në vetën e tretë v-ja kundër hiatit kthehet në f: punof, fitof, shkof (me se të gënjej beqari; e pref sëpata; e thef guri; e vraf dyfeku). Ky variant mund të lidhet me dukurinë e përfutimit të v-së dybuzore nga -vi si mbaresë e kohës së kryer të thjeshtë e foljeve në mënyrën dëftore, e cila në pozicion fundor shurdhohet.

J. Gjinari thekson se këto forma janë më pak të përdorura në këtë të folme<sup>206</sup>. Hulumtimet tona në terren kanë bërë të mundur që të vërejmë se këto forma kanë qenë gjerësisht të përhapura. Edhe sot ato përdoren lehtësisht nga folësit e brezit të mesëm, pavarësisht nga trysnia e gjuhës standarde. Folësit e brezit të ri priren t'i përdorin më pak, po ndërkohë përdorin format me -vi: punovi, shkovi, gënjevi. Në një pjesë të këngëve popullore të vjela në këtë krahinë janë hasur format me -jti, si: vjeshta erdhi edhe shkojti, / shoqi-*shoqin s'e bashkojti*.

Foljet dal, marr, përcjell, sjell, të zgjedhimit të dytë, klasa e dytë, nënklasa e parë, në tri vetat e shumësit të kohës së kryer të thjeshtë dalin me diftongun *ua*, si: *duallmë, dualltë, duallnë, mɥarmë, përcuallmë, mɥartë, mɥarnë*, si p.sh.: *duallmë gjer te urka; mirë ia bëmë krushkës/ i mɥarm'të bijën*.

Për format pësore-vetvetore të foljeve dalin mbaresat -më, -të, -në, që i ngjiten temës së foljes, si: u trepmë, u treptë, u trepnë. Në disa folje n asimilohet, p.sh.: u erë malet u erë. Në këto raste ka rënë bashkëtingëllorja e rrënjës, si rrjedhim i takimit të dy bashkëtingëlloreve gjatë sand'hit të brendshëm, ndërsa ë-ja fundore pastheksore nuk ka rënë<sup>207</sup> (por gjithashtu haset dhe forma u ngriçë).

**Koha e ardhme.** Në përgjithësi, në të folmet toske lindore, në veçanti në të folmen e Devollit, në kohën e ardhme pjesëza do del me bashkëtingëllore të shurdhët, to. Si në shumicën e të folemeve të toskërishtesh, pjesëza të e lidhore nuk shqiptohet kur pas saj nuk vjen ndonjë

<sup>206</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSHSH, nr. 4, 1960, f.117.

<sup>207</sup> Dukuria e rënies së ë-së fundore dhe futja e një zanoreje mbështetëse midis bashkëtingëllores fundore të temës dhe n-së sw mbaresës, është një proces që ka ndodhur në gjuhë pas periudhës paraletrare të saj, kjo dukuri haset në të folme dialektore si në veri dhe në jug. (K. Topalli Theksi në gjuhën shqipe, f. 306-309).

trajtë e shkurtër e përemrave vetorë, sidomos i vetës së tretë (to març gjë po do ta març këtë). Pjesëza të nuk vihet dhe kur folja merr pjesëzën mohuese mos, si: do ta përcjell, po do mos e pres. Folja e parregullt josupletive them, në të ardhmen ndërtohet me metafoni: pa dhe vjerës do *t'i thomi*.

## Mënyra lidhore

**Koha e tashme.** Në vetën e dytë, foljet që mbarojnë me zanore, zakonisht dalin me mbaresën -sh, po krahas tyre përdoren dendur dhe format me mbaresën -ç, si: të vesh-të veç, të shash-të shaç, të gjezdisç Shqipërinë, mos më preç me tërsëllim. Forma me -ç shfaqet te foljet e zgjedhimit të dytë që mbarojnë me -t. Formimi i grupit tsh, si rrjedhim i takimit të bashkëtingëllores fundore -t me prapashtesën -sh të lidhores, ka ndikuar në nyjëtimin e afrikuar të tij, si: të prashitç. Më pas, kjo formë është shtrirë për analogji dhe në foljet e zgjedhimeve të tjera.

Foljet në vetën e tretë njëjës, që u përkasin zgjedhimeve të parë, të dytë dhe të tretë (klasa II), të cilat nxjerrin bashkëtingëlloren r të temës së vjetër, dalin: të lërë, të vërë, të zerë, të verë, për analogji me foljet, të cilat në temë e kanë aktualisht këtë bashkëtingëllore (të marë, të nxjerë).

**Koha e pakryer.** Foljet e zgjedhimit tretë, klasa I, si dhe foljet e zgjedhimit të katërt: të shkoj, të bluaj, të punoj, të bëj, të luaj, në disa fshatra dalin me mbaresën -j në kohën e tashme të dëftores, ndërsa në disa të tjera me mbaresën -nj. Sipas J. Gjinarit, forma me -nj është e rrallë<sup>208</sup>, në fakt kjo formë është mjaft e përhapur, sidomos kur nj nuk është fonemë e vetme e mbaresës (të bënja, të rrëfenjë, të luanjë, të bëlvanej “bluaj” etj.)

Në kohën e pakryer të mënyrës lidhore foljet marr, jap etj. dalin me forma apofonike të mar-të mirrnja, të mirnje, të mirte, të mirmin, të mirnit, të mirnin; të jap-të jipnja, të jipnje, të jipte, të jipmin, të jipnit, të jipnin.

---

<sup>208</sup> J. Gjinari, Mbi të folmen e Devollit, BUSHT, SSSH, nr. 4, 1960, f.118.

Në fshatin Bradvicë është përdorur një trajtë e veçantë e foljeve në lidhore, kur folja paraprihej nga pjesëza lejore *le*. Në këtë rast pjesëza gramatikore e lidhores ka rënë (*le* vinjë, *le* qanjë, *le* venjë)<sup>209</sup>

Foljet, të cilat përdoren në mënyrën lidhore me kuptimin e urdhërores, marrin formë të veçantë, si: të vish-*i*, të *la(h)-i*, të *ndro(h)-i*. Këtu ka ndodhur procesi i rënies së tingujve (*sinkopa*<sup>210</sup>). Kjo dukuri dallohet edhe kur këto folje përdoren në vetën e dytë shumës të së tashmes të dëftores me kuptimin e habitores, si: *ç 'na mbai kaqë me sqimë*; *po mos më bë(h)i kurban*; *moj gjoska*, *moj dardharka*,/ *që ngarkoi me litarka*.

### Mënyra habitore

Përdorimi i habitores dallohet për një sërë formash, të cilat i përkasin kryesisht kohës së kryer të thjeshtë. Foljet, që në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore dalin me temë në *-t* dhe me *-jt*, e ruajnë atë edhe në mënyrën habitore: *di-ditur-ditka*, *rroj-rojtur-rojtka*, *vij-vajtur-vajtka*.

Në mënyrën habitore shfaqen trajtat me sinkopë, në kohën e tashme, veta e dytë shumës, si: *ç 'qënki kaq gojkllopashka*; *lënki*, *paski* (*lënkeni*, *qënkeni*, *paskeni*)<sup>211</sup>

Ndryshe nga gjuha standarde, ku në kohën e pakryer foljet e vetën së parë dhe të dytë dalin me mbaresat *-kështa*, *-këshe*, në Devoll dalin me mbaresat *-kërka*, *-kërke*, si: *qënkërka*, *qënkërke*, *bëkërke*, *mbajtkërke* etj.

Në vetën e tretë njëjës në kohën e pakryer të kësaj mënyre bie *-j-ja* fundore, si: *qënke n 'atë* fushë/ *qënke* një kullë; *seç* të rënke erë buza; *mbike*, *dalke*, *ndërkohë* dalin dhe format me mbaresën *-sh*, si: *qënksh*, *lojtkesh*, *paskësh* ato mënde.

Foljet, të cilat në pjesore dalin me diftong (*rëfyërë*, *gënjyërë*), e ruajnë diftongun dhe në pakryerën e habitores, si: *babajn s 'e gënjyékërke/nënës* i *rëfyékërke*.

Trajta habitore e foljes kam në kohën e pakryer shërben dhe si folje ndihmëse për formimin e së kryerës së plotë të habitores (*paske zënë vend*; *atë pelë* e *paske futur* *dë damaluk*; *halli ç 'e* *ka zënë*/ *firar paska* *ikur*; *manushaqe lule* e *bearit/paske mbirë* në *majë* të *malit* etj.).

Në të folmen e Devollit hasen dhe trajta të lidhore-habitore, si: *seç* të rënke erë syri.

<sup>209</sup> Tashmë ky fshat është pothuajse plotësisht i pabanuar. Banorët e tij janë shpërngulur në qyete dhe fshatra të tjerë, si rrjedhim është e vështirë të gjesh forma të pakontaminuara të kësaj trajte.

<sup>210</sup> K. Topalli: Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të shqipës, f. 117-1120.

<sup>211</sup> Në këto trajta ka ndodhur rënia e tingujve në trup të fjalës.

## Mënyra dëshirore

Në mënyrën dëshirore foljet e kësaj të folmeje ruajnë në një pjesë të tyre gjendjen e hershme të gjuhës.

**Koha e tashme.** Në foljet e zgjedhimi të dytë, formanti sh në vetën e tretë bie, sepse futet në grup prej tri bashkëtingëlloresh, si: pa në qaftë o berber; hap-sha, hapsh, hap-të<sup>212</sup>, po kështu dhe në folje të zgjedhimit të parë: shkofsha-shkofsh-shkoftë.

Në këtë të folme shpesh hasen format e vjetra me –ç, të cilat fillimisht duhet të jenë shfaqur në foljet e zgjedhimit të dytë që mbarojnë me -t. Takimi i bashkëtingëllores t me formantin sh të dëshirores ka krijuar grupin –tsh, i cili është afrikuar plotësisht në –ç, si: vajç e mos arthç; u gjeçim gëzuar; mbeç me shëndet; mos u ngopçi; do të dalç; në daç etj.

Gjithashtu, në këtë të folme gjenden dhe forma të lidhore-dëshirores, si: o bilbil ta bëra benë/ në ta gjeça dot folenë; a në të zënça etj.

### 4.4.2 Format e pashtjelluara të foljeve

Pjesorja e foljeve, e cila merr pjesë në ndërtimin e trajtave të tjera foljore të përbëra, në të folmen e Devollit gjendet e pareduktuar. Ajo paraqitet në variante të ndryshme për kategori të ndryshme foljesh.

Pjesoren me –ur e formojnë ato folje që në të kryerën e thjeshtë, në vetën e parë, njëjës, dalin me –a, si: vdiqa-vdekur, kumandara-kumandarur, xbraza-xbrazur, blojta-blojtur, kruaj-kruajtur, prashit-prashitur etj.

Pjesoren me –rë e formojnë foljet, të cilat në të kryerën e thjeshtë, në dy vetat e para të njëjësit, dalin me -va, -ve, si: refeva-referë, ktheva-ktherë, leva-lyerë, thava-tharë, lesoj-lesuarë, rëmbeva-rëmberë etj. Disa prej këtyre foljeve, të cilat në gjuhën letrare kanë formën e pjesores me diftongun ye, në këtë të folme e monoftongojnë në e.

Me mbaresën –n(ë) e formojnë pjesoren disa folje të parregullta, supletive dhe josupletive, si: qënë, zënë, vënë, thënë, rënë etj. Por, në disa raste, folja bie, si folje e parregullt supletive, në pjesore del me formën rarë: rarë pe qiellit/ nga ke rarë.

---

<sup>212</sup> K. Topalli, (Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të shqipes, f. 145-146), i quan si rënie e grupeve të bashkëtingëlloreve.

Me mbaresën –ë e formojnë pjesoren folje, të cilat në kohën e tashme të mënyrës dëftore mbarojnë me bashkëtingëlloret lëngëzore -l, -ll, -r, si: mjelë, dalë, mbjellë, pjellë, marë, nxjerë etj.

Paskjorja, si formë foljore perifrazike, e krijuar brenda shqipes gjatë zhvillimit historik të saj, në të folmen e Devollit del si në të gjithë toskërishten dhe në gjuhën letrare me strukturën për+emër foljor asnjansës i pashquar: erdhi për të punuarë.

Përcjellorja, si formë foljore e pashtjelluar, ndërtohet me pjesëzën gramatikore duke në trajtën fonetike dyke (për shkak të rrethimit fonetik të zanores u-ja qiellzorëzohet në y).

Në të folmen e Devollit përdoret një formë e veçantë e përcjellores, e cila tregon një veprim të zgjatur, por që kufizohet brenda një kohe të caktuar, si: erdhi dyke me ndenjor, u sëmur dyke me qënë mirë e bukur etj.

## 4.5 Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës

### 4.5.1 Ndajfoljet

Përsa u përket ndajfoljeve në të folmen e Devollit, hasim trajta të veçanta fonemore dhe morfologjike të tyre. Këto trajta të veçanta kanë ardhur si rrjedhim i veçorive fonetike karakteristike për të folmen e Devollit, të cilat kanë sjellë ndryshime morfologjike të trajtave të tyre.

- 1) Te ndajfoljet që kanë grupin sht në trup të fjalës, në disa fshatra njëtohen me shç, si: jashçë, përjashçë etj.
- 2) Në të folmen e Devollit hasen ndajfolje me rrokje epitetike, si: pastazaj, njëdizaj, njënazaj etj
- 3) Prapashtesat zvogëluese shfaqen dhe në ndajfolje të veçanta vendi apo sasië, si këtuckë, cackë.
- 4) Po me rrokje epitetike, por për analogji me kallëzoren e emrave, dalin ndajfolje, si këtunë, atynë, tashtinë, si p. sh.; *si s' mu ndodh vëllai këtunë*; në mos arthtë e tashtinë. Në të folmen e Devollit të Poshtëm ndajfolja e kohës haset në variantin mbrëmë, në Devollin e Sipërm, e sidomos nga folës të brezit të vjetër dhe të mesëm, del me



variantin prëmë, ku grupi mb është shurdhuar në pozicion nistor. Po ashtu, po në këtë të folme ka dhe ndajfolje kohe të përngjitura të tipit mbrëmanet (p.sh. buri ardhi mbrëmanet), apo vendi, si p.sh. përmatanë.

- 5) Nën veprimin e sand'hit të jashtëm, ndajfolja me prejardhje turke avash apo në formë lokucioni avash-avash, del në trajën javash<sup>213</sup> si tek emrat: i jati, e jëma.
- 6) Në të folmen e Devollit në vend të ndajfoljes përsëri, prapë, përdoret ndajfolja gjende dhe me variantin gjene.

#### 4.5.2 Lidhëzat dhe parafjalët

Përsa u përket lidhëzave është për t'u shënuar që në të folmen e Devollit përdoren disa lidhëza që nuk gjenden në të folme të tjera. Kështu, shërbejnë si lidhëza nënrenditëse shkakore qynqë “meqenëse”, madam që “meqenëse”, si p. sh.: E po qynqë thënke kështu, mirë po është e vogël; E po, madam që *s'ma jep shaminë*, unë do vinj me ty.

Lidhëza nënrenditëse gjer, e cila në të folme të tjera del e përngjitur gjersa, në të folmen e Devollit përdoret kryesisht si fjalë e parme, si p.sh.: prite gjer të vijë; gjer të vijë ai kam mbaruar punë.

Lidhëza nënrenditëse kushtore në del në variantin fonetik dë, si p.sh.: dë mos kor, mblidh urof; dë qaftë, tunde; dë thënçin se janë tanë,/ sihariq do jap gjerdanë, dë thënçin se “ja po vinë”,/ *sihariq do jap florinë*,/ pa dë thënçin se jan' të botës,/ mur më *mur do t'i bie kokës*<sup>214</sup>.

Klasa e parafjalëve në të folmen Devollit është mjaftë larmishme nga kuptimet që shprehin dhe nga trajtat fonetiko-gramatikore:

- 1) Parafjalët në rasën emërore janë: ngaj, ne, de. Parafjala nga del pothuaj në të gjithë zonën me tingullin epitetik –j. Kjo formë ruhet dhe në toponimet që kanë në strukturë këtë parafjalë (Ngaj klishka).
- 2) Parafjalët ne dhe de shprehin të njëjtat kuptime dhe janë variante të parafjalës te (te>nte>nde>ne, de). Gjymtyrët e paraprira nga këto parafjalë tregojnë vendin ku ndodhet a bëhet diçka apo sendin a njeriun drejt të cilit shkon një lëvizje a veprim; de Plepi i Bilishtit; erthnë ne mua; dolla de porta; unë e Nexhmija vajtmë ne Anila.

<sup>213</sup> Ndodh e njëjta dukuri si te emrat i jati; e jëma, apo te folja javitu ku tingulli j ndërfitet për të shmangur hiatin.

<sup>214</sup> Këngë popullore të rrethit të Korçës, Botim i A Sh, Tiranë, 1982.

- 3) Parafjala nga(j) mund të tregojë vend nga niset a përfundon një veprim: to shkojmë ngaj Arat e Shuma; mund të tregojë prejardhjen a vendin nga vjen dikush: jam ngaj Devolli; u rëzua poshtë, ngaj shkallët; mund të tregojë shkak: ngaj punët e shumta u lodh; por ajo përdoret dhe me kuptimin e parafjalës për, si: vinte ngaj natë.
- 4) Parafjala dë, që në të folme të tjera i përgjigjet parafjala e rasës kallëzore në, në të folmen e Devollit tregon vend: gjer dë Korçë, dë hundët kishte lesh; e vu dë xhept këtë llaf; apo kohë: u ngrit dë mëngjest.
- 5) Parafjala bë (mbë) përdoret me kuptimin e parafjalës **më** (bë tresh); me kuptimin e parafjalës **në** (e ndejmë bë djellt; ai ri bë vëndit; si bë vakt të baktisë; në zemërherë); me kuptimin e parafjalës **me**: më ngjan bë motrën; e nxjer inatnë bë mua etj.
- 6) Parafjala pe, (prej) tregon kohë (*pe vitesh s'ish dukur*); prejardhje (pe Devolli; një burë pe së Poros); vend (zbriti pe klishës); shkak (si duroej pe gazit).
- 7) Parafjalët e së ashtuquajturës “rasë vendore dalin” me asimilim të hundores dhe vazhdojnë të përdoren dhe sot: dë, mbë, dëpër, dënë etj.

#### 4.5.3 Pjesëzat dhe pasthirrat

Në të folmen e Devollit, hasim pjesëza me kuptim të përforcues, si pjesëza mu e cila në shumë raste del dhe e përngjitur me parafjalën te (*mun'te*). Në këtë pjesëz, n shërben si tingull epetentik (përngjitja mund të ketë ardhur si rrjedhimi përdorimit të kësaj pjesëze me parafjalën e kallëzores në dhe për analogji të jetë shtrirë dhe në parafjalën e rasës emërore te).

Fjala de përdoret si pjesëz gramatikore për të shprehur veprimin e foljes në kohën e tashme, që po ndodh pikërisht në çastin e ligjërit, e barazvlefshme me pjesëzën po, si: ja de vjen, de vinte etj.

Pjesëza deri (deri këtu) del në formën gjer, si: erthnë gjer dë fshat; zbritnë gjer Bilisht; etj. Pjesëza dyshuese ndoshta del në variantin ndofta, ku në shumë raste asimilohet bashkëtingëllorja hundore, si p. sh.: dofta vjen sot.

## 4.6 Dukuri sintaksore në të folmen e Devollit

Rrafshi sintaksor në të folmet dhe dialektet e gjuhës shqipe ka dallime më të pakta, megjithatë, në të folmen e Devollit, hasen disa struktura sintaksore të veçanta, që lidhen kryesisht me përshtatjen rasore të emrave me parafjalët, përshtatjen kryefjalë-kallëzues apo përdorimet si gjymtyrë fjalie të formave të caktuara rasore.

Kështu, gjejmë përdorimin e shpeshtë të parafjalës pe (të rasës rrjedhore) me gjithë kuptimet që tregon kjo rasë (originë, lëndë etj.). Por, në disa raste, kjo parafjalë merr pas një emër ose përemër në rasën kallëzore: u nis pe këtu; e ke pe mua; kishte pe mishnë tim; mori pe atë që më the tinë.

Në disa raste, pas parafjalës de të rasës emërore, përemri i vetës së parë unë përdoret në trajtën e rasës kallëzore mua, si: Ç'qefil le ti de mua. Po kështu, dhe parafjala pas mund të ndiqet nga një emër, përemër apo numëror në rasën kallëzore (ay pas tre vjet u nis për dë fshat, erdhi pas mua).

Kur një rrethanor vendi shprehet me emër në kallëzore të pashquar me parafjalë, vihet re që emri vjen menjëherë pas foljes (vajta Korçë; dolli Arzë; tërë doçët gunat Popoven i lanë; dole ngaj Shëngjergji/ vajte Potgori; Ponçarë u zu dyfek). Po kështu ndodh dhe kur në fjali ka një kundrinor të zhdrejtë me parafjalë (mbushur pamporët shqiptarë; mbushi një gomar fshesa; që në Dardhë e Allasonjë/ u mbushnë mali evzonë; shtiri sytë nga Marjani/ mbushur zabitë të Junanit).

Në disa raste, pas parafjalës për të kallëzores, emri vendoset në rasë të zhdrejtë: e mer dhe e ngul për mishi; ay mer për xhadesë.

Në togfjalëshat, ku si gjymtyrë kryesore shërben një emër në rasën kallëzore i paraprirë nga parafjalët në, mbi, nëpër, për, me dhe si gjymtyrë të varur një emër në rasën gjinore ose një mbiemër të nyjshëm, si në gegërishten jugore dhe në toskërishten veriore, përkatësisht në të folmen e Devollit, gjymtyra e varur e togfjalëshit e ruan një përkatëse, si: dë fushën e lëruarë, vajtmë bë shtëpinë e Fotinisë, për bajramnë e voglë, me pogaçen e dasmës etj.

Një dukuri interesante vihet re në përdorimin të nyjës e dhe jo të te mbiemrat, që shërbejnë si përcaktor kallëzuesor i kundrinorit të drejtë, si: e ka gjaknë e ëmbël; e ka vërnë e ngushtë; e ka viçnë e voglë; kush e pat krahun e thatë; e ka kripën e thatë etj.

Rrethanori i vendit shprehet kryesisht me emër në rasën vendore me parafjalët përkatëse të kësaj rase, si: fustanin e bardhë dënë glut; kalon dëpër lumt; e ndevi bë djellt etj.

Në disa raste, rrethanori i mënyrës apo i kohës shprehet me formë foljore të pashtjelluar të tipit me+ emër prejpjesor, si: e mori me të lehur; me të pyeturë gjen Stambollë; me të thënë kështu, fshati shkau në një vend më të mirë e më të bukur etj.

Kur kryefjala është emër kolektiv, kallëzuesi vihet në shumës, si: bënë fshati qarje; duallë Manastiri tërë; kishnë të drejtë bota, duallë pe klishe dynjallëku; tërë malla e tërë fshati ardhë; ndrenë e sulmuanë ushtria dhe iku <sup>215</sup>.

Në ndërtimet sintaksore të disa rrethorëve të shprehur me emra në rasën rrjedhore me parafjalën pe vihet re përdorimi i dy a më shumë parafjalëve, si: dolli pe prapa gardhit të kalives; u nis pe ngaj xhadeja etj.

Në fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore, folja e pjesës kryesore vihet kryesisht në mënyrën urdhërore: dë mos pastë lumi/ çap i mbush dë çezmë; d'e kishë të voglë mos i jepnje burrë<sup>216</sup>; dë mos kor, mblidh urof; dë të shaftë vjera.

Po në fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore, folja e pjesës së nënrenditur nuk vihet në mënyrën kushtore, por në mënyrën dëftore ose habitore, si: po si ardhka vakti, s'e gjen gjë.

---

<sup>215</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987.

<sup>216</sup> Këngë popullore të rrethit të Korçës, Botim i ASH, Tiranë, 1982.

## 5. DUKURI TË FJALËFORMIMIT DHE TË FRAZELOGJISË NË TË FOLMEN E DEVOLLIT

### 5.1 Fjalëformimi

Veçoritë dialektore, të cilat kanë bërë të mundur përvijimin e dialekteve, nëndialekteve apo dhe të folmeve të veçanta, lidhen dhe me mënyrat e formimit të fjalëve.

Studimet dialektore në fushë të shqipes kanë sjellë shumë formante e formime dialektore, të cilat e ndërlikojnë natyrën dialektore të leksikut përkatës me elementët gramatikore a fjalëformuese përkatëse<sup>217</sup>. Kjo ka sjellë që, në literaturën gjuhësore, të pranohet tashmë karakteri dialektor edhe i klasave të veçanta leksiko-gramatikore të fjalëve.

Që në gramatikat e para për gjuhën shqipe, duke nisur me atë të J. G. Hanit, më tej me Dh. Kamardën<sup>218</sup> janë përcaktuar si një element fjalëformues disa prapashtesa bashkë me funksionet e tyre. Studime të plota për numrin, llojin, prejardhjen, funksionin, variantet sipas dialekteve etj. të parashtesave dhe të prapashtesave të gjuhës shqipe, janë punimet e E. Çabejt dhe A. Xhuvanit “Parashtesat e gjuhës shqipe” dhe “Prapashtesat në gjuhën shqipe”, si një nga burimet kryesore të referimit për veçoritë e dhe përhapjen e ndajshesave në dialekte dhe të folme.

E folmja e Devollit, në kuadrin e ndarjes dialektore të shqipes, është klasifikuar në të folmet anësore lindore të grupit të të folmeve të toskërishtes veriore edhe për faktin që në këtë të folme ndajshtesat dallojnë për veçori fonetike dhe funksione të caktuara<sup>219</sup>. Në radhë të parë, kjo e folme dallohet për ndajshtesat me funksion zvogëlues e përkëdhelës. Brenda të folmeve të toskërishtes veriore, me këtë funksion, këto ndajshtesa nuk kanë të njëjtën peshë, madje dhe brenda të folmes së Devollit ka dallime. Për shembull, prapashtesa –zë, që luan të njëjtin rol me prapashtesa -kë në formimin e fjalëve, ka një denduri shumë të ulët se ajo<sup>220</sup>. Po ashtu, prapashtesa -kë ka larmi formash për shkak të përngjitjes së saj me prapashtesa të tjera.

J. Gjinari ka shkruar se: “Sot, ndër të të folmet e shqipes, shihen dallime dhe për shkak të fjalëve të prejardhura të formuara me prapashtesa zvogëluese dhe përkëdhelëse në të cilën

---

<sup>217</sup> J. Thomaj, Leksiku dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme, PEGI, Tiranë, 2001, f. 72.

<sup>218</sup> Po aty.

<sup>219</sup> Shih në pjesën 2.2 të këtij punimi.

<sup>220</sup> J. Thomaj, Leksiku dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme, PEGI, Tiranë, 2001, f. 72.

dallohen qartë të folmet e toskërishtes veriore, por ndërkohë që në të folmen e Devollit është e përhapur kryesisht prapashtesa –kë dhe e përngjitur me prapashtesa të tjera, prapashteza -z(ë) ka përdorim më të kufizuar.”<sup>221</sup>.

Këto prapashtesa sinonimike kanë dallime se u shtohen temave fjalëformuese sipas përkatësisë leksiko-gramatikore, por dhe se kanë nuanca kuptimore të ndryshme brenda kuptimeve të veçanta. Njëkohësisht, mund të theksohet se disa prapashtesa të huaja që kanë hyrë bashkë me fjalët nga gjuha huajtëse, sot janë bërë prodhimtare me tema të shqipes.

Te fjalëformat e të folmes së Devollit bien në sy ndajshitesat që në fjalë dalin si variante fonetike dilaektore. Këto parashtesa kanë ardhur si rrjedhim i proceseve të caktuara fonetike (kryesisht nga zëshmimimi, shurdhimi dhe afrikimi të tingujve bashkëtingëllorë që funksionojnë si parashtesa apo janë tinguj fundorë të prapashtesave të caktuara), si: zh/vesh-xh/vesh, sh/kul-çkul, z/bath-x/bath, dem/ush-dem/uç etj.

Në të folmen e Devollit dallojmë dy grupe kompozitash. Një grup mjaft të larmishëm në forma dhe kuptime e përbëjnë kompozitat e përdorura në poezinë dhe këngën popullore dhe në grupin tjetër të kompozitave përfshihen ato të leksikut aktiv të përditshëm. Ndërsa të parat janë formime që lidhen kryesisht me emërtimin e tipareve të dikujt a diçkaje për efekt stilistik, kompozitat e grupit të dytë janë të qëndrueshme, më të vjetra dhe në to shpesh kanë ndodhur ndryshime të tilla fonetike që shpesh vështirësojnë dallimin e gjymtyrëve të kompozitës.

Fjalët e përngjitura, si në mbarë shqipen, janë të kufizuara kryesisht në klasën e përemrave, ndajfoljeve, parafjalëve dhe lidhëzave, por nga pikëpamja e formave dialektore të gjymtyrëve të fjalës së përngjitur kanë tipare të dallueshme nga të folmet e tjera. Kjo lidhet kryesisht me temat fjalëformuese kuptimplota dhe jokuptimplota që janë përngjitur, të cilat janë të ndryshme në varësi të dialektit, por dhe me variante fonetike të ndryshme në varësi të të folmes (gjëkafshë, gjësendi, dëpër, ndoshta-ndofta, matanë). Por disa prej tyre dallohen edhe nga fakti se janë karakteristike vetëm për këtë të folme dhe nuk gjenden në të folme të tjera (madam, qynqë etj.).

---

<sup>221</sup> J. Gjinari, Mbi disa elemente sllave në të folmet e toskërishtes veriore, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë, 1972, f. 271.

## 5.2 Prejardhja

Prejardhja është një nga mënyrat kryesore të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Me anë të ndajshesave, si mjete kryesore fjalëformuese, dhe nyjës, si mjet gramatikor, krijohet një shtresë shumë e gjerë fjalësh me kuptime të reja. Në formimet parashtesore, përgjithësisht, nuk ndryshon kategoria leksiko-gramatikore e fjalëve dhe kjo dallohet dhe në të folmen e Devollit (kryesisht parashtesat krijojnë fjalë me kuptim të kundërt ose përforcues, si: çkul, xbath, xhdëmtoj, çquaj etj.), ndërsa prejardhja prapashtesore paraqitet më e larmishme. Duhet theksuar se këto prapashtesa, pavarësisht burimit, në shumë raste janë bërë mjaft prodhimtare dhe kanë hyrë, në disa raste, dhe në gjuhën standarde.

### 5.2.1 Prejardhja parashtesore

Në krahinën e Devollit dallohen një sërë parashtesash, të cilat kanë një përdorim të kufizuar brenda kësaj të folmeje. Pjesa më e madhe e tyre paraqiten si variante fonetike dialektore të parashtesave me funksione të caktuara:

- 1) Parashtesa ç- gjendet rëndom në të folmen e Devollit. Ajo u ngjitet temave foljore me funksionin të ndryshme:
  - a) Disa foljeve për t'u dhënë kuptim të kundërt, pa ndryshuar kategorinë e tyre leksiko-gramatikore, si: çkarkoj, u çkujdes, është çkatëruarë, çkallmoj, çqep, çmorit, çklepsit etj.
  - b) Po me këtë funksion ajo u ngjitet disa emrave për të formuar folje, si: çkoq (koqe), çfaq (faqe) etj.
  - c) U ngjitet disa foljeve për t'u dhënë kuptim përforcues ose faktik, si: çkëpus, çkëmbej çquaj etj.

Në të tri grupet e mësipërme, ajo paraqitet si një variant i afrikuar i parashtesës sh- që, siç dihet, vendoset para fjalëve që fillojnë me bashkëtingëllore të shurdhët. Kjo dukuri vihet re sidomos në pjesën e Devollit të Sipërm dhe kryesisht te folësit e brezit të vjetër. Si një parashtesë e burimit të shqipes<sup>222</sup> ajo është e pranishme dhe në fjalë që gjenden dhe te

---

<sup>222</sup> E. Çabej dhe A. Xhuvani, duke iu referuar Pedersenit, vënë në dukje se kjo parashtesë është një refleks i parashtesës së indoevropianishtes dis-, shumë e afërt me geq. e vjetër *δυσ-*. (Parashtesat në gjuhën shqipe, BUSSHT, SSHSH, nr. 4., 1956, f. 71).

shkrimtarët e vjetër të Veriut, si: i çpejtë, çkrepem, por është mjaft prodhimtare në këtë variant fonetik dhe te fjalë të reja, që në gjuhën standarde dalin me sh-, si: çpërdorj, çpërngul, çpërlaj etj.

- 2) Me parashtesën kollo- në të folmen e Devollit hasen fjalë, si: kolloface, gollozdrum “njeri i madh në trup, që nuk është i shkathët”, Kollovoz (toponim), kollozhek “janar”. Kjo parashtesë mund të jetë një refleks i një parashtese sllave dhe në këtë të folme del me variantin me nistore të zëshmuar gollo-, si: gollogash “lakuriq”, gollogungë “arrë e zhveshur nga lëvorja” ose mund të jetë ndikim nga greqishtja kollo-.<sup>223</sup>
- 3) Me funksionin e parashtesës del dhe lidhëza nënrenditëse kohore që, e cila u vihet disa temave ndajfoljore për të formuar kryesisht ndajfolje kohe, si: qëkuri, qëmoti, qëpari etj.
- 4) Parashtesa s- në të folmen e Devollit u vihet disa fjalëve me kuptim mungesor, si: *sëmundë* (*s'mund*), *skamje* (*s'kam*) *smirë* (*mirë*) (variant fonetik dialektor cmirë) apo me funksion përgjasimi, si: sfurk (furkë) (variant fonetik cfurk). Te fjalët sëmundë dhe *skamje* del mjaft qartë burimi i parashtesës nga pjesëza mohuese s'. Por, në fjalë të tilla si *ckuq* (i *ckuqur*), *burimi* dhe funksioni i kësaj parashtese është i mjegullt<sup>224</sup>.
- 5) Parashtesa x- nuk është gjë tjetër veç një variant dialektor i parashtesës z-, që u ngjitet fjalëve që fillojnë me një bashkëtingëllore të zëshme, kryesisht për të krijuar fjalë të reja me kuptim të kundërt, si: *xbath*, *xbuluanë*, *xbërthej*, apo dhe pa ndonjë funksion të caktuar, si: *xbritmë*, *u xvarrisnë*, *ju xvordhit*, *xvogëloj* etj.
- 6) Parashtesa xh- është variant dialektor i parashtesës zh-, e cila u ngjitet fjalëve që fillojnë me bashkëtingëllore të zëshme. Ajo shërben si parashtesë për krijimin e fjalëve të reja me kuptim të kundërt, si: *xhdukshe*, *xhvishçe*, e *xhdëmtuanë* etj.

### 5.2.2 Prejardhja prapashtesore

Në të folmen e Devollit ka një larmi prapashtesash shqipe dhe të huazuara, të cilat formojnë grupe fjalësh dhe fjalëformash karkteristike për të folmen e krahinës. Midis tyre zënë

---

<sup>223</sup> E.Çabej dhe A. Xhuvani nuk japin një mendim përfundimtar dhe për faktin se kjo parashtesë ka funksione të paqarta, pavarësisht se në pjesën më të madhe të rasteve ka ngjyrim keqësues, ironik. Për më tepër, disa fjalëve, si: *kollomaqe*, *kollovar*, që e përmbajnë këtë formant, nuk u dihet ende etimologjia (“Parashtesat në gjuhën shqipe”, Studime gjuhësore III, 1977, f. 77).

<sup>224</sup> Përsa i përket mbiemrit prejppesor i *squatë* mund të vihet në dukje se në temën fjalëformuese kemi shurdhimin e grupit të nistoreve të zëshme nga varianti themelor i zgjuar dhe jo një parashtesë të veçantë.



vend prapashtesa të thjeshta dhe kombinime, përbërje apo pëngjitje formantesh prapashtesore. Disa formante të truallit vendës janë përzier me ato të huazuara (kryesisht greke, sllave e turke), duke u bërë burim i formave analoge në këtë të folme dhe në gjuhë të tjera ballkanike. Prapashtesat zvogëluese zënë pjesën më të madhe të prapashtesave, sidomos në fjalëformimin e emrave.

Në formimet prapashtesore të të folmes së Devollit dallohen këto formante kryesore prapashtesore:

- 1) Me prapashtesën –ac formohen pak fjalë nga tema emërore të cilat marrin kuptim keqësues, si: gojac, hundac, pordhac, tullac etj.
- 2) Prapashtesa -aç/-açkë është me burim sllav<sup>225</sup>. Ajo shërben për të formuar emra me funksion përngjasimi ose dhe pa funksion, duke shënuar një send a një vegël, si: kutull/açkë, furk/açkë, llok/açkë “pellg i vogël me ujë”, prokovaç “lloj mbulesë e punuar me lesh të trashë dhije” (nga prokof “mbulesë për të vdekurit”), vanda(k)-çkë etj. Në variantin –aç ajo gjendet te fjalët të huazuara nga bullgarishtja, si: pregaç “përparëse”, kulaç, sandraç “vegël pune që shtrëngon hundën e kuajve kur i mbathin” etj. Me funksionin e formimit të emrave të sendeve, për analogji, ajo mund të ketë kaluar si formant dhe në formimin e emrave që shënojnë vegla pune, si kruaçkë “lloj thike që përdorej në prodhimin e enëve prej balte”, furkaçe-furkaçkë etj. Gjithashtu, formohen emra a mbiemra nga emra me funksion keqësues apo që shënojnë cilësi (kryesisht të keqe), si gag-aç, gung-aç, hund-aç/kë. Prapashtesa -açkë del si variant i përngjitur i prapashtesës -aç me prapashtesën zvogëluese –kë, duke u dhënë fjalëve kuptim zvogëlues.
- 3) Pavarësisht se formanti -alkë/-ajkë si prapashtesë në të folmen e Devollit ka hyrë bashkë me fjalët e huazuara nga burimi sllav, si: sovalkë-sovajkë, shajkë “gozhdë e vogël, alkë” për analogji, ajo është ngjitur dhe disa tema shqipe, si: drug-alkë, këmb-alkë “këmbalec druri që përdoret në festa” etj.
- 4) Prapashtesa -ak gjendet në një sërë emrash që shënojnë një shpend, bimë apo janë emra banorësh si pilurak. Sipas Vaigandit<sup>226</sup>, kjo prapashtesë në fjalë të veçanta ka funksion keqësues, nga i cili ka rrjedhur dhe kuptimi i shtazëve meshkuj, si: ftujak, gjosak “mushkë mashkull me qime ngjyrë gështenjë e buzë të bardha” (nga gjosë “cjav i zi me vija rreth

<sup>225</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, “Studime gjuhësore III”, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 196.

<sup>226</sup> Po aty, f. 199.

syve”), kërçak “lepur motak”, rosak, shytak etj. apo te disa ndajfolje me prejardhje nga tingullimitime, si: bubulak, çulak “që është çul, pa qime”, tallambak “stomaku i bagëtime; fshikëza e tëmthit te peshqit”, si dhe në disa emra sendesh, si: bythak, dorak etj.

- 5) Prapashtesa -all/-allkë gjendet në pak fjalë, si: preshallkë, peshtemall (picetë, përparëse). Fjala peshtemall mund të jetë formuar me këtë prapashtesë nga tema fjalëformuese mbështjell (variant dialektor i Devollit pështjell). Fjalët partallë, krepallë janë të huazuara si të tilla përkatësisht nga rumanishtja dhe sllaviashtja.<sup>227</sup>
- 6) Prapashtesa -an gjendet në pak fjalë që shëojnë emërtime të përgjithshme apo të përveçme të kafshëve sipas tipareve të lëkurës, si: laragan, larushan, zeshkan etj.
- 7) Me prapashtesën -aq/kë, ka fjalë si: gollomaqkë “bukë ose llokume e mbështjellë në një copë nape në vend të biberonit”, kocaqe, kollomaqe, llullumaq/e “e papjekur mirë”, përvëlaqe “lloj gatimi me brumë të zier e të pjekur në saç” etj. Kjo prapashtesë mund të jetë me burim nga greqishtja, sot nuk është shumë prodhimtare. Ajo ka mbetur në një varg antroponimesh që i përkasin besimit ortodoks, si: Ligoraq, Mihallaq, Vasillaq etj. Në emrat e përgjithshëm përdoret kryesisht për të shprehur nuancë zmadhuese e keqësuese, ndërsa te emrat vetjakë kjo prapashtesë e ka humbur funksionin e saj zvogëlues që e ka në gjuhën greke.
- 8) Prapashtesa –ar/-are formon emra prej temash emërore që shënojnë diçka ose vendin ku gjendet diçka, si: bullar “lloj gjarpri, bolla e shtëpisë”, gozhdare “euf. prapanicë”, guzhunjar “thembra e këmbës”, kashtar/e “grumbull me purteka, kashtë e dëllinja që i vihet zjarri për Ditën e Verës”, kokarkë “qepë me kokërr të vogël që përdoret si farë për mbjellje”, kukumarkë “lloj perustie prej argjile të pjekur”, pishtar, shtupar/kë “copë leshi për pastrimin e enëve apo fërkimin e trupit gjatë larjes”, strumbullar etj. Po ashtu, formohen emra prej temsh emërore që shënojnë prejardhje, si: babanar, bitinar, bradvicar, dardhar, grapshar, oçishtar, qytezar, sinicar, ziçishtar etj. Me prapashtesën trajtëformuese –e apo prapashtesën zvogëluese -kë, prapashtesa –ar shërben për të formuar shumicën e emrave që tregojnë banoret femra të një vendi, si: bickallarkë (nga bickalli), bilishtare, bitinare, kapshticare, oçishtare, progarkë, shyecarkë, vishoshicare, ziçishtare. Sipas E. Çabejt dhe A. Xhuvanit, kjo prapashtesë mund të jetë me burim latin, nga

---

<sup>227</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, Studime gjuhësore II, 1977, f. 201.

prapashtesa –arius në të gjitha gjuhët ballkanike<sup>228</sup>. Ndërsa sipas M. Domit prapashtesa – ar është e burimit të lashtë indoevropian që ka si funksion kryesor shenjimin e banorëve të një vendi.<sup>229</sup>

- 9) Prapashtesa –ashkë, e cila është përngjitje e papashesës -ash me prapashtesën zvogëluese –kë, formon emra zvogëlues sendesh nga tema fjalëformuese emërore, si: dorashkë, dredhashkë, enashkë, farashkë, gjymashkë, grykashkë, kryqashkë “veshje e brendshme për fëmijë me rripa që i lidheshin kryq në trup”, ligashkë “përparëse e vogël që u lidhet në qafë fëmijëve”, lugashkë “mjet metali a plastike që shërben për të veshur këpucët”, qypashkë etj. Në disa raste, me të njëjtin funksion, ajo shërben për të formuar të njëjtin tip fjalësh nga tema mbiemërore apo foljore, si: fellashkë “lugë e madhe dhe e thellë”, tundurashkë “napë për të mbajtur gjizë” etj. Te disa fjalë të tjera kjo prapashtesë shërben për të formuar fjalë që shënon cilësi, si: balashkë, barashkë, kobashkë, larashkë, murmashkë, verdhashkë etj. E. Çabej dhe A. Xhuvani theksojnë se fjalëve barashkë, bluashkë nuk u dihet kuptimi<sup>230</sup>. Një mundësi është që këto fjalë ta kenë prejardhjen nga foljet përkatëse bluaj dhe baras. Në rastin e parë kalimi i kuptimit mund të jetë bërë me metonimi (nga bluaj drithin në procesin e lëmimit të të drurit me anë të zdrukthit), ndërsa e dyta është folje e huazuar nga greqishtja me kuptimin ec (barashkë “grua që ec shumë, vete sa këtej-andej”). Fjala klopashkë “fletë e hollë që mbyll dhe hap vrimën ku del mielli i bluar në mulli” (me variantet kllapashkë, kllapashkë) mund të jetë formuar me prapashtesën –ashkë nga tema kllapë.
- 10) Me prapashtesa –avec janë formuar pak emra dhe mbiemra me kuptim keqësues, si: gilavec (variant me metatezë i ligavec), grindavec, llapavec “borë gjysmë e shkrirë” etj. E. Çabej dhe A. Xhuvani theksojnë se kjo prapashtesë është më e përhapur në toskërishten lindore, si rrjedhim i burimit të saj nga bullgarishtja, dhe që ka hyrë në shqipe nëpërmjet fjalësh sllave, si: kastravec.<sup>231</sup>
- 11) Prapashtesa –ckë, më fort e përhapur në toskërishten lindore me funksion zvogëlues, në të folmen e Devollit gjendet te numërorë, si: njëckë, dyckë, treckë; në disa përemra e ndajfolje, si: cackë, këtuckë; në disa emra, si: gomarickë “mjet druri që shërben për të

<sup>228</sup> Po aty, f. 207.

<sup>229</sup> M. Domi, Prapashtesa ilire dhe shqipe përkime e paralelizma, Kuvendi i Studimeve Ilire II, 1965, f. 115.

<sup>230</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, Studime gjuhësore II, 1977, f. 210

<sup>231</sup> Po aty, f. 213. Në të folmen e Devollit, fjala kastravec përdoret rrallë, ajo ka sinonimin sallat/or (ku –or është me formant fjalëformues me burim nga shqipja).

vendosur drurin kur e sharrojmë apo govatën e larjes së rrobave”, morickë “mor i vogël, thrijë”, grafickë (variant me metatezë i karfic/kë) etj.

- 12) Me prapashtesën -çe janë formuar ndajfolje mënyre prej emrash, si: beraçe “lloj valleje”, birçe, derçe, frënçe/kë “pjesë e fundit e mëngës së këmishës në formë të rrudhosur”, fshaçe, hakçe, kaçakçe “lloj valleje”, kasapçe “lloj valleje”, por nuk mungojnë dhe emra të formuar me këtë prapashtesë nga tema emërore, si: amamçe, gjymçe, jorgançe, kërçe “kërriç”, apo nga tingullimitime, si: guguçe.
- 13) Me prapashtesën -çkë janë formuar emra me kuptim zvogëlues, përkëdhelës a keqësues, si: endeçkë, feçkë, floçkë “veshje sipërme e grave”, koriçkë, mastrapaçkë, plloçkë, tazeçkë etj. A. Xhuvani dhe E. Çabej theksojnë faktin që kjo prapashtesë përdoret më shumë në toskërishten verilindore (Devoll, Korçë), si një përngjitje e prapashtesave -ç dhe -kë, gjë që e vë në dukje dhe J. Gjinari.<sup>232</sup>
- 14) Me prapashtesën -ec/-eckë, ka pak fjalë me funksion keqësues, por më tepër përdoret për të shënuar lloje të diçkaje, si: gomareckë “lloj kumbllë me kokërr të madhe, të gjatë e të verdhë”, kopanec “mënyrë lidhjeje e foshnjës”, kukulec “grumbull, majë mali ose kodre” (nga kukul “vend i ngritur”), kumbulleckë “kumbull kokërrmadhe e gjatë dhe kuqe”, kungullec “që e ka kokën kungull, nuk merr vesh”, lëvreckë “krëhër për të krehur bashkat e leshit”, shtypec “druri që lidh reznishtën me shtratin e qerres”, Kjo prapashtesë, sipas Joklit e Mlladenovit, mbështetur dhe nga E. Çabej e A. Xhuvani, mendohet të ketë hyrë në shqipe nga bullgarishtja.<sup>233</sup>
- 15) Me prapashtesën -ell, në të folmen e Devollit gjenden pak emra që shënojnë vegla a sende përdorimi, si: kaptell “pjesa e përparme e samarit” (khs. lat. Caput; it. capitello), kapërçell, kërcell, çkërfyell “dikush a diçka shumë e gjatë” (nga fyell sipas ngjashmërisë).
- 16) Me prapashtesën -es formohen kryesisht emra nga tema foljore, si: lyes (variant dialektor i vles/mbles), mbulesë, shtresë etj.
- 17) Me prapashtesën -eshë janë formuar emra që shënojnë gruan a femrën përkundrejt mashkullit si profesion a bashkëshort, si: agdeshë “gruaja që përgatit agdën dhe nis nuse”, bejlereshë, prifteshë, Dineshë, Doneshë, Koleshë etj. Kjo prapashtesë gjendet e zgjeruar

<sup>232</sup> J. Gjinari, Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore, Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë 1972, f. 272.

<sup>233</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, “Studime gjuhësore III”, 1977, f. 220.

me prapashtesën zvgëluese –kë, si: arapeshkë, arixheshkë, kungulleshkë dhe mendohet të jetë refleksi i prapashtesës latine –issa.<sup>234</sup>

- 18) Prapashtesa -(ë)ri shërben për formimin e një numri emrash përmbledhës, si: djemuri, çupëria, graria, lyesëri, evgjitëri etj.
- 19) Prapashtesa -(ë)sirë shërben për të formuar emra nga tema mbiemërore a foljore me kuptim vendi ose me kuptim konkret a abstrakt, si: fellësirë (variant fonetik i thellësirë), kalbësirë, lagësirë, ngordhësirë, rafshëtirë etj.
- 20) Me prapashtesën -icë formohen emra femërorë nga tema emërore, si: arçicë/ashçicë “gruaja që gatuan gjellët në dasmë”, Çuklicë (toponim), enduricë “fije leshi që shërbejnë për të endur qilima”, katranicë “enë për të mbajtur katranin”, lidhuricë “mënyrë lidhjeje”, skobuznicë “lloj rrjete peshkimi që përdoret për të peshkuar skobuz”, telegjicë “grua që nis nusen në dasmë” (tema fjalëformuese tel), lugenicë “kuti druri ku vendosen lugët”, zhabicë “menteshe” etj. Gjithashtu formohen emra femërorë përkundrejt mashkullit apo emri i gruas si përkatësi ndaj bashkëshortit me emër të përveçëm, si: buallicë, gomaricë, Kiçovicë, Vasilicë etj. Ajo gjendet si formant dhe në disa emra vendesh, si: Sinicë, Kapështicë, Bradvicë, Nikolicë. Fjalët si: goricë, graficë (variant me metatezë i fjalës karficë), plevicë, ponicë, pllotnicë janë të huazuara nga sllavishtja<sup>235</sup>. Sipas J. Gjinarit kjo prapashtesë është karakteristikë vetëm për anët lindore të toskërishtes, e sidomos për Devollin<sup>236</sup>.
- 21) Me prapashtesën -içkë formohen emra nga tema emërore me funksion zvogëlues, si: guriçkë, koriçkë, turiçkë etj. dhe është një formant i përngjitur.
- 22) Në të folmen e Devollit, me prapashtesën -igë, ka shumë pak fjalë, si: shurigë “vend me rërë a zhavor”, shavarigë “vend ku rritet a ka grumbull shavari” (edhe si toponim), të cilat e kanë prejardhjen nga tema emërore dhe shënojnë vend me shumësi të sendeve të atij lloji.
- 23) Prapashtesa –im është mjaft e re. Kjo prapashtesë, nën ndikimin i gjuhës së shkruar, përdoret gjerësisht në formimin e emrave të veprimit nga foljet përkatëse. Kryesisht prej saj janë formuar emra veprimi nga tema foljore përkatëse, të cilat shënojnë procese pune

---

<sup>234</sup> Po aty, f. 226.

<sup>235</sup> Po aty, f. 237.

<sup>236</sup> J. Gjinari, Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë jugore, Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë 1972, f. 273.

në bujqësi, si: lërim, lesim, lëvrim, plerim, plugim etj., por dhe emra të tjerë veprimi nga foljet përkatëse, si: fërkim, fellim (thellim), tërbim etj.

- 24) Prapashtesa –inj ka funksion gramatikor për formimin e shumësit të disa emrave ku ndodh dhe dukuria e lëvizshmërisë fonetike e theksit, si: lëminj, drapinj, thelpinj, mullinj, lëmçinj, bashtinj etj. Jokli dhe Çimohovski e lidhin me prapashtesën ilire – inium<sup>237</sup>.
- 25) Prapashtesa –is merr pjesë në formimin e foljeve nga emra, si: ballajdis (ballajdi) “velem, më vjen për të vjellë”, buçkaris (buçkë) “fryhet diçka, enjtet”, cimbis (cimbi), dajandis (dajanda) “duroj, përballoj”, dërmonis (dërmon) “shosh grurin me dërmon”, katandis (katandi), konduris (kondur) “procesi i nxjerrjes së konurit nga trugu i prerë”, kuptis (kupë) “më vjen mirë, pëlqej”, teleis (tel) “nis nuse”, apo dhe nga tingullimitime, si: bubutis (bu-bu) “thërres kot, bëj bu-bu për çdo punë”, buis (bu-u-u) “derdh, i shpërthen gjak nga hundët”, çakllais (çak) “e luaj nga mendtë dikë”, cingaris (cër-cër) “skuq, fërgoj”, çokullis (çok) “mërzit dikë me fjalë”, tororis (to-ro-ro) “i këndoj fëmijës”, xhugulis (xhu-gu). Ky formant ka kaluar si prapashtesë prodhimtare për analogji me foljet kolis, kullandris, kandis me burim nga greqishtja.
- 26) Prapashtesa –iskë, si formant i përngjitur, gjendet te disa emërtime të përveçme të kafshëve, si: Baliskë, Lariskë, Muriskë etj.
- 27) Me prapashtesën –isht (ë) formohen emra që shënojnë vendin ku gjendet a rritet diçka, si: cingarishtë, elbishtë, fierishtë, gurishtë, hollovishtë “pjesë e liqenit e me gurë të vegjël për të zënë peshq me perzevul”, lajthishtë, misërishtë, plepishtë, plerishtë, etj.
- 28) Me prapashtesën –it formohen një sërë foljesh, si: çafkit “lëviz shumë, punon tërë ditën”, çapit, darovit “i jap një dhuratë dikujt”, gërgërit “zjen diçka ngadalë e për një kohë të gjatë, fig. mërzit dikë vazhdimisht”, grebashit “punoj me grebaskë”, kallauzit, kërmishtë “ha me copka të vogla”, kopaçit “thyej plisa në arë; shpyllëzoj; fig. lodhem shumë duke punuar”, kosorit “korr me kosor”, kuaçit “ndjell pulat”, kulit “përkëdhel, e marr me të mirë”, laryshit “bëj lara-lara”, lyspit “zhvesh kallinjtë e misrit”, qanit, qerosit “e zhvesh, i heq puplat a qimet”, tretit “bëj punimin e tretë të tokës”, troshit, etj. Kjo prapashtesë mund të jetë me burim nga greqishtja –ίτης<sup>238</sup>, kur përdoret për të treguar banorë të një vendi, si: ajnoritët “që vijnë nga Agion Oros, mal i shenjtë në Greqi”.

<sup>237</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, “Studime gjuhësore III”, 1977, f. 244-245.

<sup>238</sup> Po aty, f. 249

- 29) Me prapashtesën –je, më e vjetër se –im, (pavarësisht se në pjesën më të madhe kanë të njëjtin funksion), formohen emra veprimi nga pjesoret e foljeve, si: apje, ardhje hardhucë”, dredhje, këndje “fundi i dhomës”, krisje, qarje, rojtje, shkuarje, sosje, vajtje etj. Po ashtu, shërben për të formuar dhe emra të disa poceseve të punës në bujqësi e blegtori nga temat foljore përkatëse, si: luspitje, përskatje (variant me metatezë i spërkatje), grebashitje, krastitje, mjelje, vaditje etj. Ndërkaq, ka emra topikë të cilët janë formuar nga ndajfolje, si: Tërthorje (Vranisht). Mesa duket, duhet të jetë një prapashtesë e vjetër nga trajta –lë e toskërishtes jugore me të njëjtin funksion të sotëm<sup>239</sup>.
- 30) Në të folmen e Devollit prapashtesa -kë është nga më prodhimtaret. Ajo shërben për të formuar: 1. emra zvogëlues femërorë nga tema emërore, si: copkë, çulkë, dromkë “lloj gatese si makarona të vogla”, çupkë, dackë, dremkë, eqka (heqka) “lepitka, shapka”, eshkë, gllomkë “gropa e fytit”, gojkë, gruçkë “top i vogël balte që përpunohet për enë balte”, kërcaçkë, kërkë, kllëngjkë “vezë që lihet në furrik për të nxjerrë zogj”, krepallkë, lopkë, lotkë, lulkë, myshqerkë, trirkë “derë e vogël me shkopinj”, vastangarkë, xipkë “thumb i hostenit”, zhapkë etj. 2. emra hipokoristikë grash dhe burrash, si: Dhorkë, Liskë, Marikë, Mitkë, Vaskë, etj. 3. emra që tregojnë profesion a gjendje, si: evgjitkë, fshatarkë, shosharkë etj. ku hyjnë dhe disa emra kafshësh, si: mackë, pulkë, sorkë, shqerkë, viçkë etj. Në shumicën e rasteve ajo del si bashkim me prapashtesa të tjera. Është një nga prapashtesat më prodhimtare në toskërishten lindore dhe gegërishten lindore, sidomos me funksion zvogëlues.
- 31) Me prapashtesën – li formohen një sërë emrash me kuptim pozitiv a negativ, kryesisht nga tema emërore me burim nga turqishtja, si: airli, borçli, sojli etj.
- 32) Prapashtesa – llari gjendet si formant fjalëformues në emra që tregojnë pjestarë të një fisi nga patronimet përkatëse, si: Kambollarët, Maçëllarët, Xhemollarët etj.
- 33) Prapashtesa turke –llëk përdoret për të formuar fjalë me kuptim konkret, si: arallëk, kallaballëk, apo dhe me kuptim abstrakt, si: budallallëk, gomarllëk, jagallëk “mot me lagështirë”, kurakllëk “mot i thatë, pa rreshje”, nikoqirllëk, qyqllëk “mot i vrenjtur e i nxehtë, zagushi”, zadullëk “zagushi, vapë e madhe” etj. Kjo prapashtesë ka hyrë bashkë me fjalët turke përkatëse dhe është bërë prodhimtare edhe me tema nga shqipja.

<sup>239</sup> Këtë argumentim e kanë bërë Pedersen dhe Jokli. Po ashtu, kjo prapashtesë gjendet dhe në disa autorë të vjetër të Jugut, si: Kavalioti e Grigor Gjirokastriti në trajtën –jë. (Po aty, f. 250).

- 34) Prapashtesa –lli u ngjitet temave të huazura nga turqishtja për të formuar mbiemra të panyjshëm, si: bojalli, kimetlli, nishanlli, sevdalli, si dhe për disa emra banorësh të një fshati apo pjestarësh të një fisi, si: bickalli, poloskalli, Buzollinj, Canollinj, Hyskallinj, (emrat që tregojnë fiset pëdoren vetëm në numrin shumës, prandaj kanë dhe prapashtesën trajtëformuese të shumësit – nj).
- 35) Prapashtesa –m(ë) në krahinën e Devollit shërben kryesisht në formimin e mbiemrave nga emra, si: i fismë, i sojmë dhe sidomos prej ndajfoljesh, si: i aerçmë, i andejmë, i jashtëm, i pastajmë, i sivjemë i sotmë, i tashishmë. Ajo quhet si një prapashtesë me burim vendës, si refleksi prapashtesës indoevropiane –mo.<sup>240</sup>
- 36) Me prapashtesën -nik gjenden një sërë emrash që shënojnë gatime të ndryshme (kryesisht brumi), si: fasulnik, gjalpanik, gjizanik, groshanik, kokoshnik, kripanik, krundanik, kulloshtanik, kungullnik, llallanik, palanik, petanik, vezanik, etj., e cila në shumë raste kanë një a protetike. Po ashtu, kjo prapashtesë shërben për të formuar emra sendesh që mbajnë diçka, si: çajnik, lisnik “mullar me degë lisi”, vajnik. Është një prapashtesë me burim sllav, që gjendet dhe në disa toponime, si: Trestenik, Eçmenik, të cilat e kanë këtë formant prapashtesor nga gjuha që janë huazuar.
- 37) Prapashtesa –o u ngjitet emrave të përgjithshëm a të përveçëm grash a burrash kur përdoren si thirrorë, si: nëno, hallo, xhaxho, Miço, Kiço, Bardho, si dhe disa e mbiemrave të emëruar që shënojnë të meta fizike, si: buçko, bythko, çeço, cmingo “i vogël, i dobët”, fëndo “që ka frikë”, grënxho “i plakur”, kllëngjo “njeri i butë, i pazoti, që sëmuret shpesh”, kurisko, leshko, murxho “që rri gjithmonë i mërziur e buzëvarur”, pordho, shpirto etj. Në thelb, kjo prapashtesë duhet të jetë mbetje e mbaresës së rasës thirrore që gjendet shpesh në poezinë popullore.
- 38) Prapashtesa –ojcë shërben për formimin e emrave të përkatësisë së gruas kundrejt bashkëshortit, si: Gaqojcë, Kiçojcë, Mitojcë, Petrojcë, Sofojcë, por është dukuri shumë e kufizuar (emra të këtij tipi gjenden vetëm në fshatin Dardhë).
- 39) Me prapashtesën -ok ka pak emra të formuar nga tema emërore a mbiemërore, si: bardhok, becok “dashi larmë”, çapok, çepirok “njësi matëse duke shtrirë gishtin e madh e atë

<sup>240</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, Studime gjuhësore III, 1977, f. 256.



tregues”, misrok, rinok etj. Kjo prapashtesë gjendet në disa gjuhë ballkanike (shqip, rumanisht e bullgarisht me etimologji të ndryshme në secilën prej tyre)<sup>241</sup>.

- 40) Prapashtesa –omë haset në fjalë, si: firomë (frymë), mballomë, steromë, vromë “e pistë, e keqe”, dhe e ka burimin nga greqishtja e re –*ομα*<sup>242</sup>.
- 41) Prapashtesa –or/-tor është një nga prapashtesat më prodhimtare. Me të formohen disa emra gatimesh nga tema emërore (që tregojnë përbërësit kryesorë të tyre), si: lakror, qumështor, sallator. Po ashtu, shërben për të formuar emra që lidhen me tregues etnografikë të krahinës, si: javëtor “njerëzit e nuses që bujtin në shtëpinë e të shoqit javën e parë të martesës”, sinitor “ata që shpien rrobat e nuses në dasmë”.
- 42) Prapashtesa –os, me burim nga greqishtja<sup>243</sup>, është bërë mjaft prodhimtare me tema të burimeve të tjera dhe shërben kryesisht për të formuar folje, si: farmakos, astretos(em)“përgjërohem”, azëros “bëj gati”, bukos “ia mbush gojën plot”, çibllor “fle”, ciknos, çuknos, faros, fingjillo, kaparos, kromos “bëj pis”, kuptos “puthis”, lipistros “bëj pis, bëhet lipistri”, mallos, stapinjor “rri drejt e i ngurosur”, tartaros “ngrin”, trokos “e djeg a e thaj diçka” etj.
- 43) Me prapashtesën –ore formohen emra që shënojnë një vegël, një enë a send konkret, si: balgore “hambar me baltë e bajga lope ku mbahej grurui a misri”, faqore, kashtore, kuptore “havan balte”, verore “thurje fijesh të kuqe e të bardha që vihet në dorë për ditën e verës”, ndërsa emri kafshore (dhe varianti kapshore) vjen nga folja kafshoj.
- 44) Prapashtesat –ushkë dhe -oshkë janë prapashtesa sinonime që paparaqiten si variante të përngjitura me kuptim zvogëlues, si: ardhushkë “hardhucë e vogël”, arnushkë, bibilushkë, kadushkë, kajkushkë “lloj dardhe e vogël e rrumbullakët, e ëmbël vjeshtake”, larushkë, lavrushkë “e shkathët, e shpejtë”, mangjushkë “mangall”, vetullushkë // avullloshe/kë “që avullon, e porsa pjekur”, çaparoshkë “mjet për matjen e tokës”, latoshkë, qeleposhe “lloj kapelej që e mbanin gratë” etj.
- 45) Me prapashtesën –ovinë janë formuar pak emra femërorë që kanë kuptim abstrakt ose që shënojnë vendin ku ka një shumësi sendesh a sasi të një lënde, si: baltovinë, barovinë, batakovinë, djalovinë, gjatovinë, gjërkovina “tërësi gjërash që gjenden në një vend”,

<sup>241</sup> R. Bello, Gjedhi diminutiv me sufiks-in-ok në gjuhët ballkanike, Buletin Shkencor i UK, nr. 4, 2002, f. 38.

<sup>242</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, Studime gjuhësore III, 1977, f. 262.

<sup>243</sup> A. Xhuvani dhe E. Çabej i referohen Mikloshiçit, që e ka parë këtë prapashtesë me burim nga prapashtesa –*ώσα* e greqishtes (“Prapashtesat në gjuhën shqipe”, Studime gjuhësore III, 1977, f. 267).

gjingjrovinë “mot i nxehtë me re të holla”, krëndovina “shkarpa të holla për të ndezur zjarr”, rrënjovinë, tavovina, zhigrovinë “vend me shkurre e ferra të larta”, etj. Kjo prapashtesë e burimit sllav është mjaft e kufizuar në toskërishten lindore, ku bën pjesë e folmja e Devollit.<sup>244</sup>

- 46) Prapashtesa –sëz, me kuptim keqësues, u ngjitet kryesisht temave të huazuara nga turqishja, si: airsëz, biçimsëz, dinsëz, sojsëz, vaksëz, po dhe temave të tjera, si: propkopisëz.
- 47) Prapashtesa –uckë përdoret me kuptim zvogëlues dhe gjendet në pak fjalë të prejardhura nga tema emërore, si: *balguckë* “kakërdhi”, *derkuckë*, *gërdhuckë* “e vogël, e parritur”, *majuckë* etj.
- 48) Prapashtesa –ush/ushkë/uç (si variant me afrikim i prapashtesës-ush) gjendet kryesisht në fjalë me kuptim zvogëlues, si: arë-arushkë, demush- demuç, derë-derush/kë etj.
- 49) Prapashtesa –ulkë, me kuptim zvogëlues e përkëdhelës, u ngjitet kryesisht temave emërore, si: baculkë, bishtulkë, bixhulkë, çezmulkë, ciculkë, gjoksulkë, perdhulkë etj.
- 50) Me prapashtesën –vit formohen folje nga tema emërore, si: branovit, babovit, çuknavit “nga çok, bie me çok”, garravit “zvarrit një punë”, apo nga tema foljore, si: çelevit (çel) “e mori veten”, lagavit (lag), ngjallavit (ngjall) etj.
- 51) Prapashtesa –xhi, me burim nga turqishtja, shërben për të formuar emra nga tema emërore që shënojnë profesion, si: dyqanxhi, gajdexhi, qilarxhi, a cilësi, si: aengxhi, çapërçhi, qelepërçhi, qylaxhi etj.
- 52) Prapashtesa –z/-zë është më e kufizuar në përdorim në raport me të folmet perëndimore të toskërishtes veriore. Ajo shërben si prapashtesë zvogëluese përkëdhelëse në pak emra, si: farëzë, ftujkëz, korbëzë, lulëz, mjaltëz, si dhe në disa mikrotoponime, si: Fushëzë, Gurëzë, Shkallëzë dhe është shtrirë më tepër në me funksion zvogëlues në ndajfolje e numërorë që shpesh gjenden me dy forma, si: cackë-cazë, këteckë- këtezë, njëckë- njëzë, dyckë-dyzë etj.

Këto janë ndjashtesat më prodhimtare në të folmen e Devollit, një pjesë prej të cilave hasen vetëm këtu. Por në këtë të folme gjenden dhe ndajshitesa të mbarë shqipes, që dallojnë nga të folmet e tjera kryesisht nga trajta fonetike.

---

<sup>244</sup> Po aty, f. 270. J. Gjinari, Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore, Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë 1972, f. 273.

### 5.2.3 Kompozimi dhe përngjitja

#### Kompozimi

Në të folmen e Devollit kompozitat përbëjnë një shtresë të gjerë të fjalëve që përdoren në leksikun e përditshëm. Kompozitat janë përdorur gjerësisht edhe në këngët popullore të kësaj të folmeje, çka tregon burimin e shumë fjalëve në ligjërimin popullor, e njëherazi, burimin dialektor a krahinor të këtyre fjalëve. Fakti që të folmet fshatare janë bazë e ligjëtimeve dialektore për shkak të ruajtjes pak a shumë të popullsisë dhe zhvillimit të zejeve kryesore familjare, krijon mundësinë që në këto të folme të kemi dhe larmi fjalësh dhe fjalëformimesh, të cilat, më shumë se kudo morën udhë fillimisht në krijimet popullore. Kështu, në të folmen e Devollit, gjenden dhe përdoren kompozita, të cilat mund të klasifikohen në:

- 1) Kompozita me ngjyime stilistike për të shënuar cilësi fizike emrave të frymorëve. Përgjithësisht ato janë kompozita përcaktore me strukturë emër+mbiemër, si: balukeprerat, leshpërdredhur, luleverdhë, mëngëgjëra, mjekërzinë, mustaqeverdhë, syzezën, etj., dhe më pak me strukturë ndërtimore emër+emër, si: bajamsheqer, buzëkarafilit, eqimbash, gojëmjaltë, gurmermer<sup>245</sup>, gurmuhyr, gushëlejmuva, leshkakurorë, nuselule, qafëgjymë<sup>246</sup>, rrethunaza, veshkëlyshe, vetullgaze etj.
- 2) Në grupin e dytë hyjnë ato kompozita që përdoren në leksikun e përditshëm të së folmes për të shënuar sende a frymorë. Këto tipe kompozitash nuk funksionojnë më si pjesë e leksikut poetik të folklorit, pra të krijuara aty për aty me efekte stilistike të caktuara, por kanë fituar statusin e fjalëve me kuptim të drejtpërdrejtë që shënojnë realie konkrete dhe abstrakte. Një pjesë e tyre ruajnë ende një pjesë të ngjyimit të figurshëm, por në bazë të tropeve gjuhësore nga janë krijuar, këto kompozita sillen si njësi të leksikalizuara plotësisht. Kjo dukuri dallohet sidomos te kompozitat që shënojnë emërtime kafshësh ose bimësh, si: babagjel “xixëllonjë”, dosëbalë “1.baldosë, 2.rrip lëkure me lara që vihej si zbukurim në ballin e kuajve”, kakërdhi, kazil “ka i zi”, kromobythkë “frutat e trëndafilit të egër” (variant kyrymbythkë, kyrymbyllica), parashkëndi “xixëllonjë”, qimegjallë “lloj krimbi uji sa një fije floku”, thundërmushkë “lloj bime mjekësore”, zhabëkuacë “lloj bretkoce me trup të madh, që nuk rri në ujë”.

<sup>245</sup> Këngë popullore të rrethit të Korçës, Tiranë, 1982.

<sup>246</sup> K. Zdruli, Folklor nga Devolli i Sipërm, Tiranë, 1987.

Kompozita përbëjnë dhe disa fjalë që shënojnë realie konkrete apo abstrakte, si: babamall “malli trashëguar nga babai”, bishtagjel “lloj loje për fëmijë”, çupadjalë “koskë në formë V-je e gjoksit të pulës”; te disa fjalë që shënojnë emra farefisnie në shenjë respekti, si: agabe, xhabe; disa eufemizma me vlerë emërore, si: gojëqepuri “gjarpri”, dambllamadhi “i vdekuri”, dixiu/dixif “ditëziu, i shkreti”

- 3) Disa kompozita janë formuar për të shënuar cilësi fizike apo të karakterit, nofka dhe kanë në bazë të tyre tema që shënojnë pjesë të trupit dhe tema emërore që shënojnë vegla pune të cilat dallohen nga përbërja, fortësia, qëndrueshmëria apo forma e veçantë. Këto kompozita përdoren me vlerë mbiemërore, si: barkder, barkstumbë, bollkëgrisur, bollkërënë, byshkëdere, byshkëkosh, dobromir “që nuk prish qejf me asnjë”, faqedollmë, hundëlesh, këmbëzheglinë “me këmbë të shtrembra, në formë o-je”, këmboreshkë “me këmb të holla”, kokëder, kokëgllavinë “i trashë, kokëfortë”, kokëmollçinë “që e ka kokën të vogël e të rrumbullakët”, kokësandraç, kokëshepinë “që e ka kokën të gjatë e me majë”, kokëshikëll, leshlëshuar, leshpalarë, leshpërgë “me flokë të rrallë e si të djegur”, leshpërlë, leshrapaka, leshrënë, mëndjellarëskë, pendëlloškë, shermullagë “që është gati për të nisur një sherr në çdo kohë”, sybutë “me temperament të qetë, që nuk kundërshton e rebelohet”, turiulluveqkë, vetullçapar etj.

### **Përngjitja**

- 1) Në shtresën e fjalëve të përngjitura hyjnë kryesisht fjalët shërbyese, si lidhëza: qynqë “meqënëse”, madam “meqënëse”, dykmeqënë “meqënëse”<sup>247</sup>; pjesëza: ndoshta-ndofta, sindozot “si, e ngjashme me”; parafjalë: batanë, dëpër; pasthirrma: miserdhe, punambarë etj.
- 2) Megjithatë, në këtë të folme ka formime të përngjitura dhe në pak fjalë shënuese, si emra: gjeder (gjë e derit), shtyrlish “lloj-lloj”, inandi “besë, besim”; mbiemra, si: allasoj “i çuditshëm”, shojsjojodole “i raskapitur, i cfilitur”, allallexhan; ndajfolje, si: batanë, datëpjetë (tatëpjetë), përmatanë, ngajdo, ngaera, menatë qëmenatë, aerë/atfernaj/ahernaj, namëta “në atë çast”, ndajnatë, ngaditë, njëdizë, njënazaj, qëmoti,

<sup>247</sup> Përdorimi i trajtës së veçantë të përcjellores të trajtuar në sythin 4.4.2 të këtij punimi ka sjellë këtë formë të përngjitur që përdoret si lidhëzë nënrenditëse shkakore.

njëlotkë “shumë pak”, kalikiç “mënyrë e mbajtjes së fëmijëve në qafë”, paraqende “shkel e shko”; përemra, si: xhanxhin “askush, asnjëri”, gjëkafshë, gjësendi, ndoca, njadyckë etj.

- 3) Disa prej këtyre fjalëve janë formuar nga përngjitja e dy gjymtyrëve me kuptim të plotë leksikor, si: gjësendi, gjëkafshë, gjeder (gjë e derit), inandi (iman dhe din), etj.
- 4) Pjesa më e madhe e këtyre fjalëve janë formuar si rrjedhim i elizionit në togjet parafjalë+emër, si: batane (bë atë anë), përmatanë (për më atë anë), ngajdo (ngaj do), ngaera, paraqende, menatë/që menatë etj. Po ashtu, janë formuar fjalë të përngjitura dhe nga ngjitja e togjeve të tjera (përemër+emër; pjesëz + emër), si: ndoshta-ndofta, aerë/atfernej, miserdhe, qynqë, madam, dykmeqënë (duke me qenë)<sup>248</sup> etj.

### 5.3 Frazologjia e të folmes së Devollit

Frazologjia e gjuhës shqipe është një pasuri e madhe mjetesh emërtuese dhe shprehëse në etapa historike të ndryshme dhe në stile të ndryshme. Shumë njësi frazeologjike shprehin nocione e realie që nuk kanë emërtim tjetër, përmbajnë nuanca të veçanta kuptimore emocionuese që nuk i kanë përgjegjëset e tyre sinonimike, njësitë njëfjalëshe.<sup>249</sup>

Njësitë frazeologjike mund të identifikohen në rrjedhën e ligjërimit e të veçohen, sikundër dhe fjala. Megjithë tiparet e veçanta të formimit dhe të përdorimit, frazeologjia ka rregullsi të brendshme, lëvizje të ndryshme tipologjike, shtresime hiponimike. Nga vetë natyra, frazeologjia gjuhësore nuk mund të trajtohet jashtë lidhjeve me kategoritë leksikore e gramatikore, jashtë dukurive të zhvillimit semantik të mjeteve gjuhësore e sidomos jashtë ligjërimit të gjallë.<sup>250</sup>

Gjithashtu, në lëndën frazeologjike gjejmë jo thjesht dëshmi të gjendjes së hershme të dialektit a të folmes së një krahine, por dhe dëshmi të mendësisë, kulturës, mënyrës së jetesës të banorëve të saj.

E folmja e Devollit është një mjaft e pasur me njësi frazeologjike. Këto shprehje lidhen ngushtë me jetën ekonomike dhe shoqërore të krahinës. Një pjesë e madhe e këtyre shprehjeve

---

<sup>248</sup> Është një formë e përngjitur e veçantë që ka në thelb përdorimin e formës së veçantë të përcjellores të trajtuar në sythin 4.4.2 të këtij punimi.

<sup>249</sup> J. Thomaj, Çështje të frazeologjisë shqipe, në Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972, f. 382.

<sup>250</sup> J. Thomaj, Frazologjia e gjuhës shqipe, në Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, Shkenca, Tiranë, 1999, f. 9.

kanë gjetur vend në gjuhën letrare kombëtare shqipe, edhe në veprat e shkrimtarëve me prejardhje nga Devolli, si D. Agolli, T. Laço, S. Andoni etj.

Frazeologjia është një nga elementët më të rëndësishëm që përcaktojnë tiparet e një gjuhë dhe ruajnë më gjatë gjurmët e mëvetësisë e të traditës.<sup>251</sup>

Forma e brendshme e këtyre njësive lidhet më së shumti me jetën shoqërore, me zakonet, doket, me mendësinë e njerëzve, me mënyrën e jetesës etj. Si rrjedhim, nëpërmjet frazeologjisë, mund të shqyrtohen shumë karakteristika të kësaj apo asaj krahine, ngaqë visari frazeologjik i një krahine, megjithë ndërthurjen që ka me frazeologjinë e gjuhës letrare shqipe, mund të kundrohët dhe nga pikëpamja e “formës së brendshme”. Kështu, përmes saj mund të përshenjen shumë pamje të botës krahinore. Kjo formë e brendshme sendërtohet në gjymtyrët përbërëse të njësive frazeologjike që lidhen ngushtësisht me histori, personazhe, vende që përfaqësojnë krahinën, me fjalë karakteristike të krahinës që lidhen ngushtë me mjetet, zejet, banesën dhe përbërësit e saj, me tradita, rite, po ashtu dhe me përdorimin e trajtave fonetike e morfologjike të hershme të fjalëve që gjallojnë dhe sot në të folmen e krahinës.

Duke u mbështetur në materialin frazeologjik që kemi mbledhur e vjelë nga vepra të ndryshme mund të bëhet klasifikimi i mëposhtëm:

1) Nga pikëpamja e gjymtyrëve përbërëse të këtyre njësive dallojmë:

- **Njësi frazeologjike që kanë përbërje të tyre gjymtyrë të shprehura me toponime dhe mikrotoponime krahinore.** Ka të tilla që hyjnë në visarin frazeologjik të mbarë shqipes duke lënë vulën e tyre krahinore, si: për një kockë gjer Poloskë, por një pjesë e madhe e tyre përdoren brenda krahinës dhe rreth saj, si: i ka mëntë majë Ivanit “është i lehtë nga mendja, i papjekur”; (mbaet) si mëllenja në majë të Krastës “kapardiset shumë”; (është bërë) si damazi i Rakickës “mendjemadh”; u mbyt Rakicka “nuk ndodh kurrë, asnjëherë”; akoma dë lakrat e Cangonjit “që nuk di gjë për një problem, që nuk e di si ka ndodhur”; *s’do pragu dhi, do nuse pe Treni* “duhet punë dhe jo gjëra të kota”; (flet) si hoxha i Bickës “flet gjepura, flet kot”; (bën) prëska me ujë Todoreci “bën gjëra të kota”; e vrau Muken e Stropanit “nuk punon fare, është dembel”; sikur je pe Otojake “nuk di gjë, nuk kupton”; na i kthen dhentë mbi Bickë “mburret kot”; *do t’ja dijë Ivani ce bie dëborë*

---

<sup>251</sup> J. Thomaj, Xh. Lloshi, Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë, 1972, f. 223.

“është i zoti, që nuk pyet për fjalët e të tjerëve”; pyet Vranishti për Bickë “është i pari, nuk do t’ia dijë për të tjerë”; doli Borshi bi Poloskë “është mendjemadh, shet mend” etj.

- **Njësi frazeologjike të cilat kanë si gjymtyrë emra njerëzish që janë përdorur ose përdoren në krahinën e Devollit.** Një pjesë e tyre janë të mbarë gjuhës, si: (u zunë) për mustaqet e Çelos “kot”; si Kolja me Deden “bashkë, të pandarë”, por shumica e tyre dallohen si “devollite” qoftë nga trajtat fonetike e antroponimeve (Cankë, Ximkë, Kole, Hysenkë), qoftë nga gjymtyrët e tjera përbërëse që lidhen me Devollin (emrat e fshatrave që tregojnë vendbanimin e dikujt që përmendet në njësi, p.sh. si Hysenka Trenit), qoftë edhe nga fjalë, të cilat janë karakteristike për të folmen e Devollit, si: ledhi, revani, opingë, lëmë, dem, lakra, leshtë, djathnë etj., si: *s’e ha Canka revaninë* “bën sikur s’e pëlqen diçka”; (është) lagu Kole të të ruaj “diçka pa shije, shumë e lëngshme”; *s’pyet Muçoja për gjela deti* “hiqet bujar, nuk ka frikë nga shpenzimet”; *ku këput ai s’e ngjit as Ramo kovaçi* “merret me thashetheme, u prish punë të tjerëve”; është si lopa e Sheqeres “i padurueshëm, fut hundët kudo”; ia bëri kufirin (sinorë) de ledhi i Tasit “e qortoi, nuk e la të bënte si të donte”; si qeni i Ramços “pa vlerë, i plakur”; de lëmi i Telos prapë do të vish “do të shihemi përsëri, nuk ke ku të vesh”; kush të pyet për Sali bejnë “i thuhet dikujt që hiqet kapadai, që nuk pyet për të tjerët”; i dha opingat e Sherros “nuk i dha asgjë”; mbjell Zaloja, korr Maloja “punën e bën dikush, por një tjetër korr frutet e saj”; e kërkon Zeqoja dhinë “bën një punë me vonesë, jo në kohën e duhur”; si Ximka me Nadirenë “bashkë, të pandarë”; *s’punoj për Beqirë e Lazes* “Nuk punoj kot, nuk punoj për të tjerët”; shtrihet si demi i Zalos “nuk punon, është dembel”; kur të shijë Ajdini urovë “kurrë, asnjëherë”; e hëngri djathnë e Koles “vdiq”; hesapi i Zylalit sa lakra i vë kalit “nuk të duhet gjë ty, secili e di punën e vet”; si bën krraba Mihalit “nuk është më i zot”; (mbeti) si Kasua të vreshtët “i trembur, i pafajshëm”; mori leshtë e Curres “nuk mori asgjë”; e bëri si Demir efendiu “shpenzoi shumë, pa hesap”; *ç’bën moj Shaqe, përvëlaqe* “thuhet për dikë që punon kot, kalon kohën pa punë të dobishme”; je bërë si Abedini i Shagut “thuhet për dikë që është i prapë, ters” etj.
- Njësi frazeologjike që kanë si gjymtyrë **emra që kanë kuptim të përgjithshëm karakteristike për të folmen e Devollit**, p.sh., njësitë për matjen e masave të drithit apo

prodhimeve të tjera, si: tagar, shinik, gobellë, killë, kandar, okë, torbë, thes etj. Të tilla janë: e bëri tagar “e rrahu keq”; e kam kokën tagar “jam në telash të madh”; u bë tagarçik “u shëndosh e u mbush në fytyrë”; (ha) si derat në gobellë “thuhet për dikë që ha pa kujdes, me nxitim”; foli hak kandar “foli pak, po mirë e drejt”; aq i peshon kandari “nuk ka mend, aq ia pret”; ia bëri killë “e priti me gjithë të mirat”; unë qaj një torbë, ti po më qan një thes “ankohet më tepër sesa duhet”; erdhi me torbë, iku me thes “doli me fitime”; e ka bë okët “e solli në barazpeshë” etj.

- Një pjesë e njësive frazeologjike lidhen me **dukuritë atmosferike**, të cilat kanë qenë dhe janë përcaktuese për jetën agrare të devollit, si: është si shi behari “nxehet shpejt”; bie dëborë me sitën e mirë “bie borë shumë e imët”; është si dëborë prilli “nxehet shpejt dhe i del inati shpejt”; u shkri si dëborë në prill “u zhduk shpejt sa hap e mbyll sytë”; kur të zërë dëborë krimba “kurrë, asnjëherë”; ra dëborë, mbuloi gjurmët “kaloi koha dhe u harrua çdo gjë”; *dëborë s’dimëron në qiell* “do ketë dimër të madh”; të kam parë dhe në behar o dhëndër “thuhet për dikë që përpiket të mbulojë një të metë a dobësi”; si dielli pas qindie “tepër vonë, atëherë kur nuk duhet më” etj.

- 2) Në të folmen e Devollit, mjaft njësi frazeologjike lidhen me **tradita dhe rite fetare a pagane, me figurat e klerikëve, me vende të shenjta e mitologjinë** që kanë të bëjnë me mendësinë, kulturën shpirtërore dhe materiale, me besimet, duke sendërtuar, nëpërmjet frazeologjisë, elementë të këtyre besimeve në tipare të njerëzve. Të tilla janë: është bërë si dhjak “është bërë i paqethur, i parruar”; *s’u prish fshati për një prift* “thuhet për dikë a për diçka pa vlerë që s’prish punë kur na mungon”; e bëri si prifti hostenë “e prishi diçka, e prishi punën fare”; del si prifti me kusiçkë “thuhet për dikë që është mësuar vetëm të lypë e të kërkojë nga të tjerët”; gjeti shtëpinë e priftit “u mësua keq, kërkon gjithmonë të përfitojë”; (flet) si hoxha i Bickës “flet gjepura, flet kot”; *kur s’e ke zanat, mos dil hoxhë në fshat* “mos u mburr kot me diçka që nuk e di a nuk e zotëron si aftësi”; *s’është kësmet të hajë dervishi* ljepur “është e pamundur të ndodhë a të kryhet diçka”; sikur ha në vakëf “shumë i dobët”; sikur u jep ujë të vdekurve “shumë i dobët, për të ardhur keq”; gjeti kishë të falet “nuk di a nuk është i zoti të zgjedhë njeriun e duhur për të gjetur përkrahje”; përmjer dë derë të xhamisë “bën a thotë gjëra të rrezikshme”; *s’të jep*



as gjynahet “është shumë dorështrënguar”; rri që rri bëj një hajmali “i thuhet dikujt që rri kot pa punë”; ndez kandilin pa zënë nata “ është njeri i rregullt, që merr masat në kohën e duhur”; *s’ të lë derri të bësh pashkë* “prish punë, është ngatërrestar”; ia ndez kandilin “është duke vdekur”; vuri kambanën “vuri tellallin, e përfoli diçka me shumë njerëz”; e ka zërin këmbanë “ka zë të fortë e të vrazhdë”; *s’bën vezë të kuqe* “nuk është kaq i mirë sa ta trajtojmë në mënyrë të veçantë”; (hëngri)ç’*ha dullja për Ramazan* “e rrahën shumë”; (rri) si Arifegjyni para Bajramit “thuhet për dikë që i jep rëndësi vetes më shumë se ç’duhet”; është lindur ditën e Xhumasë “është njeri me fat”; të lidhça buzën me shami mallk. “vdeksh”; i bëj duva “i lutem, i përgjërohëm dikujt”; mbi daulla një zurna (karadyzen) “thuhet kur fillon një punë pa mbaruar të tjerat ose që nuk vlen para tyre”; ta thëntë prifti (hoxha) prapa veshit mallk. “vdeksh”; të zënça për peri mallk. “vdeksh”; sikur ia ha lugati dë bark “thuhet për një fëmijë, që edhe pse ushqehet mirë, është i dobët e shëndetlig”; ngrihet si lugati “ngrihet herët në mëngjes”; u zhduk si flaka e lugatit “u zhduk shumë shpejt”; e ka frikë si lugati dritën “është shumë frikacak”; doli si shejtani nga temjani “doli papritur e pakujtuar”; di dhe shejtanë ku rri “di shumë gjëra të fshehta”; është si shejtani i përroit “është shumë i djallëzuar dhe zemërlig”; shejtani as kor, as kopaçit “njeriu i keq s’bën kurrë punë të dobishme”; u djegsh lugat mallk. “vdeksh e u zhduksh”; atje i qoftë “thuhet për dikë që i ka ndodhur një fatkeqësi”; sikur të më ngjallet babaj “në asnjë mënyrë”; vajti në xhenem të gomerëve “iku e s’u kthye më, mbaroi me turp” etj.;

- 3) Disa njësi frazeologjike të pamotivueshme e kanë burimin nga **historitë, anekdotat apo ngjarjeve të tjera nga krijimtaria gojore popullore e krahinës**, si: e kërkon si Zeqoja dhinë (dikush) “iu hyri telasheve”; *s’pyet Muçua* për gjela deti “është i fortë, i pasur, s’i bën përshtypje”; kur të shijë Ajdini urovë “kurrë, asnjëherë”; *s’e ha Canka* (hoxha) revaninë “bën sikur nuk i pëlqen diçka”; e bëri si Demir efendiu “shpenzoi shumë”; e bëri si prifti hostenë “e prishi punën fare”; badjava peshqit me mjell iron. “thuhet për diçka që është shumë e shtrenjtë për cilësinë që ka” etj.

4) Shumë prej njësive frazeologjike lidhen ngushtë me **zeje e punë karakteristike të krahinës**. Ato i përkasin sferës së bujqësisë, blegtorisë, artizanatit etj. Këto njësi mund t'i klasifikonim:

- **Njësi frazeologjike që lidhen bimë bujqësore, procese pune në bujqësi, almise etj.** Këto njësi janë më të shumta në numër, sepse krahina e Devollit dallohet për një traditë të lashtë të punëve në bujqësi, si dhe për një mendësi të lidhur fort me tokën dhe punën me të. Kështu mund të përmenden: u bëfsh si ara me grurë urim. “paç shumë fëmijë”; ara e mirë nuk mban gjemba “thuhet për dikë që është i ndershëm nuk i duron padrejtësitë”; ara e mban farën “thuhet kur gjatë punës diçka mund të shkojë dëm”; e ka lëshuar ujin në arë “i ka marrë masat e duhura, e ka vënë punën në vijë”; i bën të lara nëpër ara “flet si t'i vijë për mbarë, shpif e trillon”; i mbeti opinga në arë “nuk ia arriti qëllimit”; pyet ara me thekrë ce bëjnë *fëmija pizga* “nuk pyet për shpenzime, i përballon të gjitha”; ndrit si bari me vesë “është shumë i pastër në trup e veshje”; e la si deng me bar “e la palëvizur”; siç ha barin, çan ugarin “është i mirë dhe i ndershëm”; e ngul gjilpërën në qesen me bar “punon kot, bën punë pa vlerë”; mbeti si beli dë gurt “mbeti pa rrugëdalje, nuk e kryen dot diçka”; pret bostan dhe ha pjeprë “është hutaq i madh, flet përçart”; ta ngresh në bostan, tremb gogoçët tall. “thuhet për dikë që është i veshur keq e pa shije”; gogol bostani tall. “njeri qesharak, dordolec”; e do si drithin në lëmë “e ka shumë për zemër, e do shumë”; to të futë draprin dë thest “përpiqet më kot të mbulojë a të fshehë diçka që s'mund të fshihet”; ua fsheh drapinjte argatëve “u nxjerr pengesa në punë të tjerëve”; është si grurë rapcall “thuhet për një fëmijë të shëndetshëm e të bukur”; është bërë si grurë i zjerë keq. “është fryrë e enjtur në fytyrë; është si grurë ugarin “është punëtor, i zoti dhe kokulur”; *kur kishte grurë fukarai, s'punonte mulliri* “nuk i ka ecur në jetë, s'ka patur fat”; lë grurin dhe merr egjërën “thuhet për dikë që nuk di të vlerësojë të mirën dhe të keqen”; gruri që piqet, korret “arriti moshën e pleqërisë, do të vdesë”; del si këlyshët e grurit “përdoret për një njeri që ndërhyr e flet pa vend dhe para më të mëdhenjve”; e do si kokrrën e grurit “e do shumë; E vari kokën si elb i pjekur “u lodh aq shumë sa nuk ka më fuqi”; e shpon elbi “thuhet për dikë që është pjekur seksualisht, kërkon të zërë të dashur”; sikur ka ngrënë egjër “është i dobët dhe i pafuqishëm”; kërcen si gjeli në thekërr “zemërohet shpejt”; është bërë si lektyrë thekri “është dobësuar shumë”; nuk të pyet me sa e ka thekrën “nuk të përfill fare”; e kemi farë dë arë e presh dë

kosht “thuhet për dikë me të cilin nuk këmi lidhje gjaku, miqësie”; fshihet si fara në ugar “ka frikë e qëndron larg për të mos u zbuluar”; ja ka ngrënë fara bostanin “është plakur shumë, nuk ka më fuqi”; i ka vënë si farat në kungull “i ka vënë sendet me radhë”; mbin si fara në arë keq.” thuhet për një njeri të padëshiruar, që të bezdis”; si grosh i zjerë “njeri që nuk mbaron dot një punë, i qullët, i plogësht”; ziejnë fasulet në diell “bën shumë vapë”; përdridhet si fasulja në shkop “vepron me dredhi”; zjen si fasulja në kusi “është shumë i shqetësuar, e mundon diçka”; mbeti si fasule e ciknosur “thuhet për dikë që i kanë dalë të palarat sheshit”; është si fasulja në lule “është ende i vogël e naiv”; aq i thonë fasulet “është pa mend”; t’i *bluan brinjët me hudhra* “thuhet për dikë që është i fortë e trim”; është bërë si hudhrë e shurdhuar “po i mbarohen fuqitë”; shtyp hudhra në kokën e vet “i bën keq vetes me veprimet e tij”; është bërë për me hudhra “thuhet për një njeri ose kafshë që ka mbatur kockë e lëkurë”; është lëndinë (ugar) nga mendja “është shumë mendjehhtë; është bërë si kashtë e kalbur “është bërë pa vlerë”; e pengoi kashta qerren “sajon diçka të paqenë”; (është bërë) si kashta pas shiut “ka rënë shpirtërisht, e ka lëshuar veten”; ra kungulli nga polica iron.”dëmtohet diçka pa vlerë”; (u bë) si kungulli kur e zë bryma “u dobësua shumë; i shpoi kungulli fundin e kuisë “ka qënë i varfër gjithë jetën”; pjerdhin në një kungull “i bëjnë të gjitha gjërat bashkë, nuk ndahen”; i mbinë lakrat në bark “thuhet për dikë që ha çdo ditë të njëjtën gjë”; është rritur me fletë lakre “ka qënë i varfër e është rritur me skamje”; flet për presh e lakra në bostan “flet përçart, thotë fjalë boshe”; e ka ujët në misërit “është shumë i zënë, ka shumë punë”; misër në thest e tenxheret bosh “është koprac i madh, aq sa nuk harxhon dhe për t’u ushqyer”; është bërë si kallëp misri “është veshur me rroba të reja”; kishte mbetur si kallëp i luspitur “kishte mbetur pa rroba në trup e pa gjë në shtëpi”; e bëri lëmazhdë “punon pa kujdes, bën shumë rrëmujë”; s’*bëhet mielli i misrit petë* iron. “është gjë e pamundur, nuk mund të bëhet”; (rri) sikur i ka përvëlur zjarri mullaret “shumë i mërëzitur, i dëshpëruar”; hedh pleh në shkëmb “bën punë pa dobi”; është bërë si presh i zjerë “është lodhur shumë”; ju bë preshi me mustaqe në barkt “ha gjithmonë të njëjtën gjë”; është si presh mashkull “është i trashë nga mendja”; mbeti si plori në muzgë “është në gjendje të vështirë”; i kanë mbirë qepët nga maja “i ka punët keq”; i ra si bastra qepës “thuhet për dikë që i ka rënë një sëmundje e rëndë”; i mbeti qafa si bisht qepe “u dobësua shumë”; e ka mendjen qiçër “ka gjykim e kthjellë, megjithëse i moshuar”; rri si qiçra në tagart “rri

urtë se e ndien veten fajtor”; është si qiqër dë tagart “është i pastër në shpirt, pa djallëzi” etj.

- **Njësitë frazeologjike që lidhen me blegtorinë dhe prodhimet blegtorale** janë shumë të pasura sepse me blegtorinë është lidhur ngushtë ekonomia e krahinës së Devollit, si: flet atje ku i digjen bajgat “flet aty ku e dëgjojnë”; e dija buall, por më doli mizë “nuk është ashtu siç e prisja, si e mendoja”; s’e heqin dot as dyzet buaj “thuhet për dikë që mbahet rëndë, është mendjemadh”; kërkon të heqë buallin për bishti “merr përsipër një punë që s’e bën dot”; rri si bualli dë baltët “rri pa punë”; e do me hosten si bualli “kryen një punë me zor, është dembel”; *s’milet buallica me dru* “nuk bëhen punët me inat, me forcë”; mjel buallicën bë drekë “i bën punët me shumë vonesë”; është cjav për zile “është rritur e burrëruar, është bërë i zoti për të drejtuar një punë”; ta shet cjamin për ka “është mashtrues e dinak i madh”; e la si cjakë të parrjepur “e braktisi, e la në mes të rrugës”; e bën shelegun dash “e zmadhon së tepërmi diçka”; pesë dhen e dashi nëntë “e bën punën shkel e shko”; të tredh si dashin “thuhet për dikë që është shumë i forte”; (e shikon) si dashi kasapin “e sheh dikë me frikë e ndrojtje”; dashi një lëkurë ka “kërkon diçka të tepërt, kërkon më shumë”; është bërë si dele marsi “është dobësuar shumë”; *s’bëhet baxho me një dele* “thuhet për dikë që përpiqet të bëjë diçka pa pasur mjetet e duhura”; delen, gërshëra e plak “njeriun e plakin vuajtjet”; i mban dhëmbët jashtë, si delja kur ha kashtë “thuhet për dikë që qesh vazhdimisht”; ruhet si delja nga gërshëra “përpiqet t’i shmanget diçkaje”; *to të jepja lesh, po s’i shita delet* “shtiret si zemërgjerë e dashamirës”; kërkon të nxjerrë dyzet lëkurë nga një dele “lakmon tepër aty ku s’ka mundësi”; është bërë si dele e përvjelë “është qethur pa kujdes”; dele drekë, dele darkë, dele shtro, dele mbulo “thuhet për dikë që nuk ka mjete jetese të mjaftueshme ose përdor gjithmonë të njëjtën gjë”; është bërë si sheleg i purthosur “është dobësuar shumë e është bërë i neveritshëm”; vjen si shqera pas këmborës “sillet e vepron urtë, i bindet gjithnjë dikujt”; peshon leshin pa qethur dhentë “është shumë i nxituar”; të pret bishtat e dhive “të kërcënon kot, vetëm sa për të të frikësuar”, hidhet si dhia dë stapt të çobanit “lëviz e kërcen sa andej-këtëj”; i kanë ikur dhitë “i ka ikur mendja”; si dhia dhe kakërdhia “thuhet për dikë që nuk respekton më të mëdhenjtë”; qesh dhia delen se e ka bishtin e shkurtër “thuhet për dikë që qesh me të metat e tjetrit dhe nuk sheh të tijat”; rri si dhia në

majë të drizës “nuk rri i qetë, nuk ndihet mirë në atë vend”; thirru dhive! “mblidh mendtë, eja në vete”; u bë si qimja e dhisë “u inatos, u egërsua”; është shakull dhie me lesh brenda “është njeri me shpirt të keq”; është i drejtë si bishti i derrit “hiqet si njeri i mirë e i drejtë, por në të vërtetë është dredharak”; është bërë si derr i mbyllur “është shëndoshur shumë”; i ditka derri përrenjtë “thuhet për një njeri që është i shkathët, i zgjuar”; sikur ka qënë me derrat “është bërë shumë pis”; është bërë si derri dë koçekt “është i inatosur”; kërkon të heqë derrin për bishti “përpiqet të bëjë diçka të pamundur, punon pa mend në kokë”; janë mbledhur derrat në një gobellë “thuhet për një grup njerëzish që shtyhen e bëjnë rrëmuje”; (i pëlqen) si derrit lëndina “e tërheq dhe i pëlqen shumë diçka”; prija derrit hundën, gjene do rrëmojë “thuhet për dikë që nuk vë mend, ndërhyt në punët e të tjerëve”; sikur kanë shirë derrat “thuhet për një mjedis të papastër ose të mbajtur keq”; vete si derri (buallica) pas llucës “i pëlqen shumë diçka e keqe, e pistë”; i shkrin dhjamët derrit “bën shumë vapë”; punon sikur i shkul qimet derrit “punon ngadalë e keq”; mbahet si ftujë shytë “mburret pa meritë”; sikur i kanë ardhur ftujat “është shumë i gëzuar”; të dihej e mira e kaut, nuk vihej dënë këmbë “thuhet për dikë që nuk vlerësohet ashtu siç e meriton”; është bërë si kau në pranverë “është dobësuar e është tretur shumë”; u mësua si lopa dë lakrat “u mësua të hajë të pijë në bollëk”; e mjel lopën nga prapa “e kryen një punë së prapthi”; i vë lopës samar “bën punë pa mend”; ç’*të* duhen ato tre qe? “përzihet në një çështje a punë të ngatërruar”; *s’ka kush ia nget qetë* “thuhet për dikë që nuk e përfill njeri”; *s’na rrojnë qetë* (viçet) “i thuhet dikujtë që kërkon gjithmonë të hajë a të shpenzojë pa masë”; ha tërë viçin dhe lë bishtin “punon shumë, po pa cilësi”; të nxjerr viçen pe barkut të lopës “është shumë i shkathët”; është as viç, as kërric “është i papjekur dhe pa përvojë”; i erdhë viçet “erdhën mendtë, u rrit”; iku djathi, mbeti hira “thuhet kur humbet diçka me vlerë e mbetet ajo që s’vlen”; e ka kripur djathin “e ka çdo gjë në rregull”; e lë djathën pa shëllirë “e lë punën në mes”; atij iu prish djathët, tinë pyet për hirën “thuhet për dikë që pëson a humbet diçka të madhe dhe të tjerët e pyesin për gjëra pa rëndësi”; është si gombolkë djathi “thuhet për një fëmijë të shendetshëm”; pret kulaçi djathën “pret një mik a një shok me të cilin të hahet muhabeti”; doli dhallëgjyer “punoi shumë e fitoi pak”; dava dhalli “çështje pa vlerë e pa rëndësi”; kërkon dhallë të thartë dë kollozheg “kërkon diçka të pamundur”; u bë si luga dë dhallët “u bë i bezdisshëm”; kërcen si pleshti në dhallë “ndërhyt pa vend në bisedë”; e

bëri për gjalpë të skuqur “e rrahu keq, i foli ashpër”; të pjek pa vaj e pa gjalpë “thuhet për dikë që nuk i vjen keq për të tjerët, i mundon”; gjej çoban e kërko gjizë “gjej njeriun e duhur për të bërë një punë”; është bërë si sapllak me gjizë “është shëndoshur shumë” etj.

- Njësi frazeologjike që lidhen me kafshë pune, shpendë të buta apo insekte që janë të rëndësishme në jetën e fshatit si dhe me vegla pune e pjesë të tyre që përdoren me këto kafshë**, si: fshiji buzët me torbën e gomarit “nuk ka për të ngrënë ose për të pirë më si më parë”; pse e ftojnë gomarin të dasmët? “thuhet për dikë që e ftojnë për ta ngarkuar me punë të rënda”; e ha si gomari gjembin “ha me shumë shije”; e hip gomarin pa samar “nuk mendohet shumë për të bërë një punë, punon shkel e shko”; e hipi bë dyzet gomerë “e talli, e vuri në lojë”; nuk hip dot gomarë e tij “thuhet për një njeri që është i paaftë, i pazoti për veten e vet”; të hip bë njëqind gomerë “të premtun shumë, por s’ të mbaron punë”; gomari t’ ish do kish ngordhur “thuhet për dikë që e rrahin vazhdimisht, po ai nuk merr vesh”; është gomari me zile “është shumë budalla”; (mendohet) si gomari të trahanat “mendohet shumë për diçka”; e gjet si gomari të duhanat “është qortuar e rrahur kot”; kur të pëllasë gomari i zi “asnjëherë, kurrë”; gomari plak, palldëm i kuq “thuhet për dikë që bën diçka që nuk i përshtatet moshës që ka”; sikur shpon gomari “punon keq e pa merak”; e tërheq gomarin ngaj bishti “nuk di të bëjë një punë, nuk ia di radhën një punë”; gomari e vënë, gomari e ngrënë “është budalla, jo i zgjuar”; është veshur si gomari me lecka “është veshur trashë”; thotë gomarka prej balti “thotë gjër që nuk qëndrojnë, që nuk mund të besohen”; e zë gjumi bë gomart “është i qullët dhe i plogët”; shkoi të bëjë pazar e solli prapë gomari “u lodh kot për një punë, nuk bëri asgjë”; ka vajtur balta gjer në bark të kalit “ka rënë shumë shi, ka shumë baltë”; e ka bërë si dhëmbët e kalit “ka punuar rrallë, jo dendur, ka bërë punë pa kujdes”; do kalë me shalë “lakmon shumë”; është si kalë pa fre “është i papërmbajtur”; mos e gjetë kalin *b’udhë* “thuhet për një njeri që është i keq dhe i prapë (përdoret sidomos për fëmijët)”; u hap si kalin të vrat “mori përsipër shumë punë që s’ i kryen dot”; është bërë si kalin i cironjve “thuhet për një njeri që e urdhërojnë shpesh, e përdorin dhe për gjëra që nuk i takojnë”; është si kalë revani “është i shpejtë dhe i shkathët”; u bë për bë kalët “u bë për t’u martuar”; kalit të botës i këputet palldëmi bë të përprjetë “nuk bëhet diçka me gjënë e tjetrit”; pordhi kalin në derë të

hanit “ndodhi diçka e parëndësishme”; të rrëzon ngaj kali “thuhet për një vajzë që është shumë e bukur”; si kalë i suvariut “mbahet më të madh, i pëlqen vetja”; sikur i erthi kali te dera “nxiton e ngutet shumë”; i rreh këmbën e kalit “përpiqet shumë, bën çmos të arrijë diçka”; u dhje nusja bë kalët “papritur ndodhi diçka e papëlqyer, dështoi një punë”; flet si nusja në majë të kalit “nxitohet e flet para kohe”; sikur bë perçe të kalit të hidhet “le të përpiqet sa të dojë, nuk do ta arrijë atë që do”; të jep një thelë e të kërkon një pelë “shtiret sikur të ndihmon, por të merr më shumë”; kalbet druri në samar të mushkës “një vend që ka shumë lagështirë”; iu shtuan huqet si mushkës plakë “thuhet për një njeri që kanë filluar t’i shtohen veset e grindet për hiçmosgjë”; flet një nga mushka, një nga krushka “thotë gjëra të kota, pa kuptim”; *është mushkë, s’është dhi* “është shumë i sertë dhe kokëfortë”; *s’është mushkë ta heqësh pe* kapistalli “është njeri që s’bindet lehtë”;

**Me kafshë të ulëta që kanë karakteristika unike:** e ka gjumën si të lepurit “e ka gjumin shumë të lehtë”; ra si lepuri në lakër “ra në bollëk”; fle si lepuri në dëllinja “fle me shumë frikë”; e humbi si lepuri në thekra “u hutua”; i jep lepurit qepë “nuk di ç’bën, punon pa mend”; e mbajnë si lepurin në baçe “e mbajnë më tërë të mirat”; rri si lepuri në krastë “rri i mënjanuar”; i nxori brirët si ligaveci në maj “e zbuloi veten se kush është”;

**Me kafshë shtëpiake:** është bërë si lëngu i qenit “thuhet për një njeri të fëlliqur, të pështirë”; është bërë si qen pa erë “e ka humbur mprehtësinë”; kur të hanë qentë darkë “shumë vonë”; ia hëngri qeni petullat “përfundoi shumë keq dikush”; sikur i hanë mishrat qentë “ka dhimbje të padurueshme”; është qen që ha të zonë “është i pabesë e mosmirënjohës”; ngordhi si qeni në zinxhir “përfundoi keq”; e qeshin dhe qentë “thuhet për dikë me vese që qeshet e tallet nga të tjerët”; ka bërë rrojtkë pe qeni “ka kaluar një jete me shumë mundime e vuajtje”; ri si langori pas erës së gjahut “rri në përgjim e gati për të vepruar”; është këlysh i pagoditur “është tepër i përkëdhelur, nuk i janë vendosur kufizime”; *s’e pinë buçet de!* iron. “nuk e gjeti gjë”; rit kutën të të hajë pulpën “thuhet për dikë që është mosmirënjohës, nuk t’i njeh dhe vlerëson të mirat që i ke bërë (thuhet kryesisht për fëmijët përkundrejt prindërve

Për vetë ngarkesën negative që ka, fjala **mi** është vatër semantikepër një numër të madh njësisish frazeologjike të të folmes së Devollit, disa prej të cilave përdoren dhe në krahina të tjera, si: u fsheh si miu në ogradë “është shumë frikacak, nuk ka guxim të përballet me

diçka”; (janë) njëri mi, tjetri kaci “janë të ndryshëm, që nuk ngjajnë fare e nuk puqen në mendime”; s’*kish ku ta* lëpinte miu “shumë i varfër, i këputur; i ngordhte miu në magje “është shumë i varfër”; një mi në kusi “shumë pak, në sasi të papërfillshme; rri si miu prapa poçes “rri i fshehur e me frikë”; s’*vete miu në hambar bosh* “mendohet mirë para se të bëjë një punë, për të arritur aty ku do”; i dha sa për shpirt të miut “i dha fare pak, sa për t’i zënë sytë”;

**Me emra insektesh.** Emrat e insekteve si gjymtyrë të njësive frazeologjike të kësaj krahine janë kryesisht ato që përdoren me ngjyrimë keqësuese: iu bë morri me bisht “është shumë i papastër; i ra morri në pjatë “i dolën të palarat në shesh”; s’*të jep një* morr të kruash kokën “është shumë dorështrënguar; s’*kish një morr të kruej* “ishte shumë i varfër”; *të kreh dhe t’i le morrat brenda* “të lëvdon e të fërkon krahët, por nuk të vë në dukje të metat e dobësitë”; iu dogjën pleshtat “u dëmtua shumë ekonomkisht, ka shpenzuar shumë”; e ka plesht dë vesht “e ka halë në sy, e ka inat”; do të lidhë pleshtin bë litar “kërkon të bëjë diçka të pamundur”; iu ngjallë pleshtat “mori fuqi e guxim”; u bë si mizë kali “u bë i bezdisshëm, i padurueshëm”; fshihet si miza në bisht të kalit “është frikacak i madh”; mbahet si miza në vithe të kalit “mburret e kapardiset kot”.

**Me emra shpendësh:** bufi di të bëjë “*bu-bu*” “përsërit gjithnjë të njëten gjë”; (ka rënë) si pula në mulli “ka rënë në mes të të mirave”; kakaris si pula në vapë “është llafazan i madh”; rri si pula e hatullave “rri i mënjeluar dhe i fshehur”; ri si pula majë vastangarkës (hurit) “rri si mbi gjëmbe, nuk ndihet rehat”; ai të ha si qelbësi pulën “ta bën të keqen fshehurazi”; është si gushë pule “e mban çdo gjë për vete, është koprac”; është zier si në gushë të pulës “nuk është zier mirë”; ka ngrënë katëk pule “është llafazan i madh”; iu bë mishtë si të pulës “a shumë ftohtë, i dolën mornica në trup”; e do si pula rasatin “e do shumë dikë ose diçka”; ra kuaçkë në vjeshtë “e nis një punë me vonesë”; e hëngri qafën e patës “e pësoi ashtu siç e meritonte”; s’*di këndesi të mbajë brekë* “bëhet shumë pis, i gris rrobat shumë shpejt”; ecën si këndes çallmaxhuk “ec duke u kapardisur”; *sot s’bën as* zogu fole “është fatkeqësi shumë e madhe”; është zog i papendosur “është i vogël, i parrahur me jetën”;

- **Njësi frazeologjike që kanë si vatër kuptimore emra kafshësh të egra që jetojnë në krahinën e Devollit.** Në pjesën më të madhe këto njësi lidhen me kafshë të tilla, si: ariu, ujkua, dhelpra etj. si simbol i forcës, dinakërisë apo grykësisë, si: ra si ariu në mjaltë “uk



kish të ngopuar”; ariu fle, vete e zgjon “thuhet për dikë ngacmon pa marrë parasysht pasojat”; si grera në hundën e ariut “thuhet për dikë që të shqetëson vazhdimisht, aq sa bëhet i padurueshëm”; lëpin potillën (putrën) e ariut “rri, e kalon kohën kot”; harron si arusha shpellën “thuhet për dikë që është harraq i madh”; është veshur si ariu në qyrk “është veshur shumë trashë”; pinë arinjtë, pinë dhe minjtë “thuhet për dikë nuk e mban pijen, dehet shpejt”; e luajti si ariun “ e vuri në lojë dhe e mundi shumë”; ia pret dhelprës me gërshtë “është shumë i zoti e dinak”; u zu dhelpra në leqe “u kap në faj”; e ka erën si të ujkut “nuk i kap gjërat shpejt”; e çaftë ujku pa dhëmbë mallk. “pastë një vdekje me shumë mundime”; nuk ha ujku mish me porosi “thuhet kur e do dikush çdo gjë të gatshme”; *s'trembet ujku nga këmborët* “nuk trembet njeriu i keq vetëm me fjalë”; ka zanatin e ujkut “është grabitës e zhatës i madh”;

**Me emra shpendësh të egra.** Bien në sy njësi frazeologjike ku krahasimi bëhet me emra shpendësh, të cilët, në mendësinë devollite, kanë cilësi të këqija. Kështu mund të përmendim njësi të tilla, si: si laraska hu më hu “është i lëvizshëm dhe i paqëndrueshëm”; është si galë e zezë “është shumë i keq e shpirtzi”; tremb galat “nuk bën asnjë punë për të qenë”; është gallof pa pendë “është i madh në trup, por i trashë nga mendja”; mbeti si qyqja pa fole “mbeti vetëm”; ishte rrush e qyqe “ishte shumë i varfër”; e hëngri si stërgu zhabën “ha shpejt e shpejt pa e përtypur mirë”; e hodhi si lejleku “e flaku tej si gjë pa vlerë”.

**Me emra peshqish:** si cironkë në pe “është shumë i dobët”; si cironkë e tharë bë tym “është shumë i dobët; (mbeti) si cironkë bë të thatë “mbeti si peshku pa ujë, pa rrugëdalje”.

- **Njësi frazeologjike që lidhen me zeje të ndryshme si zdrukthëtaria, poçeria, artizanati, kuzhina dhe veglat e tyre të punës,** si: e dredh si petën në astragaç “është dredharak”; mjel me shoshë e mbledh me astragaç “bën punë pa mend e pa dobi”; e haron saçnë mbi lakror “është hutaq i madh”; i ka rënë në kokë saçi i përvëlur “e kanë zënë halle shumë të mëdha”; mbeti si rrushi pa furkë “mbeti i vetëm e pa përkrahje”; u bë si leshi në furkë “u dobësua shumë”; do dredhur në furkë “do ndëshkuar rëndë”; *s'është* as për furkë, as për çorap “nuk është i zoti për asgjë”; ngrihet me furkë në dorë “çdo ditë e nis punën herët”; e ka si plaka furkën “punon mirë e me kujdes, kryen me lehtësi një punë”; baret si në katër lisa “lëkundet shumë, ec sa këtej-andej”; *s'i ta marrë goneja* “si

të qëllorë, si ta sjellë puna”; e vuri në gone “rregulloi një punë, e vuri në vijë”; i bie bilbililit më të kthjellët “e ka punën në vijë”; mbeti si gjym pa veglë “mbeti i vetëm, pa ndihmë e përkrahje”; është trokashkë (klopashkë) mulliri “është llafazan, flet shumë”; me një gisht ujë i mbluante mulliri “ishte i varfër”; *pret dhe s’krasit* “punon pa kujdes”; është shtruar si sharrëxhinjtë “ha me oreks e shije”; iu duk qielli sa një shoshë “u trullos, u hutua”; ia zdrugoi mendjen (kokën) “e qortoi që të vërë mend”; tjerr me një bosht “mban të njëjtin ritëm, punon me të njëjtat gjëra për një kohë të gjatë”; i humbi fija e kallamit “u hutua, e humbi toruan”; (më la) gur bë leckët “më braktisi, më la vetëm”; u rrit si hardhi e krasitur (bimë) “u rrit shpejt e hodhi shtat”; është kleçkë e katranit “i dobët në trup, por shumë i fortë”; i do shtypur (vënë) koka në mëngene “do ndëshkuar rëndë”; është i drejtë si tevlig “është shumë dredharak”; vareja e thyen gurin “thuhet për dikë që është i pabindur e duhet përdorur forca”; është bërë si limë e ngrënë “ka rënë shumë nga shëndeti e nga fuqitë”; e lë poçen pa vegë “e lë punën përgjysmë”, njerë agaj, njerë ustaj “drejt, pa mbajtur anësi”

- **Njësi frazeologjike që lidhen me emërtime gatimesh.** Ky grup njësisht lidhet me gatime që janë karakteristike për krahinën, me përmbajtje brumi, mishi, si dhe me zahiretë e dimrit, si: *s’kish nëj grusht miell për mëmëligë* “nuk kishte asgjë për të ngrënë”; e ka gojën për mëmëliqe “nuk e kthen fjalën, nuk është i zoti të kundërshtojë”; prit të skuqet dhallaniku “prit gomar të mbijë bar”; nuk gënjehet plaku me kulaçe “njeriu me përvojë në jetë nuk gënjehet lehtë”; është si lakror i pjekur në diell “i pazier, i papjekur mire”; *lakrorin që s’e ha vetë le të digjet* megjithë saç; “thuhet për dikë që prirret gjithmonë nga interesi vetjak e s’pyet për të tjerët”; e nis lakrorin nga mesi “e nis jo mbarë një punë, jo që nga fillimi”; gjeti mana për trahana “gjeti arsye për t’u justifikuar, gjeti sebeb të ankohet”; na e zjeu trahanin “na e kaloi e na la në baltë”; u bë ujët narden “u zgjat shumë një punë”; del si ujët dë armet “thuhet për dikë që do të duket mbi të tjerët”.
- **Njësi frazeologjike që lidhen me emërtime veshjesh.** Në këtë grup njësisht hyjnë ato që kanë si gjymtyrë fjalë që emërtojnë veshje të plota dhe pjesë të tyre. Vihet re se në njësitë frazeologjike me emërtime veshjesh mbizotërojnë veshjet karakteristike, si: guna, opinga etj.; ç’të duhet ajo kapë e gjelbër? “pse u hyn telasheve kot”; *s’ia nxë kapa kokën* “ka shumë halle; iku pa kapë “iku shpejt, me shumë nxitim”; i rëndon kapa bë kokët “është dembel i madh”; të ngresh paçet “është shumë pis, thuhet për një shtëpi shumë të